

VITO KOĆI

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8482
K77

BORE
NE BJESHKE
novelë

8J4-32

K. FZ

VITO KOÇI

BORË NË BJESHKE

n o v e l ë

1463



SHTEPIA BOTUUESE «NAIM FRASHERI»

1.

Vukë Marashi, brigadier i sharrëxhinjve, mezi e nxori tehun e sëpatës nga kllapa që po i bënte drurit të pishës, e uli përtokë dhe u mbështet me pëllëmbët kryq mbi bishtin e saj. Gjoksi i tij i gjerë, i mbështjellë me një fanellë leshi të ashpër, të hirtë, thithëtë me lakmi ajrin e ftohtë të pishnajës.

— A u lodhe, Vukë — e pyeti shoku përbri, një djalosh që sapo ishte kthyer nga shërbimi ushtarak.

— Jo, jo, ore Frrok Gjoni, megjithëse nuk janë të lehtë pesëdhjetë vjet mbi këto supe.

Frroku e mati me sy, sikur e shikonte për të parën herë.

Trupi i Vukës filiz përpjetë, me këmbë të gjata si të mbira nga toka e shpatit, me belin e ngushtë të shtrënguar prej rripit të gjerë me shpatulla të fuqishme dhe me krahë si degë lisi, dukej sikur qe rritur aty, bashkë me drurët e pyllit. Fytyra e tij me ballë të lartë, me hundë të gjatë e të drejtë dhe me nofulla të gjera, ishte si e gdhendur me sëpatë.

— Qofsha dhe unë i fortë sa ti kur të arrij atë moshë! — tha Frroku.

— Ti ke për të qenë më i fortë. Ne kemi vuajtur shumë, — ia priti Vuka dhe filloi rishtazi punën. — Kanë filluar të lëngëzohen drurët. Ndihet në goditjen e sëpatës. C'datë jemi sot?

— Tre Mars.

— Hej, paskemi dalë nga shkurti!

— Po, ja mbërriti pranvera! — tha Frroku. — Mbajti dimër i butë sivjet. Me këtë farë kohe, po punojmë më mirë se në verë.

— Dimri ende s'ka dalë! — tha Vuka duke tundur kokën me dyshim. — Thelloje edhe pak kllapën nga e majta. Duhet ta rrëzojmë drurin me majë nga çeltira, përndryshe e mbajnë degët e shokëve.

Frrok Gjini rroku bishtin e sëpatës që e mbante midis gjunjëve. Tehu i çeliktë përshkoi një hark të gjatë, vetëtiu kërcënueshëm dhe pastaj goditi trungun. Mbas çdo goditjeje kërcenin ashkëla verdhoshe, të brishta, të pastra, që lëshonin një kundërmim të freskët e të athët rrëshire.

— Të lumshin krahët, mjaft e ka! — tha Vuka mbas pak.

Iu afrua motosharrës që dergjej rrëzë një shkëmbi, e preqatiti, tërroi disa herë litarthin e saj dhe befas zhurma e motorit drodhi ajrin. Një shpend i trembur u ngrit në fluturim.

Vuka mbërtheu me duart e mëdha si putra ariu dorezat e motosharrës dhe iu drejtua Frrokut:

— Preje ti. Mos u ngut. Po u sforcua motori, tërhiqe pak tehun, pastaj mëshoi përsëri. -

Frroku mori motosharrën dhe iu afrua pishës së kllaposur. Ndiente në shpinë vështrimin e brigadërit dhe ishte i shqetësuar se mos turpërohej. E mati drurin me sy gjer në majë, vuri në lëvizje zinxhirin prerës dhe i mëshoi tehet në trung. Zinxhiri kafshoi

drurin dhe nisi të futej thellë e më thellë duke spër-katur tallash. Kllapa kundruall ngjante tani si ndonjë gojë e çapëlyer nga dhembja e drurit që po vdiste.

Vuka, me krahët e kryqëzuar në gjoks, ndiqte me vëmendje çdo lëvizje të djaloshit. Dalloj në fytyrën e tij të freskët e të tendosur bulëza të imta djerse dhe buzëqeshi me mirëdashje.

«Po e lodhka motosharra më shumë se sharra e krahut!» mendoi: «Por ka për të mësuar shpejt, se është djalë i shkathët. I shkathët si ai Frroku tjetër. Veç i shkoftë më mbarë se atij!»

Vetullat e dendura e të kuqërrreme iu vrenjtën, sytë iu trishtuan. I qe kujtuar një ish-shok i brigadës, Frrok Gjeloshi, të cilin dhjetë vjet më parë e kishin zënë trupat dhe kish mbaruar në krahët e tij. Ishte më i riu ndërmjet tyre dhe e kishte dashur si djalin e vet.

— Ruajuuuu! — ushtoi nëpër pyll zëri i Frrokut.

Legusha u trazua nga hapa që rendnin. Pasoi një heshtje e shkurtër. Pisha u hepua pak nga ana e kllapës, qëndroi një çast pezull, cungu krisi pastaj druri vazhdoi gjithnjë e më shpejt hepimin, i shoqëruar me një krisje që rritej, gjersa u përplas me rrapelli-më në tokë.

Vuka u afroa i pari dhe vërejti me një farë krenarie se pisha qe rrëzuar pikërisht ku e kishte terezitur ai. Ngriti vështrimin nga kurora e drurëve përreth. Ato nuk qenë dëmtuar, po ndërmjet tyre kishte mbetur një boshllëk, si dritare nga qielli.

«Edhe druri lë vend bosh kur bie!» mendoi Vuka. «Por dalngadalë kurorat e të tjerëve do ta mbushin.»

— Sa e madhe u dukërka kështu e shtrirë! — tha Frroku.

— Pishë e moçme! — tha Vuka duke vështruar rrathët e cungut. — I ka kaluar të njëqindat.

— Boll paska jetuar në këto bjeshkë! Sikur të jetonim edhe né kaq!

— Sado që të jetosh, djalosh, s'të duket kurrë se ke jetuar boll! — vërejti Vuka duke tundur kokën i menduar.

— Kushedi se ku do të shkojnë dërrasat e këtij druri! — tha i riu, ndërsa priste degët me një të rënë sëpate. — Ndoshta disa në Fierzë, disa në apartamentet e Tiranës, ndonjëra do të bëhet dritare e një shtëpie pushimi në bregdet... Kanë për të parë botë më shumë se ti, o Vukë!

— Po unë kam dalë pak e rrallë prej këtyre bjeshkëve! — pranoi Vuka. — Herën e fundit, ka tre vjet, shkova e pashë djalin ushtar në Tiranë. Kur të dal në pension, do të zgres më shpesh. Kam disa miq andej nga kryeqyteti, edhe në Durrës, edhe në Laç...

— Njëqind pensionistë nga rrëthi ynë kanë shkuar vullnetarë në hekurudhën e rinisë! — tha Frroku. — Për ta shkruante edhe «Zëri i Popullit».

— E di. Shumica e tyre janë ish-sharrëxhinj. Me ta është edhe Matija ynë. Kanë marrë flamurin, kështu shkruante. U lumtë. Për nder, ua kam lakmi.

— T'u mërzitën bjeshkët dhe capina, Vukë, hé? — e ngacmoi i riu.

— Ç'po flet, bre burrë? — u nxeh Vuka, ndërsa vazhdonte çlevorimin e trungut të pishës. — Krahët e mi pa sëpatën e capinën s'janë krahë. Sa për këto bjeshkë... — Ai drejtoi një çast trupin dhe pérqafoi me vështrim pishnajën, luginën e mjegulluar, kresh-tat e zbardhura të maleve dhe qiellin e veshur me re

puplore... Këto bjeshkë nuk i shkëmbej, të më falësh botën!

— Nuk më pëlqejnë ato re, o Vukë! — tha një zë i tretë.

Ndërkokë u afrua një burrë i shkurtër pak i kërrusur, me mustaqe të zeza të varura poshtë, me një të ecur të ngathët që e tregonte më të moshuar nga çishte.

Ai u ul në një cung të vjetër, nxori qesen e duhanit dhe futi në të gishterinjtë e trashë.

— U lodhe, Llesh? — pyeti Frroku.

— Si të mos lodhesh duke pastruar gjithë ditën këto degë të mallkuara! M'u këput mesi. — Ai vuri duart në bel dhe u shtriq. — Ai dreq Palokë e kërkon pyllin të pastruar më mirë se shtëpinë e vet, thua se do të shtrojë sofrën në të!

— A ke pastruar ndopak? — pyeti Vuka.

— Boll, besa!

«Boll e për dreq!» — mendoi Frroku.

— Dridhe, Vukë! — Lleshi i zgjati qesen prej lëkure. — Është duhan i mirë, mos e gjyko nga dukja.

Vuka e mori qesen me dorë në zemër, drodhi shpejt e shpejt një cigare dhe nisi ta pinte në këmbë, me sépatën ndërmjet gjunjëve.

— Ulu e pije si njeri! — tha Lleshi.

— Na iku dita, bre burrë!

— Dita atë punë ka. Ikën njera, vjen tjetra... S'më pëlqejnë ato re! — përsëriti Lleshi, duke treguar me gisht boshillëkun që kishte lënë kurora e drurit të rrëzuar. — Përrroi po avullon, fryn veri i lehtë. Rrezik të bjerë borë.

— Bjeshkëve u duhet bora, edhe bujqësisë! — tha Vuka.

— Mos, bre burrë! S'e kam një shkop dru në shtëpi, as gjethë për dhitë. Mandej, na mbulon prodhimet pa i dorëzuar dhe mbetemi pa lekë në fund të pesëmbëdhjetëditeshit.

— Prandaj duhet të ngutemi! — Vuka pështyu bishtin e cigares dhe rrroku sëpatën. — Makar të zbresim trupat në rrugë.

— Ngutu sa të duash, traktori nuk vjen para pesë ditësh. Atëherë na takon sipas grafikut.

Sot është duke punuar te brigada e Marashit.

— I transportojmë me krahë.

— Me krahë?! — u çudit Lleshi.

— Po, po me krahë, capinat pse i kemi?

Për t'u lavdëruar me to, se jemi sharrëxhinj të fortë! — qeshi Frroku, duke larguar zvarrë një degë të madhe. — Lleshin s'e shikon gjékundi pa capinë në sup, por besoj se prej javësh nuk i është dashur t'ia cukatë majën te kovaçi.

— Ke hak të tallesh ti! — u zemërua Lleshi. — Je ende i ri dhe s'di ç'është dhembja e sëmundja, por s'ke nga ia mban, do të arrish këtu ku jam unë. Ta kishe ti këtë dhembje mesi...

— Pak dhembja e pak ia shton ti! — e ngacmoi përsëri Frroku.

Lleshi kërkoi përkrahje me sy nga Vuka, por ai heshti i përqëndruar në çlëvorimin e trungut. Atëherë e pa të udhës të mos e shtynte më tej dhe, me pamje të fyter, u cuar, fërkoi mesin dhe, me hapa të ngadaltë, filloi të mblidhët degët e holla.

— Vukë, kam dëgjuar se dikur keni transporthuar me krahë pilota njëzetmetroshe! — tha Frroku.

— Posi, ti nuk kishe lindur akoma atëherë, kurse Lleshi sado që shtiret i moshuar, ishte ende fëmi-jë. — Vuka tregoi pa e ndërpërre punën dhe goditja

e sëpatës sikur nënvizonte fjalët e tij. — Ishte viti i parë i Çlirimit. Gjithë populli punonte për rindërtimin e vëndit. Dëhej shumë lëndë druri. Ndërmarrja jonë apo që ngritur. Ne, që kur zbardhët e gjersa errësohej, i mëshonim sharrës e sëpatës. Ushqeheshim me bukë misri, qepë e kripë. Natën njeri mban te zjarrin ndezur dhe na ruante, të tjerët flinin mbi shtroje gjethesh, me shpinë ndaj tij. Nën kokë mbanim pushkët. Bjeshkët gëlonin nga bandat e armiqve dhe të diversantëve. Kishim drejtor Xhaferri, një ish-partizan nga Vlora. Ishte i dobët me gjurmë plagësh në trup. Nuk e di se si mundej ai njeri t'i qëndronte gjithë asaj pune. S'linte brigadë pa shëtitur. Herë bridhët për bukë, herë mbas makinave që transportonin lëndën, herë me ata të mbrojtjes kundër bandave. Të shumtën e kohës hante dhe flinte me ne, njësoj si ne. Na fliste shpesh për të ardhmen që duhej të ndërtonim vetë, me capinën dhe pushkën pranë e pranë. Na pëlqente të ishte ashtu, por sikur s'na besohej. Kishim vuajtur aq shumë, ishim zhgënjyer aq herë! Në të vërtetë u bë më mirë dhe më shpejt nga ç'e mendonte Xhaferri. E kujtoj shpesh. Dëshiroj ta takoj ndonjëherë. Thonë se ka një punë me rëndësi andej nga Tirana. Kur të dal në pension... Por, u largova nga filli. E patëm fjalën te pilotat njëzetmetroshe. Një ditë erdhi një shok i qeverisë. Na tha se për rindërtimin e urave të shkatërruara nga gjermanët duheshin kaq e aq pilota njëzetmetroshe. «A do të na i çoni? — pyeti. Ne dhe Xhaferri u menduam. Pastaj drejtori kërkoi disa makara dore, kërkoi edhe dy makina me bilik. Shoku i qeverisë nxori shkrepsen nga xhepi, mori disa kunja dhe i tha Xhaferrit: «Hape dorën! Na makaratë, na edhe makinat me bilik.» Ndërkohë i fuste në pëllëmbë kunja shkrep-

pseje. «Tani bëni si të bëni dhe na çoni pilotat. Përndryshe s'ka si rindërtohet ura, s'ka nga ta sjellë qeveria bulkën dhe kripën pér popullin». Xhaferri u skuq, neve sikur na ranë pishat mbi kokë. «Thuaj qeverisë se do t'i çojmë pilotat!» — premtuan. Ai buzëqeshi, na rrahu shpatullat, na shtrëngoi dorën të gjithëve dhe iku.

— E si ia bëtë? — pyeti Frroku.

— Ka gjë që s'bën njeriu po të dojë? — tha Vuka me sytë prush nga krenaria e atyre kujtimeve. — I thamë Xhaferrit të na gjente litar. Zgjodhëm pishat më të larta e më të drejta, i premë dhe i laspitëm mirë. Buzë rrugës ndërtuan një skele të madhe. I lidhëm pilotat mirë me litarë, u bëmë dhjetë burra pér një pilotë dhe kur s'punonte capina, litarët në sup dhe «hoop» më të poshtë drejt e në skele. Nga makinat që punonin te ne, zgjodhëm ato që kishin shoferët më të mirë. U treguam si qe puna. «E vështirë», — thanë, «me rrezik koke, por do ta provojmë!». U priu një shofer i vjetër. Kishte një makinë shytë, por jo si këto të sotmet. Ishte beter e shëmtuar si breshkë, por e fortë. I bëmë samar me shtylla në karroceri, kovaç i nguli dhëmbëza metalike, hodhëm sipër dy pilota dhe i lidhëm mirë. Pilotë dilte si tytë topi përtej kabinës dhe si bisht mbas karrocerisë. Makina mezi i merrte kthesat. Diku i ngriheshin rrotat përpjetë, si të ishte kalë kryeneç. Ekte ngadalë, pothuaj sa hapi i udhëtarit, por pilotat i çuan në kohë. Ja kështu, o shokë!

Si mbaroi tregimin, Vuka i mëshoi më fort e më shpejt sëpatës.

— Ju lumtë, o Vukë! — tha Frroku. — Ju pas-kam lakmi pér këto vepra.

— C'do kohë ka veprat e saj! — ia priti Vuka.

— Makar, a ju paguan mirë? — pyeti Lleshi.

— Të përpiftë Pérroi i Zi me gjithë pare! —

i shfryu Frroku.

— Këtë pothuaj e mbaruam! — tha Vuka, që ndërkokë e kishte, qërruar pishën. — Të presim një tjetër. Frrok, pa shikoje atë atje, a e ka shenjën e damkës?

Frroku e la sëpatën të ngulur në cung dhe nxitoi te pisha që i tregoi shoku.

— Po po, e ka!

— Bëji zë Mirashit, ta kllaposë dhe ti ec më ndihmo ta ndajmë këtë më asortimente. Dalin dy trupa të bukur.

Frroku kërkoi nëpër pyll, s'e gjeti gjékundi shokun, prandaj vuri duart si hinkë në gojë dhe thirri: — Oooo Miiirash!

Iu përgjigj jehona e zërit të tij, pastaj një zë i largët: — Hooo mooore!

— Eeec o Miiirash!

— Ku qenka larguar kështu? — u çudit Vuka.

— Po merr dru për letër te skaji tjetër i parce-lës! — sqaroi Lleshi.

— Përse të punojë vetëm? Kur t'u vijë radha i bëjmë së bashku ato dru! — tha Vuka. — Puna dhe buka vetëm s'shkojnë.

— Ka disa ditë që i pëlqen të punojë veçmas! — vërejti Frroku. — Duket shumë i mërzitur dhe sikur u vidhet shokëve.

— Thua t'i ketë ngelur hatri prej nesh, përse vallë? — pyeti Vuka edhe shokët, edhe veten.

— Jo me ne s'ka gjë, por më duket se ka një hall tjetër! — tha Lleshi duke lëshuar disa degë mbi grumbullin e mbeturinave.

— Ç'hall? — pyetën dy tē tjerët pothuaj përnjëherësh.

— Ndoshta e ndihmojmë! — shtoi Vuka.

— Jo, jo, nuk kemi si ta ndihmojmë! — tundi kokën Lleshi.

— Fol, bre burrë!

— Hm! — ia bëri ai, sikur ngurronte në duhej treguar apo jo. — Ju e dini se Mirashi ka një vajzë që mbaroi sivjet shkollën e infermiereve.

— Po, Bardhën! — tha Frroku. — Punon në spitalin e Dushkakuqit. Është vajzë e mirë.

— Dhe e pashme! — shtoi Lleshi.

— Po, mjafët e pashme! — miratoi Frroku.

— Bijat e pashme tē nxjerrin telashe më shumë se tē shëmtuarat! — tha Lleshi. — Tē shëmtuarave u a gjen dikur një burrë, kurse tē...

— S'kemi nge tē dëgjojmë urtësitë e tua! — ia preu Vuka.

— Mirë, bre... Ende pa kryer kursin, Mirashi e pat fejuar tē bijën me djalin e Prengë Ndrecës! — vazhdoi Lleshi.

— Kam dëgjuar! — tha Vuka. — Djalë i mirë.

— Mirëpo, Bardhës s'i paska pëlqyer!

— Pse, nuk ia patën marrë pëlqimin? — pyeti Frroku.

— Hm! — buzëqeshi me qesëndi Lleshi. Mirashi është burrë zakoni. Por Bardha i paska harruar zakonet andej, nga qyteti. Thonë se nuk do tē marrë atë që i ka zgjedhur i ati, burrë me një barrë mend. Sa për kaq, gjysma e së keqes. Por thonë se Bardha paska filluar ta luajë bishtin me traktoristin tonë, me Lulashin. Hall i mall për tē ngratin Mirash! Të ndodhët kjo dikur kishte krisur...

— E këputën qafën përgjithmonë ato kohë, o Llesh! — tha Frroku.

— Hm! — kërciti dhëmbët Lleshi. — Duhet gishti i pushkës pér të tillat.

— Sot as traktori i Lulashit nuk është i zoti ta tërheqë gishtin e pushkës pér këto punë! — tha Vuka.

— Meqë paska ndodhur kështu le ta prishin fjesën e parë! — tha Frroku.

— Po fjala e dhënë, po turpi?

— Derisa nuk e pyeti të bijën, le ta mbajë edhe turpin, në e mendoftë se i takon! Rrugë tjeter s'ka.

— Mos më rëntë në kokë hall i tillë, se pér nder...! — u hakërrua Lleshi.

— Me këto mend që kë, rrrezik se po! — qeshi Frroku.

— Heshtni se po vjen! — tha Vuka.

Duke u shfaqur dhe zhdukur ndërmjet trungjeve të drurëve po afrohej një burrë i gjatë, me shpatulla të gjera e të kërrusura, me një sëpatë të rëndë mbi supin e djathtë. Ekte kokulur, me hapa të ngadalë, por të gjatë.

— Më thirrët burra? — pyeti në ecje e sipër, sapo u afrua.

— Po Mirash! — tha Vuka. — Kujtuam se je afër, por ti qenkëshe larguar shumë.

— Më largoim puna. Thashë t'i kryeja ato drutë e letrés.

Mirashi uli sëpatën përtokë dhe u mbështet me pëllëmbë mbi bishtin e saj.

— I kishim kryer bashkë! — tha Frroku.

— Nuk e pata pér hile! — ia priti i porsaardhuri duke rrudhur vetullat e thinjura. — Keni pér ta parë sa kam prodhuar.

— As që e menduam këtë! — tha Vuka. — Por na erdhi keq që punove vetëm.

— Njeriu s'është kurrë vetëm! — tha Mirashi. Kur s'je me shokë, je me vvetven. E nganjëherë duhet kuvenduar edhe me veten.

— Sa më shumë shokë të jenë në kuvend, aq më i frytshëm është ai e aq më të urta janë përfundimet e tij! — tha Vuka.

— Nuk shtrohet gjithçka në kuvend shokësh! — ia priti Mirashi. — Në sofër të miqve s'mund të shtrosh ç'do të shtroje përvete e përvjetorë e shtëpisë. Por t'i lëmë këto biseda, se dita është e shkurtër. Ç'duhet bërë?

— Kllapose atë pishën atje! — tha Vulka duke e treguar me dorë. — Shikoje vetë nga duhet rrëzuar.

— Posi!

Mirashi iu afrua pishës, i erdhi qark duke kërkuar vendin e përshtatshëm, diku ndaloi, pështyu në pëllëmbë, rroku bishtin e sëpatës dhë filloj të godiste me forcë, sikur desh të nxirrte dufin që i vlonë përbrenda.

«...Po, po, është e vërtetë. Më kot u orvata gjithë ditën t'ia mbushja mëndjen vetes se janë dyshime të kota. Është e vërtetë, o Mirash ditëziu! Kjo duket aq në vështrimet e shokëve, në fjalët e tyre sado të tërthorta qofshin. Edhe këta e paskan marrë vesh, po, po, e kanë marrë. Sa ç'mund të fshihet tymi, aq mund të fshihet edhe turpi. Pse t'i bjerë kokës sime të thinjur kjo rrufe? S'i kam bërë keq kujt, s'i kam kujt borxh as një qime floku. Njëqind herë më mirë vdekja se kjo... Ah, e mallëkuara, pse të ma bëjë këtë? Prandaj u skuq të shtunën mbrëma, kur thashë ato fjalë përfaqezin?! Si nuk i rasshë në të menjëherë, si nuk ia përdrohha kokën aty

rrëzë vatrës. Ja si ma shpërbleka të mirën. E çova të bënte shkollë në qytet, më shumë nga ç'kanë bërë djemtë, e fejova me burrë të zgjedhur, që shumëkush e pat lakuuar. Nuk mendova për pare, si ndonjë tjetër, po për fatin e saj. I gjeta familje të mirë, pa grimcën e njollës në dhjetë breza. Ajo duhet t'i dijë këto, duhet të më ishte mirënjojëse, kurse... Ah, Bardhë, Bardhë, paskam gabuar që të quajta kështu, paske qenë e zeza për faqen time. Mallëkuar qoftë dita që të çova në qytet. Nuk kullote në lule për mjaltë, por paske shkuar si miza, në plehra. Hajde, pa ta tregoj unë vendin! Një orë e më parë martesa, pa u trashur filli se pastaj nuk e pret as kjo sëpatë... Po nuk pranoi?... Çfarë, të mos pranojë, thua guxon? Për një nder, për një fytyrë pa njolla jetojmë në këtë botë. Sa të jetë gjallë Mirash Pali...»

— Boll e kllapose, o Mirash Pali! — tha Vuka.
— Të lumshin krahët, punove si të ishe njëzet vjec.
Mirashi uli sëpatën dhe fshiu djersën e ballit me kurrizin e dorës.

— Kape motosharrën, Frrok! — urdhëroi Vuka.
Përsëri zotëroi zhurma e motosharrës, përsëri zinxhiri i saj kafshoi drurin, duke e spërkatur ta llash, përsëri u dëgjua thirrja e njobur e sharrë-xhinjve «ruajuuu!», pastaj një krismë, një rrapielli-më, një dritare tjetër nga qielli, një pishë më pak në pyll.

Për një çast u bë qetësi, sikur pishat mbanin zi për shokun e rënë, pastaj filluan të dëgjoheshin rishtazi zérat dhe pëshpëritjet e lashta të pyllit. Sharrëxhinjtë rrethuan drurin e rrëzuar dhe po e vlerësonin me sy.

— Ju lumshin krahët, burra! E rrëzuat edhe një? Sigurisht e ka damkën!

Sharrëxhinjtë ikthyen kokën të habitur. Pranë tyre, sikur të kishte mbirë nga toka, u gjend një burrë i moshuar, trupshkurtër, i veshur me uniformë e gjelbër të pylltarëve.

— Mirësevjen, o Palokë! — e përshëndetën dhe i shtrënguan dorën me radhë.

— I madh paska qenë! — tha Paloka me një farë keqardhje në zë, duke iu afruar drurit të rrëzuar.

Mbështeti pëllëmbën në lëvoren e ashpër të trungut, pastaj e kaloi më sipër te një degë, këputi ca hala, i ndrydhi ndërmjet gishtave dhe iu mori erë.

— A po të dhimset? — tha Frroku, duke buzëqeshur.

Pylltari iktheu kokën. Kishte një fytyrë të vogël, të përshkuar nga rrudha të imta e të dendura, sidomos në cepat e buzëve dhe në bishtat e syve të kaltër e të thellë.

— A ke qenë ndonjëherë bari, o Frrok Gjoni?

— Posi!

— A të janë dhembsur deshtë, kur i kanë therrur? Frrokut iu shua buzëqeshja dhe uli kokën.

— Më shumë se një shekull i stolisi bjeshkët tona ky dru! — vazhdoi Paloka, duke i rënë lehtë me pëllëmbë trungut të pishës. — Tani e pretë. Për gjysmë ore e pretë. Mirë bëtë. Damkën e pat. I duhet vendit druri, dërrasa. Kur është nevoja, ne skursejmë as veten pér ikëtë vend. Veç të mos e çojmë dëm atë çka bjeshkës iu desh njëqind vjet pér ta irritur!

— Të lumtë goja, o Palokë! — tha Mirashi.

— Sidomos kujdes këta! — vazhdoi pylltari, duke drejtuar një filiz të ri, që e kishte zënë druri i rrëzuar. — Vatra pa fëmijë, është vatër e shuar. A keni me drurë të damkosur?

— Fare pak! — iu përgjegj Vučka. — Të shumtën, edhe pér nesér. Kur do ta bëni ridamkimin?

— Do ta bëjmë bashkë me inxhiniere Bledarin, se është punë që kérkon kujdes dhe dije. Pér nesér e kemi lënë. Besoj se ai kthehet sot.

— Posi, more! — ia bëri Lleshi me shpoti. — Mos iu dogj zemra pér bjeshkët tona atij që të udhëtojë të diel tekxa mund të gëzohet me të fejuarën nëpër Tiranë. Në ardhëtë nesér falëminderit!

— Ai është njeri i fjalës! — tha Paloka.

— Dhe i punës, besa! — plotësoi Vuka. — Thua se është bir i këtyre bjeshkëve, aq i thjeshtë e i dashur tregohet me né.

— Po kaloj edhe nga brigada e Gjetanit! — tha Paloka, duke iu dhënë dorën. — Ju shkoftë puna mbarë!

Ai ia nisi shtegut të pyllit me hap të lehtë e të shkathët. Ecja e tij kishte diçka nga ecja e kafshëve të pyllit. Kur e vinte këmbën, guri nuk luante nga vendi, degët e thata nuk kërcisin, legusha nuk tra zohej. Vidhej midis degëve e shkurreve, thuajse ngushtohej e zgjerohej bashkë me shtegun.

— E do pyllin si fëmijën e vet! — tha Vuka, duke e ndjekur me sy.

— S'do të ketë fare familje! — tha Frroku. — Ditëtë pune e festë qoftë, në pyll e gjen. Rrallë zhduket disa ditë. Se ku shkon!..

— Ka vetëm një bijë të martuar larg! — sqaroi Mirashi. — Tek ajo shkon. I do kijamet nipat e vegjël. Gjithë ç'i tepron nga rroga, uaçon dhurata. Fotografitë e tyre i mban në xhep. Kur përmallohet, i nxjerr dhe i shikon. Ta shikosh fytyrën e tij atëherë, thua se nuk është Paloka i rrepte.

— Në punë, burra, se na zuri nata! — thirri Vu-ka dhe kërceu mbi pishën e rrëzuar.

2.

Nga pamjet që parakalonin në dritaren e vagonit, inxhinier Bledari, që e bënte shpesh atë udhëtim, e dinte se pas pesë minutash treni do të arrinte në stacionin e fundit. E kishte bezdi dyndjen e pasagjerëve me plaçka dhe me fëmijë gjatë zbritjes, prandaj u çua, rrëmbeu nga varësja çantën e zezë sportive dhe shkoi drejt daljes. Përtej xhamit të derës pa të parakalonin grumbuj tullash, hekurish-tash, një tabelë me mbishkrimin «Stacioni i mallrave», stiva dérrasash e të tjera.

Treni ngadalësoi ecjen, u dëgjua fishkëllima-e sirenës, zhurma karakteristike e frenave, u ndie lë-kundja e lehtë e stopimit, pastaj vagonistja çeli derën: Bledari kërceu në platformë menjëherë pas saj dhe nxitoi drejt derës së stacionit, i shoqëruar nga gumëzhitja në rritje e pasagjerëve që po zbrisnin.

Ora e stacionit tregonte pesëmbëdhjetë e njëzet e pesë. Bledari pa instinktivisht edhe orën e vet. Po të gjente makinë shpejt, rrëth orës njëzet do të arrinte në sektorin e shfrytëzimit të pyjeve. Te bufeja e stacionit bleu një paqetë cigaresh rezervë dhe këputi shkurt, drejt stacionit të mallrave, ku shkarkonin makinat që vinin nga sektorët e pyjeve.

Në atë qytet fyrn rëndom erë, por atë pasdite frynte më shumë dhe bënte freskët. Bledari ngriti jakën e palltos së zezë dhe vështroi nga qielli. Iu duk sikur retë e murme, që mbulonin tejpërtej hori-

zontin, diçka rëndonin edhe në brendësinë e tij. Prej kohe nuk e kishte ndjerë veten aq të pezmatuar.

S'kishte bërë as gjysmën e rrugës, kur e arriti dhe frenoi pranë tij një «Skodë» me rimorkio. Bledari ndjeu një grimcë kënaqësie kur pa targën e njojur 13-34. Nga dritarja e shoferit doli një kokë ezmere, me flokë të dendur e të shpupurisur dhe mesy të kaltër që e shprehnin kënaqësinë më bukur se buzëqeshja e gojës së tij të madhe.

— Mirëdita, inxhinier! Për ku kështu, në sektor?

— Mirëdita, Sulë! Në sektor, ku gjetiu?

— Hip pra, ç'pret?

Bledari çeli derën dhe hipi me një shkathtësi që tregonte se kishte udhëtar shpesh me automjete të tilla. Brenda nuk kishte pasagjerë të tjerë. U rregullua në sediljen e parë dhe i zgjati dorën shoferit përmbi kapakun e motorit, që i ndante.

— Si je, Sulë, si i ke nga shtëpia?

— Mirë duhet thënë, megjithëse dja'in e lashë pak të sëmurë. Me këta kalamajtë, hall kur s'i ke, hall kur i ke, sidomos pér ne që jemi vazhdimisht rrugëve.

Sa afroi dorën të timoni, shoferi ndjeu një erë të këndshme. Afroi pëllëmbën te hunda dhe e nuthati.

— Ohoho, qënke parfumuar! — tha duke buzëqeshur, pastaj kapi kokën e levës së marsheve dhe i futi të parin.

«Skoda» u shkëput nga vendi.

Edhe Bledari afroi pëllëmbën te hunda. Njohu parfumin e preferuar të Entelës. Si vetëtimë i ndritën në kujtesë sytë e saj gri në të kaltër, që i shkëlqenin mes qerpikëve të gjatë, nën vetullat e dendura e të lëvizshme. Sikur e ndjeu afshin e buzëve

të saj të trasha e të lëngshme, butësinë prej kadifeje
të lëkurës së saj ezmere, prekjen giciluese të flokëve
të saj të zinj e të gjatë, të lëshuar lirshëm mbi
supet e veshur me një bluzë ngjyrë ciklamini.

— Ti e di që nuk i përdor parfumet! — tha duke
bzëqeshur. — Por s'ka dy orë që u ndava nga e
fejuara në Tiranë. Helbete, duart e vajzave...

— I shkreti! — ia qau hallin me shaka Sula. —
Prandaj m'i paske varur buzët kështu dhe qenke hu-
tuar aq sa mezi më njohe makinën!

— Nuk është hera e parë që ndahem, ti e di.

— Hajde, mos u mundo kot të më dredhosh, se
i kam ngjitur para teje ato serpentina. Kur ndahesh
nga e fejuara, qoftë edhe për të njëqindtën herë, je
frenato!

— Po kur ndahesh nga gruaja? — e ngacmoi
Bledari.

— Varet. Ka grua dhe grua, burrë dhe burrë,
familje dhe familje.

— Edhe kjo nuk është përgjigje, por dredhi.

— Po të tregoj për vete, atëherë. Unë, more vë-
lla, kur ndahem jam frenato në të gjitha tamburot,
kur kthehem fluturoj me të pestin. Por dikujt i
ndodh edhe e kundërtat.

Sula vështroi një çast fotografinë format karto-
line që ishte ngjitur në xhamin kundruall. Picërroi
syty mendueshëm, pastaj ndërroi marshin dhe shtoi
shpejtësinë, sikur desh t'i largohej diçkaje.

Bledari e njihte atë fotografi, e dinte se gruaja
me tipare të holla e të ëmbëla, që i vështronte prej
saj me ca sy të mëdhenj, duke shtrënguar në krahë
një fëmijë motak, ishte gruaja e Sulës me të birin,
që u kishte lindur mbas shumë vjet martese. Befas
ata iu dukën njerëz të afërt.

— Sulë, si je martuar me mblesëri? — pyeti.

Shoferi ktheu kokën dhe Bledarit iu duk sikur e vështroi me një farë ngurrimi.

— Në daç tregoje! — nxitoi të thoshte. — Pyeta ashtu kot, pa ndonjë qëllim.

— E pse të mos tregoj? — Sula buzëqeshi. — Udhëtimi s'kalohet pa muhabet. Veç mos mërzitesh. Se unë jam njeri i thjeshtë, shofer hesapi! Edhe ndodhitë tona janë të thjeshta... Me dashuri jam martuar, shoku Bledar, madje me dashuri të madhe. Si ndodhi kështu, as unë nuk e kuptoj. Në rini kam qenë çapkën i madh. S'mblidhesha gjëkundi. S'lja dy gurë bashkë. Ku më zinte nata, s'më zinte dita. U bëra shofer, sepse më dukej që vetëm ky zanat i përshtatej kokës sime. Të afërmit dhe shokët thoshin se unë s'isha për familje. Por ja që doli ndryshe. U bëra familjar i përgjëruar për shtëpinë, meqë ky zanat... Vazhdimi shrrugëve, pesëmbëdhjetë vjet kështu. Ja djalin e lashë sëmurë dhe ika. Atje e kam mendjen.

— Mos u bëj merak, vetë the se s'kishte gjë me rëndësi! — deshi ta qetësonte Bledari.

— Po, po veç sonte mbrëma s'kam nge të pyes si u bë. Po të ishe prind, do të më kuptoje më mirë!

— Sula mori paqetën e cigareve «Porti» nga koshi mbi motor, ia zgjati Bledarit, pastaj ndezi me një dorë cigaren e vet dhe shfryu një vorbull tymi. — Filluan serpentinat e Benës! — tha duke ulur marshin: — Nuk tërheq mirë, ka rënë motori. Po u largova nga tema. Të mërzita?

— Jo, jo, të lutem!

— Një mbrëmje isha kthyer vonë nga udhëtimi dhe po shkoja në shtëpi. Megjithatë rrugëve të qytetit kishte njerëz. Ishte koha që dilte turni i dytë. Kur

u ktheva në rrugicën time më têrroqi vëmendjen një vajzë që nxiton te kokulur, pothuaj vravonte. I ishte qepur mbrapa një birbo dhe po e ngacmonte me fjalë. Më hipi gjaku në kokë. Çapkën isha, po kurrë s'u kisha rënë në qafë ashtu femrave. I arri ta, e hoqa qafe atë buku roshin, pastaj e shoqërova vajzën deri në shtëpi. Ajo ishte aq e shqetësuar, sa mezi fliste. E njihja që kur ishte e vogël, se banonte diku afër meje, por, siç ndodh rëndom me vajzat e lagjes, s'e kisha vënë re që ishte rritur dhe zbukuruar. Kështu filloj historia me Katrinën. Në fillim përshëndeteshim dhe shkëmbenim ndonjë fjalë kur takoheshim rastësish. Pastaj fillova t'i kërkoj rastet. Herë humbisja ndonjë rrugë, herë bëja udhëtime rekord, që të kthehesha kur delte ajo nga turni. Me një fjalë rashë brenda. Se si mblidhet lëmshi i kësaj pune ti e di, je vetë i fejuar. Me dashuri, apo jo?

— Po, po! — miratoi Bledari, ndërsa mendimi i fluturoi larg, në një ditë vere, pesë vjet të shkuara.

...Ai pushoi së notuari dhe lëshoi këmbët, gjersa ndjeu prekjen e butë të rërës. Ujët i arrinte gjer në gjoks. Sipërfaqja e tij përkundej lehtë dhe vezullonte me ngjyra të panumërtë, të argjëndta, kaltëroshe, të arta, të blerta. Flladi i lehtë ishte i ngarkuar me kundërmimin e detit. Duke ecur nga dalë, drejt bregut, ai ndiente me ëndje tek i përvëlonte shpinën dielli i nxeh të i korrikut dhe tek i lëpihej ujët në trup, ndërsa dilte gradualisht prej tij. Vështron te atë mori njerëzish me trupa të nxirë që zhyteshin, delnin sipër, kërcenin përpjetë, luanin me top, vozisnin dhe që dallonin nga njëri-tjetri më shumë prej kapuçave apo kostumeve të banjës. Bashkë me llapashitjen e ujit dëgjonte fragmente bisedash, klithma gazmore, të qeshura. Ndihej pak i lo-

dhur; por ishte një lodhje e këndshme, prehëse, që e bënte ta ndiente gjallë çdo muskul të trupit të vet.

Befas e goditi në zverk një top llastiku, që ra sakaq pranë tij, duke lodruar mbi ujë, sikur qeshte me çapkënllékun që bëri. Ai ktheu kokën dhe pa tek zbardhnin ca dhëmbë të rregullt e të mëdhenj në fytyrën e një vajze. Sytë e saj vezullonin si stërkalat e ujit.

— Më falni, pa dashur! — tha ajo.

— S'ka gjë, ndodhi e zakonshme në det! — Ai ia hodhi topin dhe vazhdoi rrugën. Mbas pak ndjeu përsëri një goditje në shpinë. Mbi ujë lodronte i njëjtë top.

— Përsëri pa dashje? — u zemërua ai.

— Si ndryshe? Ndodhi e zakonshme në det!...

Bashkë me gojën dhe sytë bojë deti, asaj sikur i qeshte dhe hunda e vogël e kthyer pak përpjetë.

— Nga i njëjti top?

— Nuk kemi tjeter. Sa të ndodheni brenda ujë-rave tonë territoriale, ju kërcënon i njëjti rrezik. Ju paralajmërojmë, që të mos kemi keqkuptime. Po bëjmë qitje dhe ndodh që gabojmë shenjë!

— Unë s'e besoj të gaboj. Sapo kam mbaruar stërvitjen gjashtëmuore.

Ai mori shenjë dhe goditi, por vajza u zhyt krejt dhe topi kaloi përtej, duke kërcyer disa herë mbi ujë. Ajo doli mbi sipërfaqe dhe qeshi me të madhe, ndërsa bulëzat e ujit i vezullonin në vetulla e në qerpikët e gjatë.

— Nuk paskeni bërë qitje detare! Megjithatë për kushte tokësore, shënuat mirë. Doni të provoni përsëri... që të lani edhe hakun?

Atij jo vetëm që i kishte kaluar inati, por tanë i vinte keq të largohej.

— Jo, faleminderit, nuk jam hakmarrës, sidomos karshi vajzave. Pranoj të qëlloj vetëm me një kusht: në më pranofshi në lojë me të drejta të barabarta.

— Unë jam dakord. Vjollca, Fatmir, ta pranojmë?

— Po, po, bëhemë dy me dy.

Ai u afroa. Ngriti dorën dhe tha me seriozitet të shtirur:

— Ushtar Bledar Guri gati për luftim!

Vajza me sy bojë deti i zgjati majat e gishtërinjve të lagur dhe iu paraqit:

— Bashkëluftëtarja juaj, Entela. Emrat e kundërshtarëve sapo i dëgjuat.

— Ka diçka fyese në zakonin e disa femrave, që paraqiten vetëm me emër! — tha ai, me një ton që të mos e zemëronte. — Sidomos, kur e cilësojnë veten bashkëluftëtare. Në këtë mori njerëzish mundet që edhe ndonjë tjetër t'i përgjigjet emrit Entela.

— Nuk përjashtohet rasti që të ketë edhe ndonjë Entela Koni tjetër! — tha ajo.

— Paskam bashkëluftëtare të shkathët! — vërejti ai, buzagaz, duke e flakur topin në drejtim të kundërshtarëve.

Goditi në shenjë dhe u brohorit fort nga shoqja.

Ata nisën të luanin me shkathtësinë dhe hovin që u diktonte mosha dhe ajo ditë dehëse plazhi, gjatë së cilës shpérthenin bashkë drita dhe hareja, stërkalat dhe forca, nxehësia dhe gjëzimi. Dolën nga ujët vetëm kur i ndjenë gjymtyrët të këputura dhe lëku-

rën gjithë mornica. Kapërcyen gardhin lëvizës të shëtitoreve të buzëdetit dhe u lëshuan me èndje në rrëren përvëluese.

— ... Uh, tani e ndjej lodhjen! — tha ajo, ndërsa gjoksi i dërdhur vazhdonte t'i hovte dendur. — Thatë se jeni inxhinier pyjesh?

— Po.

— A është shumë larg stacioni pyjor ku punoni?

— Jo aq sa kujtojnë ata që s'kanë qenë. Ju thatë se bëni vitin e tretë në arte, po në ç'fakultet?

— Në të pikturës!

— Aha, qenkeni piktore!

— Dëshiroj të bëhem. A janë të bukura ato pyjet tuaja?

— Të bukura janë. Por ne që jetojmë vazhdimisht mes tyre, sikur jemi mësuar me atë bukuri dhe s'na bën fort përshtypje.

— S'kam parë asnjëherë pyll të vërtetë... A ka arinj atje?

— M'i kanë treguar gjurmët e tij.

— Po luleshtrydhe?

— Në korrik lirishtet kuqëlojnë prej tyre.

— Oh, sa kam dëshirë t'i shikoj pyjet tuaj! Atje duhet të ketë një larmi të pafundme ngjyrash... E blerta e mbyllur e bredhit, e kuqja e luleshtrydhevë, e blerta e çelur e livadheve, grija e murme e shkëmbinjve, e bardha e reve, e kaltra e fortë e qieillit... ç'simfoni e mrekullueshme ngjyrash! Dhe të gjitha këto në një atmosferë të pastër, transparente, të kristaltë... Oh, sa kam dëshirë t'i shikoj pyjet! — Ajo fliste me sy të picërruar sikur desh të projekton te në ekranin e qepallave vizionin e mendimit të saj.

— Po të jetoni mes pyjeve, a do t'ju pëlqente?
— E pse jo?

— Atëherë martoju me një inxhinier pyjesh! —
bëri shaka shoqja e saj.

Entela e vështroi me qortim.
Kështu filloi...

Ushtoi buria e «Skodës». Sula i ra gjatë, me
ndërprerje të shkurtëra si në shënjtë përshëndetjeje.

— Uh! — psherëti duke zgjatur dorën nga pa-
qeta e cigareve. — Shyqyr që mbaruan. Janë kthesa
të forta dhe të mbyllura. Sa herë kaloj këtej e ma-
llëkoj atë inxhinierin që e ka projektuar. Ju inxhinie-
rat duhet të mateni shumë kur e vini lapsin në
letër

— Ke të drejtë! — tha Bledari duke i zgjatur
shkrepsen e ndezur. — Shyqyr që e hape gojën!

— Ma kyçën kthesat! — u justifikua Sula. —
Apo nuk ecin disa prej nesh si të tèrbuar dhe nuk
mbajnë as krahun. Një herë ndodh e keqja. Kemi
edhe fëmijë pér të rritur, shoku Bledar! — Ai bu-
zëqeshi dhe i hodhi përsëri sytë nga fotografia përba-
llë. — U bëmë me fëmijë pas dhjetë vjetësh mar-
tese. Por më mirë vonë se hiç!

— E paç me jetë, edhe me një vajzë! — uroi
Bledari. — Apo e do përsëri djalë?

— Jo, jo, s'jam me paragjykime unë! Aq më
tepér tani, që e sigurova një ushtar pér Republikën!

— A bëre dasmë të madhe, kur u martove? —
buzëqeshi Bledari.

— C'dasmë more! Mezi ma dhanë se më kishte
dalë nami pér çapkën. Por në të vërtetë e kishin
hallin edhe gjetkë, se ishim gjoja me besime të ndry-

shme. Çerdhen e ngritëm në një kthinë që kishte si pajisje vetëm inventarin e fjetjes të «Skodës» sime.

Bledari ktheu kokën instinktivisht nga shtrati i varur i kabinës.

— Jo, jo, nuk janë ato! — buzëqeshi Sula. — Katrina ma ka rregulluar dhe pajisur këtë shtrat, si të ishte i hotel turizmit. Ç'e do që s'e mbaj dot, shofer hesapi! M'i lan pothuaj mbas çdo udhëtimi. Kur ishte shtatzënë m'i lanin motrat e saj.

— Ka shumë motra?

— Bashkë me timen bëhen pesë, pa vëlla.

— Qenke si veshkla në mes të dhjamit në shtëpinë e vjehrrës!

— Gjynah të qahem! — tha Sula. — Më duan si vëlla e si djalë. Po tëndja ç'nerëz ka?

— Vetëm prindërit. Është vajzë e vetme.

— Obobo, pisk e paske! Nuk të kanë propozuar të hysh dhëndër brenda?

— Jo ende! — tha buzagaz Bledari, por i sëmbuan këto fjalë, sepse i vajti mëndja te biseda që kishte pasur me të vjehrrën atë mëngjes.

...Po pregatitej të dilte bashkë me Entelen, që do ta përcillte në stacion të trenit, kur ia behu ajo me torbën plot. Kishte bërë pazarin e së dielës.

— Si kështu, po ikën, Bledar? — pyeti duke zgjidhur shaminë e leshtë të kokës. Flokët e bardhë i bënин kontrast me fytyrën ende të freskët dhe me sytë e gjallë si të së bijës.

— Për dy orë niset treni! — tha ai.

— Trenat shkojnë e vijnë! — tha ajo. — Rri për drekë. Kam çuar në furrë një byrek të mirë me mish e me spinaq, siç të pëlqen ty. Në s'ma prishtë furrtari ke për të lëpirë gishtërinjtë.

— Duhet tē nisem patjetër! — nguli këmbë ai.
— Kam lënë një çështje tē ngutshme pezull.

— Eh, kjo punë, hajde e ik gjithmonë! Kur do tē mbarojnë këto kusuret tona?

— Ndoshta asnjëherë! — Ai u mundua tē bu zëqeshte. — Dhëndërin e kini zgjedhur inxhinier pyjesh.

— Dhëndërin e kemi zgjedhur goxha djalë. Nuk është e thënë tē bredhë gjithmonë pyjeve, se është inxhinier pyjesh.

— Në Tiranë, përveç gjelbërimit tē parqeve, s'ka pyje! — theksoi ai.

— Edhe i biri i Mihalit, inxhinier pyjesh është, por i dhanë goxha vend, në fakultet! — vazhdoi ajo, duke u lëshuar në minder, me duart kryq në pëqi.

— Se mos është më i zoti nga ti!

— Kjo u takon tē tjerëve ta gjykojnë! — vërejti ai.

— Posi! Fajin e ka im shoq, Petroja, që nuk interesohet. Ai ka plot shokë, një fjalë t'u thotë dhe...

— S'është nevojë tē bezdiset xha Petroja më tilla punë. Besoj se edhe ai nuk lakmon një dhëndër që ta mbajë për krahësh!

— Mos fol marrëzira, Bledar! Ti mbushe pesë vjet pyjeve, mjaft më, e lave borxhin. Le tē çojnë tē tjerë tani. Sa tē kthehet Petroja nga jashtë, pa e di unë... Një vajzë kemi.

— Vajzën në shtëpi e kini! — vërejti ai me ironi.

— Gjysmën kam, dhe një gjysmë që e bren mali! — u mundua ta ndreqte ajo. — Tani u plakëm dhe s'u ndjekim dot pas.

— Duhet tē nisem, u vonova! — e ndërpree ai, duke veshur pallton.

— Entela, e ke qerasur tē paktén me gjëkafshë? — brofi ajo. — Si, moj, harrove!

— Në shtëpinë e tij njeriun s'është nevoja ta qerasin, apo jo? — tha ai.

— Sidoqoftë... Kam një reçel tē mrekullueshëm, reçel arrash!...

Ai e përlau me dy lugë reçelin, u detyrua tē ulte ballin, që ta puthte e vjehrра dhe doli bashkë me Entelën. Reçeli dhe biseda i kishin lënë një gjurmë tē hidhur në gojë...

... Rruga ishte në zbritje, kthesat tē rralla e tē hapura, prandaj Sula i kishte futur tē pestin dhe po fishkëllente lehtë një melodi popullore. Në krahun e Bledarit parakalonte një luginë e thellë, gati humnerë, në fundin e së cilës gjarpëronte si shirit metalik lumi. Aty-këtu, buzë tij, dukej ndonjë shtëpi e veçuar si kuti shkrepseje me një copë arë përbri. Në tē dy anët e luginës ngriheshin faqe tē thepisura, shkëmbore, tē murrme, me njolla tē rralla gjelbërimi. Shtyllat e tensionit tē lartë tē rrjeshtuara térthorazi luginës, tē kujtonin përbindshat e lashtësisë.

«Si kanë mundur t'i ngjitin në këto maja?» — mendoi Bledari.

— Inxhinier u bukose fare! — tha Sula. — Na fol diçka, se s'kalohet rruga pa muhabet. Boll mendove për tē fejuarën se, siç thotë kënga,jeta ndarje ka. Ndarje, pastaj takime. Edhe kjo ka bukurinë e saj. Nganjëherë i them Katrinës me shaka: më mirë që s'më ke vazhdimisht pranë, se do tē tē isha mërzitur dhe s'do më doje kaq shumë.

— A mërzitet vetëm? — pyeti Bledari.

— Tani është mësuar diçka se, helbete, u bënë 10 vjet kështu, por në fillim mërzitej shumë. Merrmë me vete, thoshte, nuk tē bezdis shumë, ti fli në

shtrat, unë në sediljen e parë. Je në vete, i thoshja, e di ti q'vështirësi ka jeta e shoferit? S'ka gjë, thoshte, le të jetë vështirë sa të dojë, mjafton të jemi bashkë. Punë që s'bëhet dhe pikë, ia mbyllja. Megjithatë lëshova pë disa herë. Parvjet më caktoi parku tre muaj tranzit te Maja e Keqe. Iu luta sharrës për një barrakë dhe e mora Katrinën. S'e merr dot me mend sa bukur kaluam!

— Tani që u bëtë me djalë e ka më lehtë! — tha Bledari.

— Ashtu është, por e kam unë më vështirë! — buzëqeshi Sula. — Ajo mendon dhe përmallohet për një, kurse unë për dy.

Përtej një kthese ngriti dorën një burrë me trecerekshë lëkure, me shenjë të kuqe në krah. Sula mbajti krahun, frenoi dhe çeli derën. Kontrollori u afroa dhe përshëndeti thatë. Kishte një fytyrë të rrumbullakët, të kuqe dhe sy të vegjël, të vrenjtur.

— Fletudhëtimin, dhe biletën, ju lutem!

Bledari nxori nga xhepi i vogël biletën dhe ia shtoi fletudhëtimit të Sulës. Kontrollori i shqyrtoi me vëmendje dhe më gjatë nga c'ishte e nevojshme, pastaj ua ktheu duke mërmëritur:

— Në rregull, kaloni!

Përshëndeti me dorë dhe u tërhoq në pritë.

— Ky njeri sikur pezmatohet kur të gjen në rregull! — tha Sula me mllef, ndërsa «Skoda» rifilloi udhëtimin.

— Të duket ty, se do ta kesh inat! — qeshi Bledari.

Jq, se unë ndeshem me plot të tillë rrugëve, por ky ha bulkë vec. Për gjendjen teknike dhe rregullat e qarkullimit, që kanë të bëjnë me jetën, s'para

bëhet merak, letrat dhe biletat kontrollon. Një gabim i vogël dhe... procesverbal!

— Mos duhet të bëjë lëshime që të jetë i mirë?

— Jo, more vëlla, nuk them ashtu, por gjella me kripë e kripa me karar. Ja, dëgjo një rast. Një mbrëmje mora dy arsimtare në Majën e Keqe. S'kisha bileta me vete, po a lihen dy femra në mes të rrugës, natën? Pa mendoje si për motrën, apo për gruan tënde! E hoqi dreqi dhe më doli përparrë ky. Si zakonisht: biletat! Ato të ngratat ia treguan si qe puna, po hante arsyë ky se? Procesverbal! Se mos vetëm ai ka ndërgjegje socialiste!

— Gjynah që nuk ka ndonjë matës të ndërgjegjes, si tubi për pirjen e alkoolit! — bëri shaka Bledari. — Atëherë do të mënjanoheshin këto keq-kuptime.

— Ja, më duket se përsëri po na dalin përparrë arsimtaret! — tha Sula, duke bërë më kokë nga hyrja e urës së madhe, ku qëndronin dy vajza me çanta udhëtimi, njëra prej të cilave ngriti dorën. — Si thua, t'i marrim?

— Ke bileta? — qeshi Bledari.

— Kam, por do të na prishin muhabetin.

— S'ka gjë. A lihen dy vajza në mes të rrugës, buzë natës?

— Ah, inxhinier, ma hodhe! — Sula tundi kokën me qortim dhe frenoi.

Bledari deshi t'i lironte vendin e parë ndonjërsës që e zinte makina, por ato nuk pranuan. Preferuan të uleshin në të dy sediljet e pasme; sepse kështu jemi krah njëra-tjetrës dhe e kemi më të volitshme të bisedojmë, pa e shtrembëruar qafën», tha ajo e gjata me bishtaleca.

Ndërsa rëmonin në kuletat e tyre të vogla për

të paguar biletat, s'pushonin së falënderuari që i morën. Kishin kaluar shumë automjete tek ura, por i kishin vendet e zëna. Që të dyja dukeshin fare të reja. Sapo u nis makina, ato u zgjatën drejt njëra tjetrës, duke mbështetur bërrylat mbi kapakun e motorit dhe nisën të pëshpërisnin vesh më vesh.

«Vajzat si vajzat, më!» — mendoi Sula duke buzëqeshur, ndërsa i shikonte kokë më kokë, nëpërmjet të pasqyrës së kabinës.

Bledari u lthyte dhe i vështroi me vëmendje.

— Diku ju kam parë! — nxitoi të thoshte, që të mos ia keqkuptonin vështrimin.

— Në Tiranë, te stacioni i trenit! — tha e gjata.

— Ju shoqëronte një vajzë e lezetshme! — shtoi ezmerja.

— Po, pikërisht në stacion! — u kujtua Bledari.

— Motra ishte? — pyeti e gjata.

— Jo, e fejuara.

— Për ju po bisedonim! — tha ezmerja. — Sapo hipëm, ju njohëm. Sa të mirë që e kini të fejuarën! Dhe ishte e veshur me shumë shije. Atë bluzën ngjyrë ciklamin, vetë e ka thurur?

— Nuk e di! — dredhoi Bledari. Mendoi se Entelës ia bënин të gjitha gati prindërit.

Zhurma e motorit u shtua, shpejtësia e makinës ra. Kishin filluar të përpjetat e Gëzinës.

— Nuk tërheq! — përsëriti Sula, duke i futur të dytin.

Biseda u ndërpre. Jashtë po ngrysej. Asfalti dukej pothuaj i zi. Gjethet e degëzat e drurëve buzë rrugës nuk shquheshin mirë. Fundet e luginave ishin kredhur në mugëtirë. Kreshtat e dhëmbëzuara të maleve dukeshin më të ashpra e më të largëta. Një makinë që vinte përballë ndezi dritat.

Bledari kishte ndezur një cigare dhe po mendonte. Biseda me Sulën, ritakimi me arsimtaret, zhurma monotone e motorit dhe errësimi i pamjeve e nxitën të kujtonte bisedën e fundit me Entelën...

... Kur po kalonin para pasticerisë «Flora», lokalit të tyre të preferuar, ajo i tha duke vështruar orën:

— A pushojmë pak këtu? Ka kohë për trenin.

Hynë në lokal dhe instinktivisht kërkuau vëndisa ku uleshin zakonisht. E gjetën të lirë, se ishte kohë dreke. Zunë vend në kolltukë, por që të dyve sikur u qe kyçur goja dhe ngelën të heshtur përbalë njeri-tjetrit. Atij iu duk shpëtimtare ardhja e kamerieres, që i dha shkas të fliste.

— Një kompekaq dhe një ekspres, me sheqerin në lugë!

Ndërsa po largohej kamerierja, duke thënë në mënyrë profesionale «si urdhëroni», ai u tremb se mos heshtja pllakoste përsëri.

— Nuk e di pse më duket e ndryshme nga të tjerat kjo ndarja e sotme! — foli Entela, duke e lënë mënjanë çantën, që e kishte trazuar kot gjatë heshtjes. — Sikur ndërmjet nesh ka hyrë diçka jo e mirë!

— Të duket! — tha ai.

— Bledar, ne kemi kaq kohë bashkë dhe s'mund të na duket diçka e paqenë... Nuk dëshiroj të ndahemi kështu... Vërtet, a mund ta shtysh për nesër? — Në zërin e saj kishte shumë lutje.

— Nuk mundem! — tha ai me keqardhje të sinqertë. — U kam dhënë fjallën sharrëxhinje. Tekniku i pyjeve s'u jep damkë pa qenë unë dhe ata do të mbeteshin pa punë.

— Duhet të shkojë pa tjetër inxhinieri për të

caktuar se ç'dru do të pritet? — pyeti ajo me një buzëqeshje të lehtë, ironike.

— Ndoshta ty kjo të duket qesharake, por...

— Jo, jo, unë nuk i di mirë këto gjëra! — nxitoi e tha ajo.

— Duhet t'i dije tashmë, se je prej tre vjetësh e fejuara e një pylltari.

Ajo u skuq dhe uli kokën. Që të merrej me diçka, nisi të hante ëmbëlsirën, por kafshatat sikur i ngeleshin në grykë. Lëshoi pirunin dhe ngriti vështrimin.

— Të kujtohet sa çaste të bukura kemi kaluar këtu? — tha, ndërsa sytë i zunë një cipë të lëngët.

— Harronim ku ishim, na ftohej kafeja, na shkrinte akullorja në kupë, harronim orën dhe ëndërronim për të ardhmen, për kohën kur do të ishim gjithmonë bashkë dhe nuk do t'u ruheshim syve kureshtarë. Ja, tani jemi bashkë, por jo ashtu siç ëndërronim.

— Ne e kemi në dorë t'i japim fund kësaj! — tha ai.

— Si? — sytë e saj u zmadhuan nga kureshtja.

— Merr plaçkat dhe eja me mua. Celebrimin e kemi bërë. Atje s'do të na lenë jashtë, të siguroj.

— Po tallesh, Bledar! — tha ajo, e zhgënjer.

— Aspak! — u acarua ai. — Pse këtë propozim e ke quajtur herë të nxituar, herë të pamundur, kur se sot e merr për tallje? Dikur thoshje se të pëlqejnë pyjet, se të pëlqen të jetosh atje, por gjatë këtyre tre vjetëve nuk gjete kohë, në mos për të parë pyjet, për të shikuar se ku jeton dhe punon shoku yt i jetës.

— Më thuaj singerisht, vërtet të pëlqen të vij atje? — deshi të bindej ajo.

— Unë singerisht kam folur deri tani.

— Hm... Një shtëpi prej druri në mes të pyllit, zjarr në vatër, plot kalamaj rretheqark, një derr në koçak, disa puli, çizmet me baltë... — Ajo fliste ngadalë, me sy të perënduar, gjoja me romantizëm, me gojë të shtrëmbëruar nga një buzëqeshje e hidhur.

— Ti po tallesh! — e ndërpree ai me zemërim. — Nuk të detyroi kush të lidhje jetën me një inxhinier pyjesh, prandaj sa nuk është vonë...

— Bledar, ç'flet kështu! — tha ajo, me sy të çapëlyer, gati për të shpërthyer në lotë. — Të lutem, thuaj se nuk e kishe seriozisht, edhe në mos qoftë kështu, gënjenjë. Nuk mund të mbetem me kujtimin e këtyre fjalëve.

— Njeriu, kur nxehet flet edhe ndonjë gjë të tepërt! — tha ai, disi i zbutur. — Megjithatë, Entelë, pate të drejtë kur the se ndërmjet nesh ka hyrë diçka jo e mirë. Sepse ti ke ndryshuar. Të gjithë ndryshojmë, por ti s'ke ndryshuar për mirë. — Ai deshi t'i përbëlindhte qartë mendimet e tij dhe për të fituar kohë gjerbi ngadalë ekspresin e ftohur. — Ti kujtovë me nostalqji bisedat tona të bukura në këtë lokal. Kujtoi mirë ato biseda, kujto ç'thoshje, ç'en-dërrroje, ç'dëshiroje dhe krahasoi me botën tënde të sotme. Ti ëndërrroje atëherë që, me shokun e jetës për dore, të ngjiteshe bjeshkëve, të çaje më gjoks dallgët e detit, të bridhje kantiereve, fushave, të njihje vendin, njerëzit, jetën dhe të frymëzoheshe për pikturna të bukura. Ti thoshje atëherë se artisti duhet ta ketë gjoksin aq të gjerë, sa të nxejë brenda detin me tallaze. Ti urreje lëkurën e butë, duart e bardha, buzët e kuqe dhe parfumet. Ti dëshiroje të piye ujë te burimi me buzë të plasaritura nga mundi i punës; dëshiroje të të vinte erë pishë, erë kripë deti, erë dhë; ti dëshiroje të vishje pan-

tallona doku, këpucë me gozhdë, të bridhje shtigjeve partizane dhe të bëje një portret të Zonjës Çurre, me frymëzimin e një femre... Janë fjalët e tua këto, apo egzaltime të përkohshme rimore? I mbaj mend mirë, sepse për ato mendime e dëshira të dashurova më tepër se sa për sytë e bukur dhe për trupin e derdhur...

Ajo kishte shtangur përballë tij dhe dukej sikur me të gjithë qenien e saj i përpinte ato fjalë. Sytë e saj, të thatë, me bebëzat e zmadhuara, të vëmendshëm e pak të habitur, qenë ngulur në sytë e tij.

— Po sot, për se èndërron? — vazhdoi ai, duke thithur me afsh cigaren. — Që të transferohem unë në Tiranë, që të sigurojmë një apartament të mirë, që të bësh me porosi mobilje moderne, që të vi-shesh me fantazi, që të bësh kopertina të rëndomta librash dhe piktura ku pyjet, që s'i ke parë, kanë të gjitha ngjyrat e ylberit, përveç ngjyrës së tyre të vërtetë... Pa mendo për të gjitha këto. Nuk ka nevojë të më thuash asgjë sot. Bëje këtë punë pa dëshmitarë, bile edhe pa mua, sepse të qëndruarit karshi vetvetes është i dobishëm, madje i domosdoshëm. Besoj se do të arrish ta gjesh se ç'ka ndryshuar te ti. Jam i bindur se do ta gjesh, mbasi fjalët e tua të atëhershme s'mund të kenë qenë të shtirura. Bashkë me to unë mbaj mend edhe shprehjen e syve të tu, edhe timbrin e zërit tënd. Ti je ajo e atëhershmyja, jo kjo e sotmja. Duhet çarë lëvozhga e hidhur, duhet flakur, sa pa u krimbur thelbi. Këtë lëvozhgë duhet ta çajmë bashkë. Unë kam faj që s'të kam folur kështu si sot edhe herë të tjera. Shijetat e helmatisura që kemi shkëmbyer nuk i shërojnë plagët, por hapin plagë të reja. Unë do të

mendoj edhe për vete... Tani të dalim se do të më ikë treni.

Kur u gjendën në rrugë, ai e zuri për krahun dhe ia shtrëngoi lehtë me dhembshuri. Ajo i afroi kokën te supi, thua jse desh ta mbështeste atje.

«Kjo është një furtunë!» — mendoi ai. — «Por pas furtunës del kohë e mirë!»

— Sa çift i goditur! — i tha shoqes një plakë që kalonte përbri.

Ata e dëgjuan.

— Thua të jetë e vërtetë? — pyeti ajo.

— Sigurisht që është e vërtetë! — iu përgjegj ai, duke i shtrënguar rishtas krahun. — Dhe ka për t'u bërë akoma më e vërtetë...

... — Sa errët që është jashtë! — tha arsimtarja që rrinte mbrapa Bledarit.

Ai vështroi nga dritarja anësore. Jashtë brezit të dritave të makinës nuk dallohej asgjë. Iu duk sikur, po të mos ishte xhami, errësira do të vërvshonte brenda në kabinë, si një llavë e zezë.

— Vërtet shumë errët qenka! — tha.

— Më mirë kështu! — foli arsimtarja tjetër, ajo e gjata. — Nuk duken humnerat. Kur më takon të udhëtoj buzë tyre ditën, më merren mendtë.

— Nga frika, si duket! — tha Bledari me shaka.

— Ndoshfa! — pranoi ajo.

— Po të ecësh me mend në kokë udhëtimi natën është më i sigurtë! — tha Sula. — Dritat duken që larg, kurse buria... Ju, ku do të zbrisni?

— Te Shkëmbi i Zi! — u përgjigj ezmerja.

— Ku do të shkoni kaq vonë? — ua qau hallin Sula, duke parë orën e dorës.

— Shkolla është pothuaj buzë rrugës. Aty banojmë! — tha e gjata.

Arritën atje pas gjysmë ore. Bledari kërceu poshtë dhe i ndihmoi të zbrisnin. Ato falënderuan, u uruan rrugë të mbarë dhe filluan të ecnin me kujdes nëpër një shteg poshtë shpatit duke përdorur një dritë me bateri.

Frynte erë bjeshke dhe bënte ftohtë. Bledarit i shkuan mornica në trup, por nuk u fut në kabinë. Ngriti jakën e xhaketës dhe priti, duke ndjekur drithën e vockël që zbriste si ndonjë xixëllonjë më të poshtë. Sytë filluan t'i mësoheshin në errësirë dhe sikur shquante atje poshtë një pullaz të gjatë, sigurisht të shkollës. Dritëza iu afrua pullazit, pastaj sikur u kthyte nga ata dhe u fik e u ndez disa herë. Bledari buzëqeshi i kënaqur dhe u fut në kabinë. Ajo iu duk e shkretuar, sikur të ishin larguar disa njerëz të afërt.

— Vajza për t'u admiruar! — tha Sula. — E di ç'do të thotë që në moshën e tyre të vish nga Korça, apo Gjirokastra për të mësuar fëmijët e Shkëmbit të Zi? Prandaj ne shoferët s'i lëmë kurrë në rrugë arsimtaret e fshatit. Një shoku ynë ia bëri hundët përslesh dikujt që shpifi për këtë.

Rruja tani ishte e shtruar dhe «Skoda» gjallabëronte me shpejtësi brezin e zi të asfaltit. Bledari pinte cigare dhe shoqëronte me hamendje arsimtaret.

...«E gjata ndez zjarrin, tjetra nxjerr nga çanta dhe shtron në tryezë bukën, sallamin dhe djathin... Sigurisht do të pregatisin edhe çaj ose kafe. Një kafe e fortë të bën mirë pas udhëtimit... Po ujë, a kanë? Ndoshta burimi është larg dhe tani, natën... Sigurisht kanë ndezur radion. Në vende të tilla ra-

dioja është baras me një shoqe të mirë... Vallë, për se bisedojnë tanë? Për mua dhe Sulën? Sa i marrë, por ne s'qemë veçse bashkudhëtarë të rastit! Sikur s'kanë ç'të kujtojnë tjetër! Ndoshta edhe ato janë ndarë prej dikujt. Si unë prej Entelës... Po Entela ç'bën në këtë kohë? Mendon për bisedën e sotme? Është e shqetësuar? S'ka gjë, le të shqetësohet, e vlen! Duhej bërë kjo bisedë, bile më parë. E ëma ka shumë faj. Ajo e ka përkëdhelur tepër. Edhe xha Petroja ka faj. Ai s'do t'i ketë vënë re këto ndryshime, se ka shumë punë dhe është mysafir në shtëpi, por kjo nuk e justifikon. Ndoshta do të jetë e nevojshme të bisedoj me të. Por Entela ka për ta kuptuar vetë, sepse në thelb është ajo që ka qenë. Prandaj e dashurova. Dhe vazhdoj ta dua... shumë bile. Mos u mërzit, Entelë, retë e murme do të davariten. Ti e ke në dorë... Jo, ne e kemi në dorë...»

— Ku do të hamë darkë, në qytezë apo në sektor?
— pyeti Sula.

— Ku të duash! — tha Bledari.

— Më mirë në sektor. Na bën Vata një biftek të mirë, marrim një gotë raki te Staka dhe kënaqemi. Atje na kanë më në kimet.

— O burra, pra!

Bledari u shkëput si me çelës nga mendimet dhe fijet që e lidhnin me ç'kishte lënë pas. I dukej sikur ndodhej që tanë në sektorin e shfrytëzimit, në men-sën zhurmëmadhe midis sharrëxhinjeve. U ndje i leh-tësuar, i gjallëruar dhe këtë e shprehu duke hovur në sedilje.

* * *

Ishte buzëmbrëmje, po ende jo koha kur kthehen sharrëxhijtë nga puna. Nëpër shtegun që të çonte në sektor po zbrisnin dy burra. Ai që printe ishte i gjatë, i lehtë, me tipare të mprehta dhe sy të zgjuar. Mbante peliçë sharrëxhinjsh me gëzof, pantallona kadifeje dhe opinga. I dyti ishte i shkurtër, i shëndoshë, pasigurtë në zbritje, me tipare të rrumbullakta dhe lëkurë të trëndafiltë. Mbante xhup lëkure treçerekësh të qepur bukur, pantallona teritali të trashë dhe këpucë me gozhë. Krahëqafë kishte varur një çantë me trajtë të pazakontë. I pari ishte përgjegjësi i sektorit të shfrytëzimit të pyjeve, Ndrecë Marku dhe tjetri, operatori i radiotelevizionit, Fredi Mushqeta.

Shpati ku dredhonte shtegu ishte pothuaj i zhveshur, zhurrishtë, me shkurre të rralla boshtre e dëllinje, por anash dhe karshi ngriheshin faqe me pishnaja të shfrytëzuara. Në kulmet dhe brinjët e tyre pishat e moçme dukeshin, në sfondin e plumbtë të qiellit me re, si çadra gjigande. Poshtë, aty ku përrroi që shkumbëzonte rrëzë shpatit bënte bërryl dhe lugina zgjerohej pak, dukeshin si në maket barrakat e sektorit.

— Edhe sa duam të arrijmë? — pyeti Fredi, duke ia bërë me kokë andej.

— Ndonja gjysmë ore, me hapin tënd! — iu përgjegj Ndrecëa.

— Sa lirshëm që ecën ti, Ndrecë! E hedh hapin me kaq siguri, sikur shkel në trotuar. Kurse unë shkel si mbi vezë. Më duket sikur do të rrokuillisen

gurët ku vë këmbën. Bëra dy javë këtu dhe s'u mësova dot.

— Ne jemi mësuar me këto shtigje, shoku Fredi, se hapat e parë në to i kemi bërë, kurse në trotuare nuk dimë të ecim. Unë atje lodhem më shumë. Janë krejt rrafsh. Mërziten edhe muskujt.

— Ishalla arrijmë në sektor me dritë! — tha Fredi, duke vështruar horizontin që po ngrysej. — Mua edhe errësira më mungon!

— Mos vështro nga qilli, se të vriten sytë dhe pastaj nuk sheh! e këshilloi Ndreca. — Vështro vetëm shtegun.

— Paske përvojë interesante!

— Është përvoja e babës, e gjyshit!

— Sot kemi bërë goxha punë! — tha operatori.

— U lodhe, besa!

— U lodha, por ia vlejti! Me kaq e përfundova filmin pér ju. Besoj se ka pér të dalë i mirë.

— Patjetër që do të dalë i mirë! — e përforcoi Ndreca, me bindje të singertë. — Ju kini bërë shko llë pér këtë punë, kini përvojë dhe ata që ju dërguan këtu...

— Brigadë e zonja ajo që filmuam në fund! — e ndërpreni Fredi.

— E Vukë Marashit? Posi. Ata janë të fortë dhe punojnë fort.

«Vërtet, të fortë! — mendoi Fredi, duke kujtuar disa nga kuadrot që kishte parë nëpërmjet objektivit. «Punë e vështirë t'i mëshosh sëpatës dhe të luash trupat me capinë gjithë ditën. Dhe sa të rëndë që e kanë atë sëpatë! Kurse capina qënka një levë e mrekullueshme. Po t'ia kishin gjetur atë pikë-mbështetjen e Arkimedit, një e tillë do t'i duhej pér të lëvizur botën nga vendi... Prej sa vjetësh tha

Vuka që është sharrëxhi, tridhjetë? Bobo, tridhjetë vjet e njëjtë punë, e vështirë! Si qëndrojnë xhanëm, si nuk lodhen, si nuk mërziten? I mban ushqimi dhe klima.»

— Të na lajmërosh kur të jepet filmi! — tha Ndreca. — Ndodh që kthehemë të lodhur nga puna dhe biem herët. Por, atë mbrëmje do të mblidhem pranë televizorit, në këndin e kuq, dhe do të presim, qoftë edhe sikur të jepet mbas lajmeve të fundit.

— Patjetër që do t'ju lajmëroj! premtoi Fredi.

— Sharrëxhinjtë tanë do të shikojnë veten dhe do të gëzohen!

— Do t'i shikojë gjithë Shqipëria!

— Ty të lumshin këmbët që erdhe! — tha Ndreca.

Në shpatin karshi feksi një dritë. Ajo dukej dhe zhdukej, duke zbritur më të poshtë.

— Po ardhka një «Skodër» për ngarkesë! — u gëzua Ndreca. — Por s'ka për t'i gjetur punëtorët e ngarkimit në skele. Do edhe gjysmë ore të mbërrijë.

— Kaq shumë?

— Leqet e Majës së Keqe nuk kanë të mbaruar. Më shpejt zbret më këmbë se me makinë. Brigadës së ngarkesës do t'i duhet të dalë rishtas mbas darke.

— Sonte? Por s'janë për t'u ngarkuar dengje pambuku! — vërejti Fredi.

— Ashtu, vërtet, ka diçka rrezik, por s'mund ta lemë të presë deri nesër. I kemi si ujët e pakët makinat... Pastaj kemi dritat e stërgjyshërvë — qeshi Ndreca.

— Ç'janë këto drita? — u çudit Fredi.

— Ndezim pishë.

Fredi ndjeu në fytyrë një prekje të lëngshme,

të ftohtë. Ngriti sytë nga qelli dhe vuri re se po binin flokë të rrallë e të mëdhenj bore.

— Po kjo? — tha i habitur.

— Dimri ikën vonë nga bjeshkët tonë! — tha Ndreca.

— Megjithatë s'do ta ketë seriozisht. Sot jemi më tre mars, në mos gabohem.

— Nuk i dihet, toka është e thatë, fryn veri dhe po vazhdoi, ka rrezik të zërë.

Ndërsa po i afroheshin sektorit, barrakat po rriteshin në sytë e tyre, gjersa arritën përmasat e vërteta. Sheshi mes tyre ishte i shkretë. Xhamat nxinin. Vetëm mensa kishte dritë. Fredi shpejtoi hapat drejt saj. Ndihej i lodhur dhe po i çuhej hunda për një cigare, sepse gjatë zbritjes nuk e kishte ndezur. Mezi i pritej të ulej në karrige dhe ta ndizte një.

Sapo hynë në mensë, i mbështolli një afsh i vaket, i ngankuar me kundërmime gjellësh dhe me erë pishe të djegur. Në mes të sallës gjatoshe, me faqe pupuliti të suvatuar e të sherbetisur me gëlqere, bu-bullinte zjarri në një fuçi-sobë. Nga dericka e saj e çelur dilte një fjollë tymi të zi. Tryezat ishin të gjitha bosh. Vetëm një grua e gjatë e thatime sillëj ndërmjet tyre me hap të ngadalë e krenar dhe diç rregullonte.

Fredi zgiodhi me sy një tryezë të mënjanuar dhe shkoi drejt saj, duke nxjerrë një cigare me filter DS. Sa u lëshua në karrige, shkrepit çakmakun dhe thithi me èndje tymin e duhanit.

«Sa të shijoka cigarja kur e pi rrallë!» — mendoi. — «Sikur të isha i zoti ta pakësoja, do të kisha disa dobi.»

— Mirë se erdhët! — i përshëndeti banakieri Stakë, duke dalë nga dericka e banakut dhe shkoi

drejt tyre. Ishte një burrë i shkurtër, thatim, me sy të vegjël, por të mprehtë. Çalonte pak nga këmba e majtë. — A mërdhihët? Ja, u kujtua përsëri bora! Thamë se doli dimri, por ja që s'dashka. Një konjak, një fernet?

— Jo, më mirë nga një raki, prej asaj së fortës!
— tha Ndreca. — Apo jo, shoku Fredi? Ty s'të pëlqen rakia jonë e butë.

— Dhe nga një meze! — shtoi Fredi. — Veç të jetë e bollshme, meze dhe darkë bashkë. Kemi urë, ë, Ndrecë?

— Ujët e këtushëm të gërryen po nuk e mbushe!
— tha ai, duke i rënë me pëllëmbë stomakut. — Na sill një herë mezet, pa pastaj shikojmë e bëjmë për darkën.

— Si urdhëroni! Po shkoj t'i them Vatës të sajë dy të mira. Staka eci me shkathësi drejt sportelit të kuzhinës, që ndodhej në faqen karshi banakut. Kur nxitonte, dukej sikur kërcente.

Ndërkohë mensa po mbushej me sharrëxhinj. Para sportelit të kuzhinës u formua radhë. Punëtorët flisnin me zë të lartë, bënin shaka, qeshnin dhe ngjesheshin tek sporteli. Tryezat plotësoheshin njëra pas tjetrës.

Fredi vuri re se në tryezën karshi po hanin katter burra të veshur me pelice të vjetra, të grira sidomos në supe dhe në faqet e sipërme të mëngëve.

— Si kanë mundur t'i grisin në këtë mënyrë? — pyeti i çuditur. — Që të konsumohen bërrylat e kuptoj, por kështu!...

— Bërrylat grihen në tryezë! — qeshi Ndreca.
— Kurse ata janë të brigadës së ngarkesës. Mbartin për ditë në supe dhe para duarve shtylla miniere, degë voze, dru...

— Aha, si puna e vezës së Kolombit! — vërejti Fredi, duke buzëqeshur.

— Çfarë?

— Asgjë, m'u kujtua një histori! — Ai përtoi të tregonte.

Të katër të ngarkesës po mbllaçiteshin me kokët mbi pjatat me mish e grosh. Hera-herë hidhnin nën tryezë nga një koskë, ose pështynin përtokë bërthamat e ullinjve.

«Sa të vrazhdë e të pagdhendur që janë endë!» — mendoi Fredi, me njëfarë pakënaqësie. U mat t'i bënte vërejtje Ndrecës, por sakaq hoqi dorë. Ai po çohej për të marrë raktë. Ndërkohë kamerierja e gjatë e thatime solli pjatat me meze.

Fredit i bëri përshtypje të mirë fustani i vjetër prej fanellate, por shumë i pastër, që i dukej nën bluzën e bardhë.

— Faleminderit, Mrika! — i tha.

— Me nder qofsh!

— Si e ke djalin?

— Mirë, mirë. Po bën detyrat, vocrraku i nënës! — tha dhe buzët e saj të holla e të shtrënguara skicuan një buzëqeshje, kurse sytë i shndritën butë. U largua, duke e mbajtur trupin drejt, aq sa dukej pak e ngurtë në lëvizje.

«Duhet të ketë qenë një malësore e bukur në rini!» — mendoi Fredi. — «Por e ashpër dhe e ftohtë. Të tilla duken si të rejat, ashtu edhe gratë në këto anë, kurse plakat janë më të gjalla, më të afraura. Si duket, çështje zakonesh.

— Është raki e mirë! — tha Ndreca, duke vendosur dy dopjot në tryezë. Provoje. Gëzuar!

— E mirë qënka, vërtet!... Ndrecë, ka kohë Mrika këtu?

— Po, shumë kohë, qyshkur u bë nuse. Unë këtu e kam gjetur.

— Po i shoqi?

— Ia kanë vrarë trupat plot dhjetë vjet më parë. Ishte mars, si tani. Më kujtohet mirë si buka i nxehjtë dhe i fortë si lis. Punonte me Vukën. Atë ditë po stivonte trupat bashkë me Stakën. S'e kishte shokun në capinë. I lëvizte trupat si të ishin fije shkrepseje. Atë ditë qëlloi lagështirë dhe stiva e trupave rrëshqiti. Ti nuk mund ta marrësh më mend ç'do të thotë të rrëshqasin e të rrrokullisen dyqind metra kub trupa si ortek. Staka shpëtoi me pak...

— Prandaj çaloka! — tha Fredi.

— ... Kurse Frroku u shua në krahët e Vukës! — vazhdoi Ndreca. — «Amanet djalin dhe Mrikën!» u pat thënë shokëve. E sollën në sektor aty nga mesdita, në një vig prej degësh bredhi. Vuka dhe shokët qanin. Kur e pa, Mrika u zbeh, u bë bardhë si bora në fytyrë, por nuk briti, as nuk qau. «Mbahuni bie burra!» — u tha shokëve. «Vdekja për njerëzit është, lum kush vdes kështu me ndër!»

— Grua e fortë! — tha me admirim Fredi, dhe njëkohësisht mendoi: «Si mund të jenë të tillë këta njerëz, vallë, a kanë zemër?»

— Të tillë jemi ne, malësorët! — sqaroi Ndreca, sikur ta dinte mendimin e tjetrit. — Jo se s'kemi zemër, jo se nuk na dhimbset i afërmë, porjeta, që nga gjysh stërgjyshërit, na ka mësuar të mos epemi në fatkeqësi dhe vuajtje. Të mos ishim të tillë...

— Pse mbeti këtu Mrika? — pyeti Fredi.

— Ç'është e vërteta, njerëzit e të shoqit erdhën ta merrnin, erdhën më tepër të merrnin djalin, por ajo nuk pranoi kurrsesi. «Do ta rrit vetë djalin e Frrokut!» — tha dhe qëndroi këtu. Si ajo, si i shoqi

ishin prishur me familjet e tyre qyshkûr u martuan. Prindérit i patën fejuar gjetiu jashtë fshatit, por ata e thyen zakonin, se e donin njëri-tjetrin. I ndihmoi Partia dhe u vendosën familjarisht këtu, në sektor.

Fredi vështroi me admirim Mrikën, që vendoste rregull nëpër tryeza, duke ecur me hapin e saj të ngadalshëm, të ngurtë e krenar. Pastaj sytë i vajtën në tryezën pranë sobës, ku dy sharrëxhinj të vjetër po mbllaqitnin në heshtje. Iu dukën të njohur. Ah, po, ishin të brigadës së Vukës, ku filmoi atë ditë. Më të moçmin prej tyre sikur e quanin Mirash.

Mirashi po hante darkë me një pamje të zymtë. Ishte përqëndruar aq shumë në ato që bluante në kokë, sa nuk i shijonte aspak ç'bluante në gojë. Lugën e mbushte dhe e zbrachte mekanikisht. Bile kishte harruar se kundruall tij, në tryezë ndodhej Lleshi. Gjymtyrët i ndjente të ngathta, kokën të rëndë, qepallat të fryra. I dhembnin kyçet e nofullave dhe sikur nuk ngopej me frymë. Nuk qe i sëmurë, s'e kishte lodhur as sëpata, por...

«Po qe e vërtetë, si do t'ia bëj?» — kjo pyetje e godiste në kokë si majë capine. — Ta përzë nga shtëpia?... Përsëri ngelem se ngelem i turpëruar karshi mikut. Kurse ajo, në s'e marrtë ai, faqeziu, mund të bëhet e rrugëve. Dhe, sidoqë e përzënë, bota do ta tregojnë me gisht si të bijën e Mirash Palit... Ta vras?... Të vras njeri, time bijë!.. Pastaj, sot gjaku i saj nuk më takon vetëm mua, por edhe Partisë. Të hyj në gjak me Partinë? Kjo as që duhet menduar. Por, si t'ia bëj, unë, ditëziu? A kapërdihet turpi? Kafshatë e hidhur, që s'e nxen fytë. Ah, Bardhë, mallëkuar qoftë dita që linde se e ke zënë babën tënd si zogun nën rrassë: përpushet e s'di nga të dalë!»

— Na kapi në befasi kjo bora e mallëkuar! —

tha Lleshi, duke shtyrë mënjanë pjatën e zbrazur. Kujtuam se e hodhëm dimrin sivjet.

— Po, po, në befasi! — iu përgjigj me vonesë Mirashi.

— I kam ato pak dhi pa një grimë ushqimi. Edhe drutë e zjarrit i lashë në të mbaruar. Kushedi si e kanë hallin andej nga kulla.

— Edhe unë i kam ngushtë për gjeth! — tha Mirashi.

— Duhet të shkoj patjetër! — L'eshi ndezi çibukun prej shqope të gdhendur trashë.

— S'ke si shkon pa u mbyllur pesëmbëdhjetë ditëshi, se duhet kryer plani. Pastaj, kjo borë...

— Hej, plani nuk kryhet kurrë. Sa mbaron njeri, fillon tjetri. Në më ngordhshin dhitë, s'm'i ngjall plani.

— S'po flet mirë, o Llesh Gjoni!

— Ke hak ti, se ke një tufë burra në shtëpi, kurse unë...

— Pse, i vogël është yt bir, Prenga?

— Sa për të dhitë kanë mbaruar kur të duash. Gjithë ditën me punët e kooperativës merret. Duhet të shkoj vetë, përndryshe...

— S'të jep kush leje.

— Po s'më dhanë...

Dera e mensës u çel me vrull. Hyri një djalosh me pallto të zezë dhe një burrë i gjatë, vok i kërrusur. Bashkë me ta vërshoi një rrymë ajri e ftohtë, që rrötulloi te hyrja ca flokë bore.

— Mirë se ju gjej, burra, e ju bëftë mirë! — pëershëndeti me zë të lartë i gjati, duke shkundur flokët e kuqërreme nga bora.

— Mirë se vjen, o Sulë! — iu përgjegjën disa zëra.

— A do të më ngarkoni sonte? — iu drejtua kësaj radhe punëtorëve të ngarkesës.

— Kur të kemi lënë pa ngarkuar? — ia priti njëri prej tyre, ndërsa po kruante me lugë pjatën e fasuleve.

Sula dhe Bledari morën nga një raki, meze dhe u shtruani në tryezë duke shkëmbyer përshëndetje me fqinjët.

— Kujdes, Sulë, se mos të del Qazimi dhe të vë-tubin e llastikut! — bëri shaka Ndreca nga tryezapranë.

— He, ku pyet gjithë kjo bina për kaq! — qeshi shoferi, duke treguar më përcnim teken e rakisë. — Pastaj, kur të dal unë te Leqet e Majës në Keqe, Qazoja do të jetë kthyer në krahun tjetër. Sa ç'ë-dua unë kokën time, se do ai.

— Aq më tepër tani, që ka edhe djalin! — tha Bledari.

— Dhe çfarë djali se, buçko! — u lavdërua Sula.

— Ti, shoku operator, a po vjen me mua sonte? Dëgjova se kreve punë. Të dorëzoj shëndoshë e mirë-në stacion, të kapësh nesër trenin e parë për Tiranë.

— Faleminderit, do të qëndroj sonte! — tha Fredi. — Nesër udhëtojmë. Siç thotë fjala, ditë e re, nafakë e re.

«Si duket ka frikë!» — mendoi Bledari. Enkas pyeti: — Nesër edhe mund të ngrijë. Me këtë borë e këtë veri që fryn...

— Se mos na ndjek njeri nga mbrapa! — tha operatori, duke vendosur cigaren në një pipë prej druri të zi. — Ju jeni njerëz mikpritës, na keni krijuar kushte të mira, prandaj një ditë, dy...

— Ne udhëtojmë për muaj me radhë në rrugë-që mbajnë akull! — tha Sula.

— Jeni mësuar. Nuk ka dyshim, kjo është një punë e vështirë, heroike mund të thuash, prandaj ka edhe rreziqe. Por çdo punë ka rreziqet e veta.

— Edhe puna juaj ka rreziqet? — pyeti Bledari me naivitet të shtitur.

— Posi! Ja, një ditë, duke filmuar diçka për flotën luftarake, desh rashë nga një silurues. Të mos që ndodhur një detar aty pranë...

— Nuk di not?

— He, not, në dyqind metra thellësi, nëpër shkumën e një siluruesi... Mirë që u ndodh ai detari, përndryshe... Fredi e plotësoi mendimin me një gjest të dorës.

«Do ta ketë treguar shumë herë këtë ndodhi!» — mendoi Bledari.

— Kini punë të bukur! — tha Ndrecia. — Njihni gjithë vendin, shikoni gjithçka bëhet anembanë tij. Unë vjet isha në një shkëmbim eksperience dhe i mbaj mend ato ditë.

— Ashtu është! — Fredi u mbështet mirë në karrige dhe thithi me èndje cigaren. — Po, është punë delikate, me përgjegjësi të madhe.

Sula ktheu me fund rakinë që i kishte mbetur, përlau kafshatën e fundit të mezes, fshiu me kurriz të dorës buzët dhe u qua.

— Mbështet e shëndet e bëfshi natën e mirë! — përsyhndeti, duke mbërrthyer kopsat e treçerekshes. — Ti, shoku Fredi, në mos iksh më parë, nesër nga mesdita më ke këtu. — Ai rrasi duart në xhepa dhe iku, duke u kolovitur mbi këmbët e tij të gjata.

— Shofer i zoti! — e lavdëroi Ndrecia. — E kallon makinën në fije të flokut. Kur kemi ndonjë vend ngarkese të vështirë, Sula futet i pari. Dhe makinën e mban nuse.

Bledari e afroi karrigen te tryesa e tyre dherë
ndezi një cigare.

— T'i mbushim edhe një herë? — pyeti Staka,
që po kalonte me shishen e rakisë dhe masën në dorë.

— Jo, mjaft me kaq! — tha Fredi.

— Atëherë ç'do të porositim për darkë? — pyeti.
Ndreca.

— Pse akoma do të hash pas gjithë kësaj me-
zeje? — u çudit Fredi.

— Ne, sharrëxhinjtë, hamë shumë. Përndryshe
s'e luajmë dot sharrën e as capinën.

— Ti je përgjegjës, nuk je me capinë.

— Sharrëxhi kam punuar që pesëmbëdhjetë vjec.
Përgjegjësillëkun s'e kam zanat. Mundohem t'ia dal
me faqe të bardhë, se ma kanë varur shokët këtë
këmborë e duhet ta luaj, por, në s'qofsa i zoti... vrap
e te bishti i capinës.

— Sa origjinal, ha-ha-ha! — ia bëri Fredi.

Bledari ia kish ngulur sytë ftyrës së ngjallme
të operatorit, që rrezatonte vetëkënaqësi. Përtej zë-
rit të tij të butë e melodioz, ai shquante një notë
ironie të lehtë. Përtej vështrimit të tij të kadifenjtë,
shquante vështrimin e një njeriu që i shikon gjérat-
nga lart.

«Ndreca, me thjeshtësinë dhe bujarinë e tij prej
malësori, sigurisht nuk i vë re këto!» — mendoi,
duke parë me sa admirim i ndiqte ai fjalët e opera-
torit. — «Këta malësorët, nganjëherë, i mbivlerësojnë
të ardhurit dhe u falin me zemërgjerësi shumë ku-
sure».

Mbas darke, me propozimin e Ndrecës, ata iu
afroan zjarrit. Rrotull sobës (një fuçi me gypa të
mëdhenj si të ishte kaldajë) që sajuar një rrëth i
madh punëtorësh. Ata u liruan kryet e vendit.

Drutë e pishës kërcisinin, zjarri bubullinte me të madhe, aq sa llamarina kishte filluar të skuqeji. Dikush kishte nderur nga soba duart, dikush këmbët, dikush tjetër afronte peliqen për ta tharë. Era e çizimeve të nxehura, avulli me kundërmim të athët nga peliqet, tymi i duhanit të fortë të fshatit, era e pishës që digjej, kundërmimi i gjellëve që vinte nga sporteli i kuzhinës përziheshin dhe jepnin kundërmimin karakteristik të mensave të sharrëxhinjve në një natë dimri.

«Hej, ç'po tymosemi si caragat!» — u tall me vete Fredi duke afruar te soba këmbët e mardhura. — «E shkreta Dritë, ç'do të vuaj për të larë rrobat e mia!»

«Nuk e prisnim këtë mot! — tha Lleshi, duke shkuar pëllëmbën mbi mustaqe. — E ka filluar shtruar. Siç duket, deri nesër do ta çojë një gju.

— Tu thaftë ajo gojë! — e mallëkoi Ndreca, me shaka.

— Dalsha i gënjer, se nuk ia kemi kohën. Ngushtë me plan e ngushtë nga shtëpia. I kam ato dy kokrra dhi pa një grimë ushqimi.

— T'i çuftë ujku ato dhi, të shpëtosh ti e ne prej tyre! — tha me mllef Mirashi. — Aty të mbeti mendja e gjuha.

— Kujtdo i shkon mendja dhe gjuha ku i dhemb e ku i djeg! — ia priti me djallëzi Lleshi. — Dy njerëz e dy halle njësoj s'janë.

Mirashi ndjeu se u skuq, diçka hungëroi, por nuk e shtyu më tej. Nxori qesen e duhanit dhe filloj të mbushte llullën duke menduar: «Ç'ditë mbërrite, o ditëzi, të skuqesh në kuvend burrash!»

— Ç'do të bëni nesër? — pyeti operatori.

— Do të punojmë! — iu përgjegj brigadieri

Vukë. — Në pastë burrë që mund të punojë, do të punojmë. Veç të tjerave, duhet mbajtur rruga e çelur, se stabilimenti ka nevojë për trupa. Përndryshe, na ngelen treqind shokë pa punë dhe planin e merr lumi.

«Sa e vështirë dhe e thjeshtë që është jetë tyre!» — mendoi Fredi... «Për të qenë të kënaqur, u mjafton një ngastër pylli, një sharrë, një sëpatë, një capinë, një peliçe, një palë çizme, bukë e grosh me mish, një sobë si kjo dhe një shtrat me pesë batanije. S'pyesin në është shi, borë a ngricë...»

Dera e mensës u çel me vrull. Hyri një rrymë e ftohtë, u rrrotulluan në ajër ca flokë bore, nga dera e sobës doli një gjuhë flake, pastaj tym i zi.

— Mbylle, dreqin! — hungëroi Mirashi.

I porsaardhuri krejt i zbardhur nga bora, përplasi këmbët fort te praku, zgjidhi shallin që kishte në kokë, e shkundi, fshiu vetullat dhe fytyrën e lagur e iu afrua zjarrit.

— Hej, qënka traktoristi Lulash! — tha Ndreca.

— S'të njoha fare. Qenke bërë si dordolec bore. Nga vjen kaq vonë?

— Nga përrroi i Gjarpërit. Mezi e nxora traktorin në rrugën kryesore. Nuk ndizej nga të ftohtit. Ma mori shpirtin.

«Kur s'ta mori vërtetë!» — mendoi Mirashi.

Lulashi afroi te soba duart e skuqura. Flokët e borës që i kishin mbetur në krrelat e zeza, u shndërruan në bulëza vezulluese uji, që filluan t'i rridhnin nëpër fytyrë. Ai i fshiu me shpinën e dorës.

— Ka zënë shumë bora te Përrroi i Gjarpërit? — pyeti Ndreca.

— Ka zënë që ç'ke me të. Në vazhdoftë kështu...

— T'i vëmë ruspën traktorit. Lipset ta mbajmë

të celur rrugën me çdo kusht. Stabilimenti e kamaruar rezervën dimërore.

— S'e kam në gatishmëri hidraulikun! — Lulashi me zi i nxori fjalët, duke e rrëzuar vështrimin te çizmet që i avullonin.

— Ç'thua, bre! — u zemërua Ndreca.

— Më ka plasur një manikotë. E kam lajmëruar para një jave oficinën, por s'shkova ta merrja. Besoj ta kenë bërë.

«Se mos e ke mëndjen te puna ti!» — tha me vete Mirashi, duke i futur dru sobës.

— Nuk mendova se do të na rrethonte kaq vonë? — vazhdoi traktoristi, duke ia bërë me dorë nga jashtë. — Nesër, që pa gdhirë, po nisem më këmbë dhe e sjell.

— Po s'pushoi, ashtu duhet vepruar, por mos u nis pa më takuar! — tha Ndreca i pezmatuar.

— A shkojmë dhe flemë, burra? — tha Vuka. — U bë vonë dhe nesër s'e kemi të lehtë. — U çua, nderi edhe një herë duart nga zjarri, si për të marrë një rezervë nxehësie, kopsiti peliqen dhe u largua, duke uruar natën e mirë.

Pas tij doli Mirashi dhe disa të tjerë. Lleshi qëndroi, se deshi të kërkonte leje për të nesërmén, por matej dhe nuk guxonte.

Rrethi qark sobës u ngushtua. Mrika përfundoi së shtruari tryezat për të nesërmén dhe priste e mënjanuar me fshesë në dorë. Staka mbylli sportelin e banakut dhe iu afrua sobës, duke çaluar. Zjarri bubulliti edhe një herë, pastaj u fashit.

— Ju shkoni të flini në dhomën time! — u tha Ndreca Fredit dhe Bledarit. — Batanije ka boll, zjarrin e keni të ndezur... Veç mirë është t'i futni nga

një dru natën, në u daltë gjumi. Sidomos në të gdhi, rë do të jetë shumë ftohtë.

— Po ti? — pyeti Fredi.

— Mos u bëni merak për të zotin e shtëpisë!

Lleshi çeli derën e sobës, ndezi në prush ciganen e dredhur të trashë sa gishti dhe u çua. Vendosi ta linte për të nesërmen kërkesën.

Ndreca me të dy shokët e tryezës dolën të fundit.

— Bëfshi natën e mirë! — i uroi Staka dhe i hodhi zjarrit një broke me ujë.

Mrika që gjer atëherë kishte qëndruar si statujë ndanë sobës, filloi të fshinte.

3.

— Kalo se je më i shtëpisë këtu! — tha Fredi sa po dolën nga mensa.

— Jam tamam i shtëpisë! — ia priti inxhinier Bledari dhe kaloi i pari në shtegun që të conte në fjetore.

Vazhdonte të binte borë me flokë të mëdhenj e të dendur, që shquheshin sidomos karshi dritareve të ndriçuara dhe ndiheshin në fytyrë si prekje të ftohta, të lëngshme. Shtegu i saporrahur nga sharrë-xhinxjtë që kishin shkuar të flinin, dukej vetëm si gjurmë.

Fredi kishte rrudhur qafën nën jakën e ngritur, që të mos i futej borë në zverk dhe mundohej të ecte në gjurmët e shokut. Trembej mos shkelte bosh dhe ndrydhte ndonjë këmbë. Bledari nxitonte lirshëm, pa u bërë merak për atë, që mezi mbahej pastiq. Shyqyr që fjetorja ishte afër. Pas perdes qumë-

shtore të borës ajo dukej shumë e gjatë, me dritare të panumërtë, të zeza. Vetëm dritarja e skajit ishte e ndriçuar.

Fredi mori frymë i lehtësuar, kur kaluan pragu. Shkundën borën dhe u futën në dhomë. Zjarrin dhe dritën i gjetën ndezur. U pëlqeu afshi i ngrohtë i sobës, sepse ato dyqind metra ua kishin shterur rezervën e nxehësisë së mensës.

— Kail kohë pa parë borë të tillë! — tha Fredi.
— Si thua, do të bllokohen rrugët?
— Edhe mund të bllokohen! — iu përgjigj Bledari.

— Mbata këtu, dreqi e marrtë! — mallëkoi operatori, duke varur treçerekshen në gozhdën mbrapa derës.

— Kjo është e keqja më e vogël e kësaj bore! — buzëqeshi Bledari. — Pastaj, siç the vetë, këta janë njerëz mikpritës, të kanë krijuar kushte të mira dhe...

— Po, po, por isha pregetitur shpirtërisht që nesër të ndodhesha në familje. Bëra dy javë këtu, S'janë pak. Më ka marrë malli pér fëmijët, pér gruan... — Ai vuri re se tjetri vazhdonte të buzëqeshët dhe shtoi: — Ty ndoshta të duken qesharake këto, djalosh, por do ta kuptosh më mirë kur të bëhen me familje, se tani je ku rafsha mos u vrafsha.

Fredi nisi të zgjidhët këpucët me qafa. Ndërkohë e mendoi veten në shtëpi. Së pari do të bënte një banjë të mirë. E di ç'domethënë të rrish dy javë pa bërë banjë? Sidomos, duke bredhur pyjeve, në këto barraka, pranë këtyre sobave që djegin dru pishe! Ky inxhinieri, që buzëqesh me ironi, si duket është bërë njësoj si këta, vendasit. Qenka edhe nga Tirana, pa le!... Drita me siguri do t'i pregetiste ca meze të

mira, sa për të shoqëruar një gotë nga ajo rakia që kishte blerë në Përmet. Ka mbetur edhe nja gjysmë litri në frigorifer. Fëmijët, mbasi të hanin darkën dhe çokollatën që ai ua çonte sa herë kthehej nga shërbimi, do të shkonin të flinin. Ai do t'i bënte Dritës, si zakonisht, përshkrimin e hollësishëm të udhëtimit, do t'i tregonte mbresat, kuriozitetet. Dhe kishte ç't'i tregonte, mjaft historia e Mrikës. Do të dëgjonte pastaj prej saj të rejat e Tiranës, do të mbaronin darkën e shijshme dhe së fundi, në shtrat. Boll me këta shtretër të ngushtë, gjoja me sustë, ku s'guxon të rrotullohesh se ke frikë mos bie në dysheme... Ah, kjo borë, pse nuk priti edhe pak!

Nxori nga valixhja një palë pantofle me rripa të verdhë, një palë tuta vishnje, u ndërrua, rregulloi rrobet e ditës në një karrige dhe iu afroa shtratit.

— A thua janë të pastra? — pyeti, duke i çuar pak me dorë mbulesat e duke i shqyrtuar me vëmendje.

Bledari nuk u përgjigj.

— Nuk po më dukesh fort i mërzitur që le të fejuarën dhe Tiranën në ditë të diel! — u mundua ta thumbonte Fredi. — Mirë mua, që më zuri këtu kjo e mallëkuar borë, po ty ç't'u desh të vije në ditë pushimi? Të të kishte zënë në Tiranë... rroftë sebepi! Apo, ndërgjegja?! — Ai buzëqeshi me njërin cep të gojës.

— Puna dhe ndërgjegjja bashkë! — iu përgjigj Bledari, duke u shtirur sikur nuk ia vuri re buzëqeshjen. — Po të mos vija, nesër sharrëxhinjtë e dy brigadave do të ngeleshin pa front pune. E kanë përfunduar prerjen e drurëve të damkosur dhe duhet kryer ridamkimi.

— C'është ky ridamkim? — pyeti tjetri, ndërsa po kërkonte muzikë në radion e dorës.

— Drurët që do të priten i shënojmë me damkë ne pylltarët! — sqaroi inxhinieri. — Që pylli të ripërtërihet vetë lëmë pa prerë një pjesë të drurëve. Këta lëshojnë farën dhe, njëkohësisht, hijezojnë filizat e porsambirë dhe mbrojnë tokën nga gërryerja. Po le më shumë drurë nga ç'duhet, filizave nuk u mjafton drita e ngrohtësia dhe nuk zhvillohen. Po le më pak, toka e zhveshur gërryhet, kurse filizat vriten nga drita dhe nxëhtësia e tepërt. Duhet gjetur, pra, karari. Kjo punë s'bëhet dot me një dorë, se pylli është i ndërlikuar.

— Pra, ridamkimi qënka një farë retushi! — krahasoi Fredi.

— Aty afër!

— Interesant, dashka edhe puna juaj një farë shkence! — në zërin e operatorit kishte një timbër ironie. — Të them të drejtën nuk kam një ide fortë qartë për profesionin e inxhinierit të pyjeve. Mendoja, pylli mbin vetë, pyllëzimet janë të thjeshta, çel gropë e mbill fidane, çdo fshatar di ta bëjë këtë punë. Ç'i ngelet inxhinierit të pyjeve?

— Besoj se kësaj radhe pe dhe mësove diçka për punën tonë! — tha Bledari.

— Diçka po! — Fredi çeli derën e sobës dhe e mbushi me dru.

— S'thotë kot populli, sa të rrosh do të mësosh. Megjithatë, në një drejtim justifikohesh, se puna jonë, e pylltarëve, është anonime. Ti pregatit një film që kur shfaqet, mbas titullit lajmëron: realizues, Fredi Mushqeta. Të gjithë spektatorët e mësojnë se filmi është vepra jote. Një tjetër boton një tregim a një vjershë dhe poshtë saj vë emrin. Projektuesi

gëzohet kur sheh një godinë të përfunduar, e cila ka lindur së pari në imagjinatën e tij. Ne, pylltarët, punojmë gjithë jetën, por vepra jonë bashkohet me atë të natyrës dhe mbetet anונית.

— Qenka, pra, një punë pa sadisfaksion! — vërejti Fredi.

— Për një egoist, po. Për atë që e dashuron pyllin dhe natyrën, është e kundërta! — ia priti Ble-dari. — Është e mrekullueshme të shikosh një pyll të ripërtëritur, atë mori filizash të dendur, të shëndetshëm, të freskët, që e veshin tokën më bukur se më e bukura sixhade. A nuk është kënaqësi të mendosh se puna jote ka ndihmuar sadopak për krijimin e kësaj mrekullie?

— Nuk ndodh e kundërta, që ndërhyrja juaj t'i bëjë dëm pyllit? — pyeti Fredi, duke dashur t'i hidhte ujë të ftohtë entuziazmit të shokut. — Pyjet kanë arritur mjaft të pasur e të bukur deri në ditët tona edhe pa ju, pylltarët.

— Po sa nuk kanë arritur? — kundërshtoi Ble-dari. — Ç'kanë qenë gjithë ato faqe malesh, sot të zhveshura, gjithë ato rrëpira dhe toka, që duken sikur i ka gërryer me thonj ndonjë përbindsh? Ato dëshmojnë për mungesën e kujdesit ndaj pyjeve në të kaluarën, për mungesën e dorës së njeriut, të pylltarit.

— Ju, pylltarët, një gjuhë paskeni. Kështu më fliste një ditë edhe ai Paloka, tekniku i Pyjeve! — tha Fredi.

— I do shumë pyjet! — tha Bledari. — Ka lidhur jetën me to. S'i thonë shaka, tridhjetë vjet pylltar! Ta shikosh shprehjen e fytyrës së tij në një pyll të bukur, thua se nuk është ai Paloka i zymtë. E di ç'u thotë sharrëxhinje? Duajeni dhe mos e

shpërdoroni drurin, u thotë, se ai ju përkundi në djep dhe ai do t'ju përcjellë nga kjo botë, ishalla pleq. I dridhet zemra pér një filiz. I përkëdhel, sikur të ishin fëmijë, i çliron nga shkurret, i drejton dhe vident midis tyre si shqarth, që të mos i shkelë.

— Kjo na kujton historinë e atij zemërbutit, që kishte lidhur zilka në këmbë pér të trembur mizat e dheut, që të mos i shkelte! — buzëgeshi Fredi.

— Ne kemi nevojë pér njerëz që ta dashurojnë profesionin, si Paloka — tha Bledari.

— Po, po, bëra shaka! — u ngut të thoshte Fredi, duke vënë re acarimin e tjetrit. E vendosi radion e dorës mbi tryezë dhe ndoqi me vëmendje melodinë gazmore që transmetohej. — E bukur, ë?

— Po, e bukur.

— Te ju, këtu, nuk dëgjon veçse muzikë popullore. Si duket, sharrëxhinjve tuaj nuk u hyn në vesh muzikë tjetër. Madje, atyre u pëlqen vetëm çiftelia.

— Është e kuptueshme! — tha Bledari. — E kanë dëgjuar qysh në djep. Kujdo i pëlqen muzika e vet. Pér shembull, ty a nuk të pëlqejnë këngët dhe meloditë tiranase?

— Po, po, madje i dëgjoj me èndje, por.. me karar! — buzëgeshi Fredi. — Kurse kjo, çiftelia, të them të drejtën, më duket ca si monotone. Pse ty të pëlqen?

— Pa ardhur këtu edhe unë nuk e shijoja. Kurse tani nuk e konceptoj dot malësinë pa këngët me çifteli. Pse, do të pyesësh! — Bledari u mendua një çast. — Ndoshta sepse, sa mund ta kuptosh madhështinë e shqiponjës duke e parë atë në kafazet e kopshkit zoologjik, aq mund ta kuptosh çiftelinë pa njuhur malësorët dhe malësinë.

— Vërej me kënaqësi se qenke adaptuar përmrekulli! — tha Fredi.

Mënyra se si i shqiptoi këto fjalë ishte kaq e pangjyrë, sa Bledari nuk e dalloi në fliste sinqe-risht, apo me ironi.

— Ta paskam qarë hallin kot! — vazhdoi tjetri.

— Këta sharrëxhinjtë, vërtet mund të jenë njerëz të mirë, punëtorë, por më duken të vrazhdë, me botë të brendshme të kufizuar. Ç'mund të bisedosh me ta përveç hallevë të prodhimit, të bujqësisë, apo të ndonjë problemi tjetër të rëndomtë? Për një intelektual kjo nuk mjafton. Është e qartë, e kemi për detyrë të punojmë atje ku nevojitet, të ndihmojmë përvzhillimin e njerëzve dhe të punës, por kujtoja se e ke shumë të vështirë, kujtoja se mërziteshe shumë. Bravo! Më pëlqejnë njerëzit që dinë ta gjejnë të bukurën dhe interesanten kudo.

— Sështë ndonjë meritë ta gjesh shtegun ditën në diell! — tha Bledari, i acaruar nga toni mësimor dhe ngushëllues i tjetrit. — Vetëm i verbri ka nevojë ta marrin për dore.

— Edhe modestia është një veti e mirë! — buzëqeshi Fredi dhe duke dashur t'i largohej asaj temë tha: — Sa tym që paskan bërë cigaret tonë! Sikur ta çelim pak dritaren? Duke pasur ajrin e pastër të bjeshkëve, gjynah të thithim gjithë natën këtë ajërtë prishur... Prit sa ta mbush sobën me dru, se nabin tym pastaj. Dhe cigare nuk do të pimë më, dakkord? E tejkaluan normativën, u helmuam fare!

Me të çelur Bledari kanatet e dritäres, hynë pjerrtas e rrëmbimthi një mori flokësh bore, që sikur i dhanë trajtë të dukshme rrymës së ajrit të ftoshtë. Disa cërcëritën e u avulluan sa prekën syprinën dhe

gyngjet e sobës, të tjerat ranë mbi tryezë e dysheme dhe u shkrinë sakaq, duke lënë njolla të vockla uji.

— Mbylle, se u ajros! — tha Fredi, që ndjeu mornica të ftohta në trup dhe iu afrua sobës. — Nësër rrezik të dalim nga dritarja. S'ma merrte kurre mendja që më tre mars...

— Një rast i mirë për ta njojur punën e sharrëxhinjve në kushte të vështira! — e ndërpren Bledari, duke buzëqeshur lehtë. — Ju, operatorët, i gjuani këto raste. Ti pate fat si ai gjuetari i rosave që u rropat gjithë ditën e nuk vrau gjë, por ndërsa kthehej i dëshpëruar në shtëpi, i ra nga qielli një rosë e egër mu përpara këmbëve, si duket e plagosur nga ndonjë tjetër...

Fredi diçka mërmëriti i nxehur nga kjo shaka, por nuk e shtyu më tej. Nisi të prebatiste shtratin për të fjetur me një kujdes të tepruar. I ktheu batanijet nën dyshek në të tria anët dhe u fut nga sipër, si në zarf.

— Mund ta fikësh dritën. Natën e mirë! — tha ftohtë dhe u kthyte me fytyrë nga muri. Lëvizi me kujdes, që të mos i luanin batanijet.

Bledarit iu kujtua tregimi i Çehovit «Njeriu në këllëf» dhe qeshi me vete. U fut në shtrat, tërhoqi batanijet gjer në sqetulla, lidhi pëllëmbët nën kokë dhe vështroi lojrat e dritës së sobës në tavan. Dëgjohej krisma e lehtë e drunjve që digjeshin dhe frymëmarrja e operatorit. Si zakonisht në këto raste, mendimi i shëtitit andej-këtej.

«... A thua do të vijë nesër herët Paloka? Do ta fillojmë ridamkimin te Mrizat e Qarrit, aty duhen hequr mjaft drunj të vjetër ahu, se ka ripërtëritje të bollshme bredhi... Më mirë të vesh këpucët me qafa, apo çizmet? Më duket se çizmet janë të shpua-

ra. Po tē jetë bora e thatë, kalohet me to, pérndryshe... Bëra gabim që s'e mora bluzën e trashë. Nesër do tē më hynte në punë. E dashura nënë qëndroi dy net gjer vonë që tē ma mbaronte. Sa lodhet, e ngrata! Në moshën e saj s'i thonë shaka njëzetegjashtë orë mësimi në javë. Gjynah që s'kam pasur rast ta dëgjoj si e zhvillon mësimin. Të gjithë e lavdërojnë si arsimtare tē mirë... Vallë c'bën tan? Planin e mësimit pér nesër, thur trikon e Edit, lexon, arnon, apomendon pér mua?... Kushedi sa e merr malli, sa shqetësohet, megjithëse nuk e tregon. Unë jam trenguar disa herë i pavëmendshém ndaj saj. Ja, harrova t'i thoshja Sulës tē telegrafonte se arrita mirë, megjithëse ajo më porositi. Pò im vëlla? Me siguri që tanë fle. E ndihmon nga pak nënën, por është ende i vogël dhe ka më tepër nevojë pér shërbim e kujdes. Ndryshe tē kishim babanë gjallë... Natën e mirë, nënë, gjumin e èmbël, Edi!

Drutë u shembën në sobë, zjarri bubulloï, drita në tavan u shtua, pastaj zjarri u pakësua përsëri dhe drita u fashit. Në dhomën fqinje dikush u kollit. Shtrati i operatorit kërkëlliti.

Fredi u kthye në anën tjetër, gjithmonë me kujdes. «Ja, zjarri do tē shuhet dhe kushedi sa ftohtë do tē bëhet, sidomos në mëngjes.» Nuk e zinte gjumi, megjithëse një copë herë mori frymë thellë dhe numëroi gjatë. Kishte ngrënë shumë. Gjithmonë zotohej me vete që tē mos e tépronte në darkë, po rrallëherë e mbante zotimin. Ndiente etje, por përtonte tē çohej. T'i lutej Bledarit? Ai zgjuar qenka... Në asnjë mënyrë! Edhe po tē mos e dallonte në errësirë, ai do ta ndiente buzëqeshjen e tij. Tip i çuditshém!...

Vështroi dritaren, që dukej si një njollë e madhe, kaltëroshe. Ajo dritë qumështore, që mezi da-

Ilohej, ishte aq eëmbël dhe aq qetësuese! I ktheu sytë nga katrora e ndritshme e derickës së sobës. Sikur e magjepsi ngjyra e kuqe portokalli e prushit. Iu kujtua një natë e largët dimri kur ishte ende i vogël. Sa? Nja njëmbëdhjetë vjeç. Po, aq!

Atë ditë, si rrallëherë në Tiranë, kishte rënë borë dhe ai qe lodhur e këputur, duke luajtur me topa bore. Mbas darke nëna u kishte shtruar fëmi-jëve, në kuzhinë, përdhe, karshi sobës prej llamarine që e kishte bërë vetë babai. Ai ishte kovaç. Nëna i urdhëroi rreptë të flinin, por ajo vetë nuk ra. Me xhaketën e vjetër të babait krahëve dilte shpesh te pragu i jashtëm dhe dukej shumë e shqetësuar. Pse s'po kthehej babai, ai s'e kishte zakon të vonohej? Fredi, më i madhi ndërmjet tre vëllezërve e dy motrave, nuk deshi të flinte pa ardhur i ati. Fërkonte sytë, vështronte zjarrin nga dericka e sobës, si sonte, dhe priste. Nuk guxonte të lëvizte nga frika e nënës. Kur erdhi, babai përtypi diçka në eirësirë, që të mos i zgionte ata dhe pëskpëriti gjatë me nënën. Fredin e kishte zënë gjumi, pa kuptuar ç'thanë. Të nesërmen, që pa għidh, babai i veshur pér udhëtim, i puthi një nga një në shtroje dhe iku. Nëna e përcollti gjer te kreu i rrugicës.

Shumë kohë ai s'e diti ku ndodhej i ati. Nëna nuk tregonte. Gjatë asaj kohe babai kishte qénë partizan. Ajo vazhdonte të lante rrobat e botës, bile më shumë se zakonisht dhe ai quditej edhe sot, se si kishin mundur të ushqeheshin gjashtë gojë pér dy vjet me rádhë, vetëm nga duart e saj. Zaten, ata ishin mësuar me pak gjithmonë! Një palë çizme llastiku me llüstër dhe një fetë bukë me gjalpë e marmallatë gjatë pushimit të madh, kjo kishte qenë èndrra më

e guximshme e fëmijërisë së tij. Kurse sot, ehe, ku janë sot!... Plaku mbahet, kurse nëna ka rënë shumë. Vuan nga mëlcia e zezë. Duhet bindur të shtrohet disa kohë, të mjekohet mirë. Doktor Esati i ka premtuar...

Drita e sobës po fashitej. Heshtje. Në dhomë po shtohej errësira.

*

* * *

Staka u zgjua pa rënë zilja e orës që mbante mbi komodinë. Shtriqi këmbët nën të pesë batanijet dhe sakaq ndjeu se i depértoi të ftohtit. U mundua të gjente karar përsëri, por nuk mundi. Atëhere flaku batanijet, uli këmbët nga shtrati dhe kërkoi me to pantoflet. Në errësirë iu duk se zbardhonte pragu i derës. Mënjanoi perden që ndante kthinën e fjeteres nga ajo e banakut, vërtiti çelësin e dritës dhe picërroi sytë nga shkëlqimi i llampës njëqindvatëshe, varur mbi banak. Shpëlau sytë me ujët e akullt të lavamanit, u vesh me ngut, ndezi ekspresin, pregatiti banakun për shërbim dhe çeli taraben e madhe prej fibre, që e ndante nga salsa e mensës. Sakaq u shquan rreshtat e parë të tryezave me mbulesa të bardha. Nga sporteli ende i myllur i kuzhinës përballë vinte kundërmimi i gjellëve.

«Kazanët qenkan gati: fasule, makarona, pilaf, çaj, djathë...» përsëriti me mend Staka, çka përsëriste qindra herë me zë, përditë. — «Duhet ndezur soba e mensës!»

Mbathi çizmet. Dera e jashtme e kthinës së banakut u çel më lehtë se zakonisht, sikur e shtyu

njeri nga jashtë. Sakaq u rrëzua në prag një tog i shkrifët bore.

«Hej, sa paska rënë! — u çudit Staka, kur iu fundosën çizmet në borën që kërciste butë.

Përtej xhufkës verdhacuke të dritës që dilte nga dritarja e vetme e banakut, shtrihej errësira. Ishte një errësirë e ndryshme nga e zakonshmja, kaltëroshe, qumështore, pa silueta, disi e ndritshme. Ajri ishte i palëvizhëm, i ftohtë, i thatë, pa kundërmimet karakteristike të malit. Zhurmat ishin më të fashitura se zakonisht. Bile, edhe përroi aty pranë dëgjohej më pak. Borë nuک binte.

«Druaj se do të bjerë përsëri!» — mendoi Staka, duke ecur me hamendje drejt hyrjes së mensës. Gjeti me të prekur drynin, mezi e tereziti çelësin në vrimë dhe e shtyu me forcë derën e rëndë. Iu desh ta pastronte me lopatë pragun që ta mbyllte përsëri. Pastaj trokiti në sportelin e kuzhinës.

— Hej, Vatë, a fjete?

— Më pak se ti!

Krisi llozi i sportelit dhe sakaq u shfaq në të një kokë e madhe, tullace, e shoqëruar me një afsh të ngrrohtë, të lagësht e plot kundërmime gjellësh.

— E pe si e ka shtruar Stakë? — tha kuzhinieri.

— E pashë, dreqi e hëngërt!

— Pse shan, ajo këtu ka shtëpinë e vet.

— Po, bre, por kaq vonë dhe kaq shumë! Jemi në mars.

— Ka ndodhur edhe në qershori, ti e di.

— Na rrëthoi keq. Jemi ngushtë me planin, kur se stabilimenti e ka mbaruar rezervën dimërore. Ku na gjeti, e mallëkuara!

— Plani i xhiros së banakut do të tejkalohet, mos u bëj merak!

— Dreqi e marrtë planin e xhiros, kam hallin e planit të prodhimit, bre Vatë!

Kuzhinieri diçka nisi të skuqte mbi sobën e madhe, sepse dëgjohej cërcëritja e vajit. Tani dukej sikur zëri vinte nga larg.

— Hej more Stakë, sado që kanë kaluar dhjetë vjet, sharrëxhi se sharrëxhi ngele! Mendjen te trupat e ke.

— Pa ta, as unë e as ti nuk duhem gjë këtu. Ma jep një lopatë prush, të ndez zjarrin. Ç'ka për mëngjes?

— Të zakonshmet! — Vata e nxori lopatën me prush.

— Fasule, makarona, pilaf, çaj, djathë, reçel! — përsëriti Staka, duke kapur me kujdes bishtin e lopatës.

— Edhe hallvë. Po skuq miellin. Në kohë bore hallva duhet, se të jep fuqi.

Staka hodhi prushin në sobën-fuç, e mbushi me dru, cau një copë pishë dhe e ndezi. Nga deriçka e sobës dolën ca gulshe tymi, pastaj ai e gjeti rrugën e vet nëpër qyngje dhe zjarri nisi të bubullonte.

Dera krisi dhe te pragu u shfaq Mrika, si gjithnjë me bluzë të bardhë, të kopsitur gjer sipër, me flokët e zes të krehur me kujdes dhe të shtrënguar me napë të bardhë. Tha «mirëmëngjes» shkoi drejt e te tryeza më e afërt, mori brokën, e shpëlau te çesma mbas portës, e mbushi, kaloi te tryeza tjetër dhe përsëriti të njëjtin veprim. Ekte me hap të ngadalte dhe me trupin drejt, si pérherë. Sytë e mëdhenj e të zes, të futur thellë ndërmjet mollëzave të theksuara dhe harqeve të gjata të vetullave, i dukeшин tē ftohtë e të qetë. Tiparet e fytyrës i kishte tē palëvizshme, pa shprehje.

Staka, që e njihte prej kohe, hetoi një dhembje të thellë pas kësaj dukjeje të qetë.

— Mrikë, a s'po vjen të nxehësh pak duart? — i tha. — Sot s'e besoj t'u duhet ujët.

— Të ftohtët jep etje, si të nxehëtë! — tha Mrika dhe vazhdoi punën. Ajo ecte ngadalë, mes rresh-tave të tryezave, ndërsa mendimi e çonte larg...

... Atëherë ajo ruante dhitë e familjes te Mrizi i Lisave. Aty kishte livadhe të bukura, plot bar. Në pranverë çelnin lule të panumërtë, të vockla me të gjitha ngjyrat e ylberit. Ajo bënte kurora me to. Stoliste flokët e saj, stoliste edhe kecat. Hidhërohej kur ata i shkundnin e i prishnin. Ishte e re, në mos e vogël.

Te ai mriz kalonte shtegu nëpër të cilin, të shtunave pasdite ktheheshin në fshat dhe iknin të hëna-ve, herët në mëngjes, burrat dhe djemtë që punonin në sharrë. Vërtet ishin të shpërndara shtëpitë e tyre, por ai qe i vetmi shteg për në sektor.

Kur i shihte që vinin, mënjanohet shtegut, fshi-hej dhe i kundronte së largu. Shumicën i njihte. Ata kishin një të ecur ndryshe nga djemtë e tjerë të fshatit, diçka më krenare. Vinin e shkonin me rrrobat e tyre më të mira dhe dukej sikur thoshnin «shikonani neve, jemi sharrëxhinj!»

Në atë mriz u njoh me Frrokun. Ai banonte në kullën më të largët. Një të shtunë pasdite po kthehej me një deng të madh në shpinë. Si duket kishte ble-rë dyshekë për shtëpinë. Ishte i lodhur e i djersitur. U ul të pushonte te livadhi i madh e i bëri zë së largu. I kërkoi ujë. Ajo rendi te burimi, mbushi paguren e drunjëtë dhe ia çoi, pa guxuar të ngrinte sytë. Ai e falënderoi dhe iku.

Kështu filloi. Ajo e njihte prej kohe, por si

fëmijë. Tani i qe dukur ndryshe dhe filloi të trembej nga ndjenjat e saj. Ishte e fejuar, qysh dymbëdhjetë vjeçë. Nuk e njihte fare të fejuarin, por i qe nën-shtuar këtij zakoni si edhe shoqet e saj.

Fejesa me atë të panjohurin, nisi t'i dukej si diçka e frikshme, e ftohtë dhe kërcënuese, si tehu i mprehtë i sëpatës së madhe të babës. U mundua t'i ndrydhte ndjenjat, por s'mundi. Ato u ngjanin luleve të egra të Livadhit të Madh, që nxirrin kryet në të çarat e shkëmbinjve e përmes borës së vonshme.

E priste me ankth e gjëzim të shtunën, kur ai dukej te Qafa e Arushës. Të hënën, kur ai ngjitej përpjetë dhe zhdukej përtëj qafës, i bëhej një boshllëk mu në lukth. Në fillim fshihej në kaçuba, pastaj guxoi të kulloste dhitë pranë shtegut. I përgjigjej pëershëndetjes së tij kryeulur dhe ndjente se skuqeji në fytyrë. Ia ngulte sytë mbasi kalonte dhe prandaj e njihte më mirë nga shpina: shpatulla të gjera, eshtake, krahë, të bëshëm, që i tundte me ritmin e hapit, këmbë të gjata e të forta që shkelnin në shteg me shkathtësinë e dhive të saj.

Pastaj filluan ta kërkonin njeri-tjetrin. Ai e linte shtegun dhe bënte sikur kishte nevojë të çlodhej a të pinte ujë. Atëherë ajo sillej mbas dhive me një kujdes të tepruar. Një ditë e mori zemrën ndër dhëmbë dhe u ul disa hapa larg tij. Më shumë heshtën se folën. Vonë ajo guxoi ta vështronte në sy. Dhe, që atë ditë, folën më shumë me sy për ndjenjat e tyre, që u mritën bashkë me lulet e egra të Livadhit të Madh e me kecat e tufës së vogël të bareshës.

Kaluan ditët. Kecat u bënë dhi. Ajo i bëri muillarët e saj të gjethit. Gjethet e lisave filluan të ash-përscheshin, të zverdheshin. Prindërit e saj caktuan ditën e dasmës me atë tjetrin. Filluan pregetitjet.

Asaj i dukej sikur zemra i tkurrej përditë. Dikur s'duroi dot. I tregoi Frrokut. Ai uli kokën. Sytë iu errësuani. Shtrëngonte nofullat dhe gjuante me guraleca një shenjë të paqenë. Më në fund tha: «A dëshiron të vish me mua?». Ajo, si në prush, tundi kokën në shenjë pohimi, pastaj i shpëtuan lotë dhe iku me vrap.

Ai erdhi të shtunën, i tha të bëhej gati për të hënën dhe atë ditë e mori me vete në sektor. Për herë të parë ajo i pa në sup sëpatën e madhe të sharrëxiut. Prindërit e tij nuk kishin dashur të shkeleshin zakonet e kanunit.

Në sektor i përkrahën shokët e Partisë. U dhanë një të ndarë, që shërbente si magazinë veglash. Frroku e rregulloi sa mundi, por era hynte se hynte. Kur bënte tufan, gdhiheshin me borë mbi mbulesa. Megjithatë, qe dimri më i butë për ta.

Në fillim, disa sharrëxinj, sidomos të vjetrit, i shikonin shtrembër, por ca nga ca ndryshuan mendim. Ajo hyri në punën që ka sot. Dalngadalë e rregulluan shtëpinë. Vetëm të shtunave kur të tjerët ktheheshin pranë familjeve dhe sektori shkretohëj, ata ndjenin një farë trishtimi. Qysh asaj të hëne nuk e kishin kapërcyer Qafën e Arushës dhe i merrte malli për bjeshkët, për kullat dhe për njerëzit përtjej saj.

Kur ra bora e parë ajo lindi djalë. Frroku u gëzua sa s'bëhet. Dhe atë mbrëmje i gostiti të gjithë shokët me raki, në mensë. Aty i gjetën edhe emrin. Bardhoku i vogël pati kumbarë gjithë sharrëxinjtë e sektorit.

Frroku nuk veproi si burrat e zakonit të vjetër të malësisë, që nuk ia hedhin sytë foshnjës pa mbushur motin. Ai e përkundte Bardhokun, i këndonte,

e merrte në krahë dhe në ditët me diell e shëtiste buzë përroit të Bardhë, që kalonte mes për mes sektorit.

Zhurmave të vjetra e të njohura të sektorit, iu shtua për herë të parë guisja dhe të qarët e një foshnje. Kur e dëgjonin sharrëxhijntë vinin buzën në gaz dhe sektori u dukej më familjar e më i dashur.

Për herë të fundit ajo e pa Frrokun të gjallë mëngjezin e atij katër marsi. Ishte një ditë e zyrtë, e lagësht, e mjegullt. Ai, si çdo mëngjes, iu afrua djepit të foshnjes, i ciku me gisht majën e hundës, buzëqeshi dhe iku, me bukën e drekës të lidhur në shami.

Mbas disa orësh shokët e sollën në vig. E kishin vrarë trupat. Asaj diçka iu shemb përbrenda, por nuk klithi, as nuk qau. Gruaja e malësorit nuk duhet të qajë, madje ajo duhet të mbajë me gajret edhe të tjerët.

Kur hodhi grushtin me dhe në varrin e tij, ndjeu se i lëshoi pranë zemrën e saj prej gruaje. I kishte mbetur zemra prej néné, prandaj, si u dha dorën burrave te skaji i pllajës, nxitoi te Bardhoku që e kishte lënë lidhur në djep. Ai qante, donte ushqim, por asaj i qe prerë gjiri.

Sharrëxhijntë i sollën qumësht lope nga familjet e tyre. Madje disa shkonin enkas në mes të javës në shtëpi. Kur sëmurej vogëlushi, shqetësohej gjithë sektori. Ndoshta për fëmijët e tyre nuk shqetësohejshin aq shumë. Bardhoku i Frrokut duhej të jetonte, të rritej. Ata, kumbarët e tij, ishin tani edhe prindërit e tij.

Bardhoku po rritej, po bëhej me shkollë, por Frroku...

— Ec, moj Mrikë, e nxehu pak! — tha përsëri Staka.

— Nuk mërdhish! — tha Mrika, e shkëputur nga filli i mendimeve. — U nxeha boll në shtëpi. Zjarrin e lashë të ndezur, që të mos mërdhihë vocërraku i nënës.

— Si e ke?

— Mirë, faleminderit.

— Krejt mirë?

— Po, krejt mirë. Pse po pyet kaq hollë, ti mbrëmë e pe!

— Po, por më dukesh e mërzitur sot. Kujtova se mos...

— Eh, more Stakë, harrove, pra?

— Çfarë moj Mrikë?

— Sot është katër mars. Dhjetë vjet më parë...

— Zëri iu drodh paksa. Ajo shtrëngoi buzët dhe ktheu vështrimin mënjanë. Sytë i vajtën te dritarja, që sillte dritën kaltëroshe të agimit.

— Sot qenka katër mars! — tha Staka, si të fliste me vete. Me një qartësi të madhe i erdhën në kujtesë ngjarjet e asaj dite.

... Qiell i murmë, shi i imët, i ftohtë, trupa të lagur. Ai dhe Frroku ndodheshin në kreshtën e stivës. «Ho-hop!». Capinat e tyre nguleshin me një goditje në skajet e trupit. Ai rrrokullisej ngadalë mbi të tjerët, me gjëmimin karakteristik të drurit. Por, ja edhe një gjëmim tjetër i mbytur, diku thellë, nën këmbët e tyre. Veshi ua kapi menjëherë. Dikush bërtiti «ruajuni»!. Stiva u drodh si nga tërmeti. Britma të tjera, «ikni, trupat!». Ata po iknin, duke kërcyer trup më trup. Krisma u bë bubullimë. Trupat rrrokulliseshin, kërcenin, goditnin njëri-tjetrin, gjëmonin. Ishte afër skaji i stivës. Ai mblodhi gjithë

fujitë dhe u hodh, me duart e shtrira përpara, si të kërcente në lumë. Sakaq ndjeu një goditje të fortë në këmbë dhe iu errën sytë.

Kur i çeli e pa veten të shtrirë mbi degë bredhi. Vetëm njëri nga shokët i qëndronte pranë. «Shyqyr që shpëtovë!» — i tha.

«Po Frroku?»

Tjetri nuk iu përgjegj. Por sytë i kishte të mje-gulluar. Pra Frroku... Nuk e ndjeu më dhembjen e këmbës. Iu njomën sytë. Shoku mund të qajë për shokun...

Staka iu afrua Mrikës, duke çaluar më shumë se zakonisht. I vuri lehtë dorën në sup dhe e vështroi në fytyrë, me ngulm. Ajo lëshoi broken që sapo kishte mbushur dhe ngriti sytë.

— Mrikë, Frrokun nuk e kemi harruar!

— Unë e di që s'e kini harruar. Unë dhe voci i tij e dimë. Pa ju... Sytë e saj u ngrohën, u mjegulluan pak dhe ajo, e trembur nga vërshimi i ndjennave, ktheu vështrimin gjetiu.

— Hej, ju, mirëmëngjesi! — thirri Vuka, me gjallëri, duke përplasur fort këmbët te pragu. — Qenkam i pari sot.

— Jo vetëm sot! — tha Staka.

— He, u plakëm, bre Stakë. Na del gjumi herët.

— Je ende i fortë, o Vukë, si një lis.

— Lisat e moçëm duken të fortë, por kur i rrëzon sharra, shpesh dalin me zvagër përbrenda.

— Ti s'je syresh. Përndryshe nuk do ta përdorje capinën në trupa më lehtë se lugën në tasin më fasule.

— He, capina... Sikur pa punuar ta mbash tri-dhjetë vjet në sup, ta bën gropë, jo më të kthesh

trupa me të. Por nuk e lëshojmë, pa i gjetur duar të mira.

— Hë, më të lumtë ajo gojë! — tha Staka. — Një kafe me shumë si zakonisht? — e pyeti pastaj.

4.

Ndreca çeli sytë, megjithëse nuk ishte ngopur me gjumë. Sakaq e kuptoi c'ia kishte nxjerrë gjumin para kohe. Ishte drita e bardhë, e pazakontë për atë orë, që vërvshonte nga dritaret e fjetores. Flaku batanijet, kérceu nga shtrati dhe ashtu siç ishte, rendi e çeli kanatat e derës. Bora që ishte mbledhur në kullesat e tyre u shkund. dhe i ra mbi këmbët e zbathura. Në gjoksin e zbërthyer ndjeu ftohtësinë e ajrit.

Jashtë bora i qe afruar pragut të dritares. Shtegu për në mensë, që sapo kishte filluar të rrihej, ishte e vëtmja e çarë në atë bardhësi të butë, me trajta të rrumbullosura, vezake.

«Paska rënë më shumë se pesëdhjetë cantim, dreqi e marrtë!» — mendoi Ndreca. — «Ku na e gjeti, rezerva ushqimore pothuaj është mbaruar, naftë kemi vetëm dy fuçi, stabilimenti pret trupa, traktori pa hidraulik...»

E la dritaren çelur dhe filloi të vishej. Vuri re se shtrati i Vukës ishte i rregulluar. Ai qenkësh çuar i pari, si zakonisht. Lleshi qe shtruuar këmbëkryq mbi batanije dhe po mbushte çibukun, me një pamje të menduar. Frroku flinte ende.

— Na e bëri me të pabesë! — tha Lleshi. — Na kapi ngushtë, si në punë, ashtu edhe në familje.

— Dimri përherë i pabesë ka qenë në bjeshkët

tona, o Llesh! — ia priti Ndreca duke mbathur çizmet.

Lleshi u kollit, kroi zërin, pastaj tha pa i ngritur sytë nga qesja e duhanit:

— Shoku Ndrecë, kam një lutje!

— Lutje qysh në pikë të mëngjesit?! Të qenka shfaqur në ëndërr, si duket!

— Jo, jo e pata ndërmend qysh mbrëmë, por s'gjeta rast... Kam nevojë pér nja dy-tri ditë leje.

— Leje në këtë hall që po gjendemi! — u aca-rua Ndreca. — Mos e fol!

— Kam disa nevoja të ngutshme andej nga kulla.

— Ti s'e ke shtëpinë të shkretë, as pa mashkull. Mandej, secili e ka një hall në ditë bore, por puna mbi të gjitha.

— Por...

— S'bëhet, Llesh! — ia preu Ndreca, duke dalë.

Lleshi rrasi qesen dhe çibukun e mbushur në xhep, kërceu nga shtrati me një shkathtësi të pazakontë dhe ia nxori dufin Frrokut. E kapi prej këmbe dhe i thirri:

— Çou, hej, të çaptë ujku, se të zuri mesdita! Çiftin tënd e quajnë punëtor të dalluar, mandej!

Ndreca u fërkua me borë, gjer sa e ndjeu veten krejt të freskët e të kthjellët, pastaj u kthyte në fjetore, që të merrte peliqen. Te pragu desh u përplas me Lleshin, që doli i zymtë, me torbë në sup dhe pa vegla pune.

«Po ky, mos ka ndërmend t'ia mbathë pa leje» — mendoi Ndreca, por sakal iu kujtua se i duhej gjetur shok rruge traktoristik Lulash dhe nxitoi pér nën mensë. Sapo hyri dëgjoi zërin e Stakës:

— Hë, më të lumtë ajo gojë! Një kafe me shumë, si zakonisht?

— Po, edhe një të mesme, për shokun Ndrecë!
— porositi Vuka.

— Si do të dalim nga kjo gjendje? — i kërkoi
mendim Ndreca, duke zënë vend në tryezë, përbalë
tij.

— Do t'ia dalim! — ia priti ai, me zë të qetë. —
Se mos është hera e parë! Ia kemi dalë edhe në ditë
më të vështira.

— Punë boshe! — tha me shpoti Lleshi, që po
kalonte pranë tyre, me një pjatë fasule në dorë. —
Bora nuk po shkundet nga degët, veri nuk fryn,
qielli është i rëndë. Prite kur t'ia fillojë përsëri.

— Edhe në filloftë, dikur do të pushojë, o Llesh
Gjoni! — ia priti me mllef Vuka. — Atë pjatë me
fasule dhe atë bukë gruri nuk na i gatuajnë për të
pritur duarkryq.

— Do të lodhemi kot e s'ka për të na dalë gjë,
as për plan e as për xhep! — murmuriti Lleshi dhe
zuri vend në një tryezë të mënjanuar.

— Duhet të ndahemi, disa për çeljen e rrugës,
disa për zbulimin dhe afrimin e trupave në skelet e
ngarkimit, të tjerët në prodhim! — tha Ndreca dhe
filloi të gierbte kafen.

— Mirë e ke, s'duhet pritur traktori! — miratoi
Vuka. — Brigadën tonë caktoje ku të jetë më vë-
shtirë, na jep detyrën dhe flije mendjen në atë krah.

Ndreca u mendua një copë herë, duke gjerbur
kafen me hurpa të vogla e të dendura, pastaj tha:

— Ngastra ku punoni ju është më e afërtë me
skelen e parë të ngarkimit. A kini trupa të prodhuar?

— Kemi diçka, por duhen nxjerrë nga bora.
Disa edhe mund t'i prodhojmë.

— Ia dilni dot të furnizoni me krahë skelen e
parë?

— Duhet t'ia dalim! — u përgjigj Vuka, mbasi peshoi një hop detyrën e marrë. — Edhe në rënçin gurë nga qielli, s'e lëmë bosh atë skele! — shtoi pastaj, me vendosmëri.

— Kujdes shokët. Shikoni se mos ju ikën pa leje Lleshi. Lere dëmin e punës, po rrrezikon të ngelet në borë, se nuk i dihet motit.

— Na e lër neve atë punë! — ia bëri me dorë Vuka. — Ai është burrë i vjetër dhe duhet ta dijë se dashin që ndahet nga tufa e çan ujku.

— Ju shkortë mbarë, pra! — Ndreca gjerbi hurpën e fundit të kafes dhe brofi më këmbë. — O Stakë, e ke parë kund Lulash traktoristin? — thirri.

— Këtu është, shoku Ndrecë! — ia priti Staka nga banaku, ndërsa lëvizte duart si xhongler, përtë plotësuar kërkasat e punëtorëve që ishin grumbulluar aty. — Sa sheqer deshe ti, Lulash?

— Gjysmë kile! — ia priti ai, duke kthyer ftyrrën nga Ndreca. — Ma hidh në ndonjë qese plastike, që të mos më laget rrugës. Shto edhe një shishe konjak, edhe dy shkrepse. Ja, u bëra gati, shoku Ndrecë!

— Me kë të të bëjmë çift? — pyeti Ndreca, duke iu drejtuar më tepër vetes.

— Me asnjeri, po shkoj vetëm.

— Jo, jo, punë që s'bëhet. Na duhet shumë traktori, por na duhet më shumëjeta e shokëve... Si thoni, burra, kush i njeh mirë shtigjet e borës përnë qytezë? — iu drejtua grumbullit të punëtorëve.

— Më mirë se Mirash Pali, askush! — shfaqi mendim njeri pas një heshtjeje të shkurtër.

— I njoh edhe vetë, s'kam nevojë për shoqërues!

— nguli këmbë Lulashi i shqetësuar.

Pa ia vënë veshin, Ndreca kthehu kokën nga salla dhe kerkoi me sy nëpër tryeza.

— Ja ku qenka Mirashi, e pasqë ngrënë edhe mëngjesin! O Mirash Pali afroju pak, të lutem! — thirri.

Ai u çua ngadalë, fshiu buzët me kurriz të dorës dhe eci rëndë-rëndë drejt banakut. Lulashi ktheu shpinën, gjoja se do të bënte llogarinë me Stakën dhe u vonua, duke kerkuar të hollat nëpër xhepa. Ndërkajq dëgjonte Ndrecën që po përpiquej t'i mbushte mendjen me të mirë Mirashit.

— Mua, që jam burrë i vjetër, gjete të më caktosh këtë detyrë? — thoshte ai, duke i zvarritur fjalët, me zëmërim. — A s'ua kam mësuar boll shtigjet fëmijëve dhe nipave të kullës sime, duhet të marr për dore edhe çunakët e të tjerëve?

Lulashi ndjeu se po skuqeji nga kjo shpoti. U kthyte me vërtik dhe gati sa s'bërtiti:

— Të thashë, shoku Ndrecë, shkoj vetëm, i di shtigjet dhe s'kam nevojë për shoqërues. Madje, po nisem.

— Leri fjalët dhe mos bëj hap! — ia preu Ndreca, që kishte mbetur i habitur nga qëndrimi i Mirashit. Ai s'e kishte zakon të kundërshtonte.

«Si t'ia bëj?» — punonte me shpejtësi mendja e Mirashit. — «Të shoqëroj atë që po më merr fytryn? Punë që s'bëhet. Ç'do të mendonin shokët?... Veç në e shoqërofsha për të vënë nderin në vend... me teħun e sēpatës... Të mos shkoj? Por, atëherë provohet që e di ç'po ndodh dhe s'kam bërë gjë prej gjëje. Turp e faqe e zezë!... Në shkofsha, ndoshta do të kujtojnë se s'di gjë, se jam sylesh. Gjysma e së keqes. Ndryshe mospranimi im do të bëhet shkas bisedash, thashethemesh... Duhet marrë një vendim,

○ Mirash, se nuk pret koha. Ja, Ndreca po e humbet dërimin. S'ditka gjë, si duket, dhe habitet pse po kundërshtoj. Kurse ai Llesh Gjoni po qeshka nën mustaqe. Edhe disa të tjerë po më vështrojnë. Presin... Po, po, i duhet dhënë karar... Si t'ia bëj?

Lleshi qe çuar nga tryeza dhe, me të ecurit e njeriut që vuani nga dhembja e mesit, po drejtohej nga banaku.

«Duhet shpëtuar i ngrati Mirash nga ky lak!» mendonte. — «Do t'ia tregoj Ndrecës si është puna, ai s'duhet ta çojë, përndryshe kushedi se ç'mund të ngjasë!»

Mirashi e kuptoi vetëtimthi qëllimin e Lleshit dhe u tmerrua. Obobo, tanë do ta merrte vesh edhe shoku Ndrecë! Vendosi aty pér aty.

— Hë, Mirash, do të shkosh, apo të mendojmë pér ndonjë tjetër? — pyeti Ndreca me padurim.

— Po shkoj, unë kurrë s'ta kam prishur! — u ngut të përgjigjej ai dhe mori fryshtë thellë, si i lehtësuar nga një barrë.

— Shoku Ndrecë, pata një fjalë veças! — tha Lleshi, me të arritur. — Jo, jo, pér çështjen e lejes! — shtoi, kur pa grimasën e padurimit tek ai.

«Ka pér të ngatërruar punë ky, Lleshi!» — mendoi Vuka, që duke ndjekur së largu ndodhinë, kishte kuptuar gjithçka. Brofi më këmbë, me tri hapa u gjend pranë banakut dhe e kapi Lleshin pér krahu.

— Shko merr veglat e punës, se na vonove, ty po të presim — i tha, pothuaj ashpér. — Ke kohë në mbrëmje të qash hallet me shokun Ndrecë. — Pastaj u kthyte nga Mirashi, i zgjati dorën dhe buzagas i uroi rrugë të mbarë.

— Mirë ju gjetsha! — ia ktheu Mirashi, me sytë

përdhe. Pastaj e vështroi nga këmbët Lulashin dhe i tha me zë bubullues: — shkojmë, pra!

Hovi supet, sikur desh të rregullonte një barrë të rëndë në shpinë, dhe eci drejt derës me hapa të gjatë, pa i ngritur sytë, Lulashi shkoi pas tij, i kuq në fytyrë dhe me rrudhën midis vetullave më të theksuar se zakonisht.

Ndreca i ndoqi me sy, me një grimasë habie në fytyrë, por i harroi sa kaluan pragun, se e rrëmbyen hallet e punës. Kërkoi punëtorët e ngarkesës. Ata duhej të pastronin skelen nga bora dhe të stivonin trupat që do t'iu afronte brigada e Vukës. Për çeljen e rrugës do të caktonte të tjerë.

— Po Mirashi, ku është? — pyeti Frroku shokët e brigadës, duke kullufitur më këmbë racionin e makaronave, me shpresë se nuk ishte ai i fundit.

— Ha dhe mos pyet, se do të mbytesh! — bëri shaka Vuka. — Ai është nisur në krye të detyrës, pa u çuar ti prej gjumit. — «Vallë, si ka për të shkuar udhëtimi i tyre?» — mendoi pastaj. — «Mirashi, si burrë i vjetër, vërtet është i lidhur mbas zakoneve, e kush prej nesh nuk ruan diçka prej tyre, por nuk e besoj të bëjë ndonjë marrëzi. Ai ka qënë gjithmonë i gjykueshëm dhe i matur, mandej, kaq vjet me mësimet e Partisë!.. Ndoshta del edhe për mbarë ky udhëtim. Ndoshta diçka afrohen. Në vështirësi njerëzit e mirë afrohen. E, Lulashi është kreshnik djalë...»

Me këto mendime Vuka kopsiti peliqen, rrasi mirë kokoren dhe me capinën në sup i priu brigadës përtej pragut.

Gjallëria e mensës po shuhej me po atë hov që ishte krijuar. Tryezat po boshatiseshin njëra mbas tjetrës, duke ngelur të ngarkuara me një mori enësh

e me gjithfarë mbeturinash, në pozicionet më të ndryshme.

Duke u munduar të rivendoste rregullin, Mrika shkonte ec e jak, nga tryezat në sportelin e kuzhinës, me pirgje enësh të palara në duar. Ekte me hapin e saj karakteristik, por diçka më shpejt se zakonisht dhe vështronte shpesh nga dera.

«Thua të bëjnë mësim sot?» — mendonte. «Shkolla s'është larg, por ka shumë borë dhe Baradhoku është ende i vogël. Në mos bëfshin, tani duhet të mbërriji.»

Staka pastronte banakun me lëvizje të plogëta dhe me pamje të lodhur. Mengjesi ishte gjithmonë më i vështiri për të, se sharrëxhijtë nguten në punë dhe janë të padurueshëm, por sot kishte qënë më vështirë se tjetër herë.

Në këndrejtin e derës, tashmë të ndriçuar plotësisht, u dukën dy silueta. Staka vrënji vetullat. Kush qenka çuar kaq vonë nga gjumi? Sa kaluan pragun dhe u ra drita në ftyrë, ai njohu operatorin dhe inxhinierin. Atëhere buzëqeshi dhe i përshëndeti me zë të lartë.

— A patët ftohtë, a fjetët mirë?

— Jo, ftohtë nuk patëm, po për të fjetur... disi!

— iu përgjegj Fredi, duke zënë vend në tryezën pranë banakut. — Me gjithë profesionin endacak që kam, sa herë ndërroj shtrat, nuk fle rehat.

— Ç'do të hani? — pyeti Staka.

Fredi u mendua një çast, duke fërkuar mjekrën.

— Gjalpë, reçel dhe qumësht... Jo, qumësht jo. Harrova se është prej pluhuri. Nu k ia duroj dot erën. Më mirë çaj.

— Po ju, shoku Bledar?

— Një kafe të mesme! — iu përgjegj ai, me shenja të theksuara padurimi.

— Nuk ecet nëpër borë me një kafe! — vërejti Staka.

— S'kam kohë. Më erdhi lajmi se Paloka po më pret te Qafa e Keqe qysh pa dalë drita. Do të marr një pako biskota pesëlekëshe dhe disa llokume. M'i mbështill, të lutem! — Ai vështroi me mllaf operatorin sikur desh ta qortonte «Ah, ç'më more në qafë!» dhe vuri në buzë një cigare, me gjeste nervoze.

Fredi u shtriq, gogësiu, fërkoi duart me vrull dhe vështroi një punëtor, të vetmin në sallë përveç tyre, që po hante me ngut.

«Obobo, që pa gdhirë fasule me mish derri të konservuar!» — mendoi. — «Stomaku i tyre duhet të blua jë edhe gurë, me ç'shikoj!»

Bledari gjerbi me ngut kafen, sa s'u përvëlua, dhe brofi në këmbë.

— Stakë, amanet mikun! — tha, duke i shtrirë dorën Fredit.

— Më ngadalë, se s'të ikën treni! — buzëqeshi operatori, duke ia shtrënguar lehtë. — Po na lënke vetëm, pra?

— Mos u bëj merak, zjarr do të kesh, kafe kur të duash, vetëm ekspres nuk ta bëjnë dot. Mirë mbetshi.

Fredit i erdhën të tharta këto fjalë dhe ia ktheu përgjigjen ftohtë nëpër dhëmbë.

— Nxirri pantallonat mbi çizme, përndryshe do të të mbushen me borë! — e këshilloi Staka inxhinierin, ndërsa ai po dilte, me nxitim. — Djalë i mirë, i papërtueshëm! — iu drejtua pastaj Fredit. — Veç, larg familjes. Është edhe i fejuar.

— Ku të jetë nevoja do të punojmë, Stakë! —

— Patjetër, por do të ishte më mirë të kishim inxhinierë nga bjeshkët tonë. Pse të vijë Bledari së largu, duke pasur djemtë tanë? Për dy kokë dhi a pér një krah pune, i kemi mbajtur te shtëpia, pa shkollë. Sa bursa na janë djegur, disa vjet të shkuanra! Vonë na erdhën mëndtë, madje jo krejt. Na i solli Partia, pérndryshe...

— Erdha, nënë! — u dëgjua një zë i gëzueshëm fëminor së bashku me disa hapa që rendnin në dysheme.

— Mirë se erdhe, Bardhoku i nënës! T'i kishe shkundur çizmet te pragu, se na solle borë.

Fredi ktheu kokën dhe pa një çunak dhjetëvjeçar, trupshëndoshë, por me trajta të zhđervjellta, me fytyrë të rrumbullakët e të skuqur. Mrika i kishte mbështetur dorën mbi flokët e qethur shkurt dhe sytë i qenë ngrohur nga dhemshuria.

— Nuk do të bëni mësim? — pyeti ajo.

— Jo. Erdha të të ndihmoj. Mësuesi ka dalë sippër, te qafa, se mos neget ndonjë nxënës në borë... Si jeni, a kini ftohtë? — iu drejtua Fredit, sapo e pa. Kishte sy të mëdhenj, të kaltër e me qerpikë të gjatë.

— Jo, jo! — buzëqeshi Fredi, duke nderur këmbët drejt sobës. — Nga është mësuesi juaj?

— Nga Korça.

Staka tundi kokën, duke dashur të nënvizonte mendimin e posashfaqur.

— A ju mëson mirë? — pyeti Fredi.

— Po, shumë mirë. Ka edhe djalin e vet në klasën time. Nënë këto tryeza po i pastroj unë.

— Kujdes se mos thyesh pjatat! — e porositi ajo.

Bardhoku iu vu punës, me shkathtësinë e moshës. Staka fiku dritat e banakut dhe zuri vend pranë Fredit. Një copë herë u nder heshtja. Dëgjohej

vetëm tingëllitja e enëve dhe bubullitja e zjarrit. Nga dritat e vërvshonte drita e fortë e ditës me borë. Të dy burrat pinin cigare. Afshi i sobës e ndiqte tymin e duhanit.

Mbas pak kërkëlli dera dhe në drejtkëndëshin e bardhë u shfaq silueta e një sharrëxhiu, që sikur ngurronte të hynte.

— E keni mbyllur, a?

— Ti Llesh qenke? — u çudit Staka, duke picërrruar sytë. — Ç'deshe?

I posaardhuri kaloi pragun dhe mbylli derën.

— Ja, thashë... thashë mos ju kanë tepruar nja dy bukë... Desha edhe dy kile makarona, një sheqer dhe disa kaushë me duhan! — tha si me të lutur, duke hequr torbën nga supi.

— Ç'të duhen gjithë këto te puna? — pyeti Staka, ashpër.

— Mora leje. Do të shkoj në shtëpi.

— Gënjen, ke ikur fshehurazi! — buçiti Staka, duke brofur më këmbë, i skuqur në fytyrë. — Si s'ke turp, je edhe burrë i vjetër. Shokët po luftojnë me borën, kurse ti... Hm!

— Mos ma merr fytyrën para mikut, se nuk gënjë! — u shtir i zemëruar Lleshi. A s'po m'i jep, a?

— Të ishte luftë, do të të kishim dhënë një plumb ballit, dezertor!

— Më ngadalë, se jemi burra malësie dhe dutimi ka karar! — u hakërrye Lleshi. — E ke lehtëti, pranë sobës!

Staka u ul, duke i kthyer krahët dhe pështyu me kuptim, në drejtim të sobës. Tjetri ngeli në këmbë me torbë në dorë dhe s'dinte ç'të bënte. Fredi po e vështronë me ngulm, sikur të ishte ndonjë ekzemplar i rrallë. Sakaq dera krisi dhe u çel me

vrull. Hyri Frroku, i kuq në fytyrë e duke dihatur shpesh.

— Këtu qenke, Llesh, a?

Ai s'iu përgjigj. Qëndronte i ngrirë, si ndonjë shtatore. Torba e varur në dorë, kishte prekur dyshemenë.

— Paska marrë leje të shkojë në shtëpi! — e shpotiti Staka, pa e kthyer kokën.

— S'jam as fëmijë dhe as i burgosur, që më ndiqni kështu! — shpërtheu Lleshi, duke ngritur ca sy të skuqur e të errësuar.

— Mos kujton se s'ia dalim dot pa ty? — ia priti Frroku. — Sa i marrë qenke! Për ato thinja, të takojnë më shumë mend. Ne e patëm më shumë për ty, se po ike vetëm mund të ngelesh në borë. Tani, ik po deshe, s'të kemi më borxh. Me zor nuk të mbajmë. Veç, në arritsh gjallë, mos u kthe më në brigadën tonë. Kështu më porositën shokët.

Frroku iku me po atë vrull që erdhi. Lleshi mbe-ti një hop si shtatore, pastaj u kthye dhe doli, më i kërrusur se zakonisht, duke zvarritur këmbët dhe torbën në dysheme.

«Ç'ndodhi e fortë!» — mendoi Fredi. — «Do të ishte një skenë e mrekullueshme dramatike për film. Por, do të duheshin aktorë të mëdhenj, për ta dhënë ashtu siç ndodhi.»

Staka tundi disa herë kokën, pastaj brofi më këmbë, shkoi te banaku dhe nisi të sorollatej mbastij, duke i gjetur punë vetes. «E ke lehtë ti, pranë sobës», i jehonte në vesh zëri i Lleshit. Hm, ç't'i bënte mikut, se do të kishte dalë qyshkur me shokët. Edhe tani, si mbi gjemba rrinte, por miku është mik.

Fredi ndoqi një copë herë gjestet plot nervozizëm të banakierit, pa e gjetur dot me mend shkakun

e tyre. E pse të shqetësohej aq shumë Staka për gjestin e Lleshit?

«Është vështirë t'i kuptosh thellë këta malësorët! — i dha karar më në fund, duke vështruar orën e dorës. Nëntë e njëzet. Si do të kalonte gjithë paratiten? Të porosiste edhe një kafe? Jo, e kishte akoma në gojë mbresën e së parës. Tani edhe Staka është bërë «flu» nga zemërimi, s'ke ç'bisedon me të. Ndjeu se po e pushtonte mërzia. U çua dhe iu afrua pragut të derës. Picërroi sytë nga drita e fortë.

Shtigjet e sapoçelura në borë dukeshin si brazda të thella. Gjetiu shtrihej një bardhësi e valëzuar, e butë, që sikur të joshte të shtriheshe mbi të. Thuprat e dendura të shëlgjishteve buzë pérroit, të harkuara gjer përdhé, mbanin përsipër jastëkë të mëdhenj bore, me trajta nga më të ndryshmet. Përtej tyre dallohej pérroi, me një shkëlqim të venitur. Në shpatin kundruall shquheshin qartë, si qirinj viganë, të kuqërrëmtë, trungjet e drejta e të dendura të pishave. Pjesët e pambuluara nga bora të kurorave, dukeshin si njolla të gjelbra, në të zezë. Hijet ishin të lehta, pothuaj të padukshme. Konturet e maleve nuk shquheshin mirë. Qielli thua jse ishte vazhdim i asaj bardhësie. Nuk frynte erë, nuk lëvizte asgjë, me përjashtim të një fjalë tymi, që ngrihej drejt e përpjetë nga oxhaku i barrakës kundruall.

Fredit iu duk sikur ajo qetësi e bardhësi prehëse, i vërshoi edhe në brendësi. U kthyte dhe hyri në mensë. Tani ajo iu duk e errët, e mërzitshme.

— Stakë, nuk bëka shumë ftohtë, qenka mirë jashtë! — tha.

— Nuk bën ftohtë! — miratoi Staka mekanikisht.

— A është e vështirë për t'u ngjitur te punëtorët?

— Jo dhe aq, se shtegu është i rrahir.

«Po sikur të marr aparatin dhe të dal tek ata» — i shkrepri Fredit. — «Vërtet e kam mbaruar normativën e filmit, por s'bëhet kijameti për disa metra. Patjetër do të gjej diçka të bukur, që do ta bëjë dokumentarin më interesant. Po, duhet filmuar, është një rast i mirë. Nuk bën edhe aq ftotë... Të tjerët bredhin mbas një rasti të tillë, kurse mua më erdhë te dera, pse ta lë të më shpëtojë? Po me kë të shkoj deri te punëtorët?

— Stakë, ç'punë ke tanë? — pyeti.

— Deri në drékë, asnjë punë. Ja, po ju bëj shoqëri! — u përgjigj banakieri me mirësjellje, por disi i zymtë.

— Mund të më shoqërosh deri lart? Dua të filmoj diçka.

— Posi, me gjithë qejf, — u gjallërua Staka dhe uli me ngut tarabën e banakut, se mos i ndërrrohej mendja tjetrit.

Mbas pak, në mensë ngelën vetëm Mrika më të birin, që po përfundonin pastrimin.

— Nënë, po tanë ç'do të bëjmë? — pyeti Bardhoku, mbasi zbrazi koshin e fundit të plehrave. — Të gjithë kanë shkuar, veç nesh dhe Vatës, kuzhinerit. Vata do të gatuaj drekën, po ne?

Sytë e Mrikës sikur shkrepëtinë, pastaj qeshën, si rrallëherë.

— Shkojmë edhe ne te shokët e babës, ore voc!

— tha duke i mbështetur lehtë pëllëmbën në sup.

— Ec e merr lopatën tonë. Në kthinën e drove e ke. Unë po marr të mensës.

Ajo e ndoqi me sy, ndërsa ai vrapon me shkathësi në shteg. Një mall i vjetër i shpërtheu në gjoks, dhe ndjeu se po i njomeshin sytë.

«O Frrok, o trim i Mrikës, pse s'rrojte të shikoje sa kreshnik po të rritet djali!»

Ajo zhveshi bluzën e bardhë, mbylli derën e mensës me dry, ia la çelësin Vatës dhe doli të priste Bardhokun te kreua i shtegut. Ai erdhi duke renëndur, me lopatën në sup. Ajo e vuri të printe, si burrin e shtëpisë. I ngjiteshin shtegut me hapin e lehtë e të shkathët të malësorit.

Kur kaluan karshi pllajës, në të cilën ndodhej varri i të shoqit, ajo vështroi gjatë andej dhe i thirri me zë të brendshëm:

«Frok, o trim, vegla jote s'po ngelet e shkretë sot krahu yt do të jetë krah shokëve!»

Pastaj ktheu sytë nga shtegu, mbushi gjoksin me ajrin e ftohtë të pishnajës dhe vështroi lart, nga qafa ku duhej të dilnin.

5.

Mirash Pali s'i ngriti sytë edhe mbasi e kaloj pragun e mensës. Vështronte majat e çizmeve të tij të mëdha tek çapiteshin në borë dhe i dukeshin si të tjetërkujt. Kokën e ndiente të rëndë, i buçisnin veshët dhe e mundonin lloj-lloj mendimesh që rendnin njeri mbas tjetrit, diku të veçuar e diku të përzier si retë në qiellin e atij mëngjesi.

«... Pse pranova ta shoqëroj? Më mirë të mos kisha pranuar, të dilte ku të dilte... Atëherë Lleshi... E pastaj? Le t'ia thoshte Ndrecës e kujt të donte! Në mos sot, nesër ka për t'i dalë tymi. Se tymi s'fshihet në gj... Por, pse lodhem kot? Tashmë kjo punë mori fund dhe s'më ngelet tjetër veçse ta gëlltis këtë kafshatë...»

Kur arriti në kryqëzimin e shtigjeve, u kthyte në drejtim të fjetores me mendimin e turbullt se diçka duhej të merrte. Te pragu i dhomës shtangu. Ç' duhej të merrte? Iu kujtua sëpata e vogël me bisht të shkurtër dhe e kërkoi në qoshen ku mbanin veglat. E mori dhe doli me të në dorë.

Lulashi e priste në kryqëzim, kokulur, duke gërmuar borën me majën e çizmes. Mirashi, me një lëvizje të zemëruar e ngjeshi sëpatën në brez, mbërtheu peliqen dhe kaloi përpara.

«Si më vështroi» — tha me vete Lulashi, duke pritur që tjetri të largohej pak. — «Sytë e tij veç që nuk e shprehnin me fjalë urrejtjen! Duket sheshit që ka marrë vesh gjithçka. Bardha s'ka guxuar t'ia thotë, por, në të tilla raste gjëndet dikush që ta thotë... Ç'ngatërrësë! Pse nuk u çova pak më herët? Ndoshta Ndrecë do të caktonte tjetërkë... A kalohet gjithë kjo rrugë bashkë. Vështirë për të e vështirë për mua!...»

Mirashi i ngjitej shpatit me ngut. Donte ta përshkonte sa më shpejt shtegun që rrihej nga sharrë zhinxjtë, të largohej sa më parë nga sytë e shokëve. Po i merrej fryma, zemra i rrihte fort, por s'e ngadalësonte hapin. Diku preu shkurt, megjithëse bora e pashkelur e bënte edhe më të vështirë ngjitjen.

«Turpi u bartka më lehtë vetëm!» — mendoi. — «Më mirë të më ndiqte vdekja se ky njeri. Qysh se kam lindur nuk e kam parë veten më ngushtë... Ah, Ndrecë, Ndrecë, në ç'provë të rëndë më fute! Të dyshoja se e di çështjen do të të quaja armik për jetë. Si s'më ra pika e të mos më zinte kjo ditë!

Lulashi e ndiqte nja njëzet hapa mbrapa. Ishte kaq i përqëndruar në mendime sa, megjithëse vësh-

tronte me ngulm shtegun, nuk shkelte në gjurmë, por kuturu dhe shpesh fundosej në borë.

«... Po ikën prej meje, si prej një ujku të tèr-buar... Po më ardhka keq pér tè. Por, a thua jemi fajtorë unë e Bardha?... C'faj patëm që u njohëm dhe pastaj u deshëm? C'faj patëm që Bardhën e kanë fejuar, sipas zakonit, me një njeri që s'e njeh dhe, pra, s'ka si ta dojë? Se, po ta njihte dhe ta pëlqente, kjo ngatërrresë s'kish pér tè ndodhur!... Por, nga ana tjetër, tè kesh tè bësh me një vajzë tè fejuar është pabesi. Pabesi karshi atij tjetrit, pabesi karshi prindërve tè saj... Pse pabesi? Unë e kam prekur Bardhën, sa ç'kam prekur maiën e asaj pishe, atje! Vëtëm se e dua, se më do?... Sidoqoftë, tè larë e ballë-hapur s'jemi. I kam thënë Bardhës, ajo duhet tè flasë me njerëzit e vet, duhet ta prishë fejesën. Është e vështirë pér tè? Sigurisht, e vështirë është, madje shumë e vështirë. Ata mund ta shtrëngojnë, mund ta rrahin, madje mund ta... Jo, s'e besoj tè arrijnë gjer atje! Por, sidoqoftë, rrugë tjetër s'ka...»

Në malësi nuk gjëndet lehtë vau pér tè hedhur lumin. Lumenjtë tanë janë shumë tè rrëmbyer!... Prej më shumë se një çerek shekulli po lodhet Partia që t'i shkuli barërat e këqija nga kokët tonë, mjaft ka shkulur, por edhe kanë mbetur. E, rrënjetat e tyre lëshojnë filiza tè helmatisur. Po s'u qëndrove gati, hedhin shtat... Besa, asnjeri prej nesh s'është pa to... Ja, sikur kjo që më ndodh mua t'i ndodhët një tjetri, motrës sime pér shembull, a do të gjykoja kështu siç gjykoj tanë?... Ah, sikur tè punonte capina apo ruspa e traktorit pér tè shkelur këtë lloj grami!...»

Lulashin e shkëputi nga mendimet një frymë-marrje e shpeshtë dhe rëndë. Ngriti sytë dhe fare

afër pa shpinën e Mirashit. Ai nxítonte e nxítonte, me zverkun tē nderur përpëra, me supe tē rrëzuara, me krahë tē lëshuar ngathët, duke shkelur me inat e pa siguri në borën e shkrifët.

— Tani më takon mua tē prij! — tha Lulashi, sikur i drejtohej një tē treti.

— Për tē prirë ma paguajnë mua sot ditën e punës! — bubulloj Mirashi duke u munduar ta përmëbante frymëmarrjen e rëndë dhe nxitoi edhe më shumë.

«Dikur e ngjitja me një frymë këtë shpat!» — mendoi. — «U plaka, sot po e kuptoq që u plaka, dhe ujku plak bëhet gazi i qenve; por jo, s'kam pér t'u bërë gazi i këtij qeni. Mos kérce kështu moj zemër, por ja përballo, ja plas. Dhe ju, o këmbë, mos më lëshoni. Ja sot, ja kurrë!»

Mirashit i qe trashur pështyma, i merreshin mendtë, i zirej fryma. Coi dorën te gryka, zbërtheu jakën e këmishës dhe zgjeroi qaforen e bluzës së leshtë. I dukej sikur nga çasti në çast do tē përmbysej në borë, madje sikur i pëlgente tē ndodhte kjo. Zgjati dorën, rrëmbeu kalimthi një grusht borë, lagu buzët dhe fërkoi fytyrën me tē. Nuk mendonte as gjë, veç i diktonte vetes me ritmin e hapit «ec, ec, ec...».

«Është e kotë t'i propozoj tē pushojë. S'ka pér tē pranuar!» — mendoi Lulashi! — «Por, ky i ngrati, është lodhur sa s'mban!» — Ngadalësoi hapin dhe ca nga ca largësia ndërmjet tyre u rrit.

Mirashit iu duk sikur nuk po i dëgjonte më hapat e pasuesit. Me kujdes, tinëzisht, ktheu kokën. Sa mirë, ai paskësh ngelur mjaft mbrapa! Ngadalësoi hapin, u mundua tē ngopej me frymë, ngriti sytë dhe

vështroi nga qafa. Ishte ende larg, shumë larg. A do të mundej të arrinte gjer atje pa pushuar?

Lulashi, pa qëllim, duke ecur me ritëm të njëjtë, iu afrua përsëri.

— Kam nevojë të pushoj pak! — tha enkas kur u afrua.

Mirashi u lëshua sakaq tek rrinte dhe nxori kuttinë e duhanit.

«S'paska pasur takat të këpuste degë pishe për t'i shtruar, por qenka lëshuar drejt e mbi borë, i ngrati!» — mendoi Lulashi, ndërsa ia bënte vetes këtë shërbim.

Zuri vend dy hapa larg Mirashit. Ai hovi krahët dhe i ktheu kurrizin, përgjysmë. Pastaj deshi të ndizte cigaren. Shkrepja nuk po i ndizej, si duket qe lagur. Lulashi futi dorën në trastë, nxori njëren shkrepse dhe ia zgjati, por tjetri bëri sikur nuk e pa dhe vazhdoi të provonte me nervozizëm duke i flakur fijet në borë gjersa njëra u ndez. Lulashi duke buzëqeshur, e futi shkrepsen në trastë. Nxori që andej qesen plastike me sheqer, mbushi grushtin e vet dhe ia zgjati përsëri tjetrit.

— Urdhëro e merr, Mirash!

Ai ktheu përsëri kokën, e pa me përcëmim dhe tha me shpoti:

— Kur kthehem në kullë, për t'i marrë me të mirë nipat e mbesat që zvarriten rrëth vatrës, ua mbush dorën me sheqer.

— Unë, karshi teje, edhe në mos qofsha sa nipay, prapë larg jam dhe më takon të ta duiroj deridiku shpotinë! — tha Lulashi butë. — Megjithatë, sheqeri të bën mirë në raste të tillë. E kam provuar kur isha ushtar në kufi.

— Të bëftë mirë, pra! — ia preu Mirashi dhe shfryu me duf tymin e duhanit.

Lulashi mori pak borë të pastër, e përzjeu me sheqer në grusht dhe e kafshoi me èndje. Kur u ngop, ia lidhi nyje grykën qeses, e futi në trastë dhe nxori që andej shishen e konjakut.

— Prej kësaj ndoshta pranon disa hurpa! — iu drejtua përsëri tjetrit. — Kjo veç pér burra èshtë.

Ai ktheu kokën pa e fshehur bezdinë që i sillte këmbëngulja e tjetrit, e pa shishen dhe tha me përqëmim:

— Nuk e pi rakinë me bojë... A thua ka më në atë trastë?

— Malësori ç'ka në trastë e ndan me shokë, s'e ka zakon as të hajë e as të pijë vetëm! — ia priti Lulashi me krenari.

— Ti e bëre borxhin tënd! — tha Mirashi më butë.

— Kurse ti jo. Sikur helm të të kisha dhënë... Veç prej armikut nuk merret gjë, kurse unë as jam dhe me dëshirë as bëhem armiku yt.

— Fjala dhe vepra s'shkojnë gjithmonë bashkë!

— Varet si i gjykon veprat.

— Siç i kanë gjykuar gjysh-stërgjyshi, malësorët!

— Nuk i kanë gjykuar gjithmonë mirë.

— He, dolët ju t'i gjykon më mirë! — shpërtheu Mirashi. — Ju, që s'u èshtë tharë ende qumështi në buzë, ju që hani borë me sheqer dhe pini raki me bojë, ndërsa të parët tuaj janë shtrënguar të mbartin në krahë me caliqe ujë të kripur nga Shëngjini, se edhe kripa u mungonte! Mandej keni fytyrë të përqëmoni zakonet, të ciilat na kanë sjellë shqiptarë e me nder deri në ditët e sotme; keni fy-

tyrë të gjykonit për urtësinë e të parëve që kanë prirë **kaq** breza mes tufanit të jetës...

— Mos e merr me kaq turr, o Mirash Pali, se rrëzohe e thyen qafën! — e ndërpren Lulashi, urtë dhe ashpër njëkohësisht. — Që jemi të rinj dhe s'kemi jetuar vuajtjet tuaja, është e vërtetë; që s'duhet t'i harrojmë, është e drejtë, por se jetojmë më mirë e kërkojmë të jetojmë edhe më mirë, s'bëjmë keq, sepse ky është qëllimi i punës sonë dhe i Partisë. Sa për zakonet, të mirat s'i përcmon kush. Kur shkojmë e lahem i te çesma, nuk fërkohemi për të rrjepur lëkurën, po për ta pastruar atë prej zhulit. Zakonet e mira janë lëkura jonë, por në të ka ngjitur zhuli i kohrave, kur ne, malësorët, përpinqeshim të ishim njerëz po s'na linin priftërinjtë e bajraktarët. A duhet të ngurojmë për ta pastruar këtë zhul? Jo, o Mirash, sepse atëhere do të zbardhojë më mirë fytyra e zakoneve të mira. Por, sa keq se për ta larë këtë fytyrë s'bën dobi ujët e çesmës.

Mirashi gjërvishëtë borën me gishtin tregues dhe vështronë larg me një shprehje të ngurtë, gjoja se nuk ua varte fjalëve të tjegrit, por, ndërkaj e dëgjonte me vëmendje dhe i vinte inat që ai dinte të fliste kaq mirë. **Të mos ishte Lulashi, ndoshta do të pranonët se kishte të drejtë.**

— Ne i duam dhe i respektojmë baballarët, siç na duan edhe ata! — vazhdoi Lulashi. — Sepse, ajo pisha që kemi kundruall s'bën dot pa rrënji, ashtu sikurse edhe rrënjet s'duhën gjë po ta presim pishën. Edhe urtësinë tuaj e çmojmë, edhe fjalën tua dëgjojmë, por para së gjithash duhet dëgjuar fjala e Partisë, që është e urta më e ditur dhe që si bletë punëtore, nga urtësia e brezave ka bërë mjaltë duke iu ruajtur luleve që e prishin mjaltin.

— Cohu, se na zuri mesdita! — e ndérpreu Mirashi, duke brofur më këmbë. — S'kemi dalë pér ligjérata në bjeshkë. Sa pér Partinë e kam njojur e dëgjuar para teje.

— Varet sa ka mësuar secili prej saj! — tha Lulashi duke u pregititur pér udhëtim.

— Po qe nevoja pér të mësuar, s'kam ngelur të më mësosh ti! — ia priti Mirashi me mospërfillje.

Tashmë ai ndihej i çlodhur, i freskët, madje ndiente pak të ftohtë, prandaj kopsiti peliqen. U mat të kalonte i pari, por Lulashi me dy hapa i doli pérpara dhe e ndaloi.

— Zakoni i mirë i malësisë është që burrat në udhëtim ta çajnë me radhë borën! — i tha. — Tani më takon mua kjo punë. Në mos zgjedhsha shtegun e mirë, drejtomë.

— Mirë, kalo! — pranoi Mirashi pas një çasti ngurrimi, i mundur me armët e veta.

Lulashi nxitoi disa hapa sa pér të krijuar largësinë e duhur ndërmjet tyre, pastaj vazhdoi me ecje të shtruar, ritmike, duke çarë me shkathtësi borën e duke lënë pas një shteg goxha të mirë pér tjetrin. Lëvizja plot forcë e shpatullave të tij të gjera trengonte se kjo nuk ishte punë e lehtë.

«Është i ri dhe i fortë!» — mendonte Mirashi, duke e vështruar me zili. — «Edhe unë kam qënë i tillë dikur, por iku vapa me gushtin! Shyqyr që nuk u turpërova sa priva. Tani qafa s'është larg, megjithëse rrugë ka ende mjaft. Dalça faqebardhë, makar në këtë punë... Sa bukur që e çan borën, sikur të ishte plug! Dhe është djale i pashëm... megjithëse burrit pak i hyn në punë kjo... Por, edhe mendjen e ka të hollë e gjuhën brisk. Me këto ia ka marrë mendtë Bardhës!... He, mos do ajo të ndërrojë burrë sa herë

njeh një tjetër që i duket më i mirë se i veti!... Po, po ajo e ka fajin më të madh. Femra duhet të dijë ta ruajë nderin e saj dhe të familjes. Ja rri urtë siç u ka hije bijave tonë, ja... më mirë vdekjen se turpin. Ka për të marrë se s'bën atë që i zgjidhi fati e baba. Madje, me fjalët që dolën, ishalla mylllet me kaq...»

Lulashi ktheu kokën mbrapa dhe vështroi tinë-zisht tjetrin.

«Të ishte diçka tjetër, do t'i lëshoja rrugë!» — mendoi. — «Por, s'është e drejtë që për hir të bindjes së tyre të gabuar, ne të shkelim ndjenjat tonë, të prishim jetën tonë. Po qe puna për të vuajtur për shkak të bindjeve të gabuara, më mirë le të vuajnë ata që i kanë, gjersa ta kuptojnë... Sidoqoftë diçka duhet bërë. Vetvetiu kjo nyje nuk zgjidhet. Por, si ta zgjidhim, kush ta zgjidhë? Fjala ime, ca më pak e Bardhës nuk shkon. Është si t'i futësh karthija zjarrit. Duhet të ndërhyjë dikush tjetër, që t'i peshojë fjala... Ndreca? Jo, do të tingëllonte si një ndërhyrje zyrtare. Më mirë një shok, për shembull, Vuka. Mirashi e çmon si vëlla e sipër vëllait. Ata kanë njëzet vjet që punojnë bashkë. Por, a thua është me ne Vuka? Ndoshta edhe ai si Mirashi... Jo, nuk e besoj, Vuka është ndryshe, e kam provuar në disa raste. Do t'i hapem. Sa të kalojnë këto telashet e borës, do të bisedoij shtruar me të...».

Tani qafa ishte fare afër. Silueta e pishës së vetmuar, që nxinte në sfondin bardhosh të qiellit, dukej edhe më madhështore. Veriu po e fshikullonte rreptë sipërfaqen e borës, duke formuar vraga të cekëta e duke rrëmbyer kokrrizat e imta, që të shponin fytyrën si gjilpëra të panumërtë. Megjithë erën e ftohtë që frynte, ndjeu se po djersinte. Diku iu

desh tē pushonte pak. Ktheu kokën pér tē parë apo mbahej tjetri mbas tij.

Mirashi kishte ndaluar pranë një ahu tē ri dhe po priste disa degë me sëpatën e vogël. Ja që i hyri në punë sëpata! Zgjodhi degët e përshtatshme, i qëroi nga degëzat, i ktheu në formë rrithi, u vendosi kryq nga dy palë shkopinj tē drejtë dhe i lidhi në këtë trajtë me një copë spango që e ruante në xhepin e pasmë tē pantallonave. Këta rrathë i lidhi nën çizme dhe nisi tē ngjitej, duke i hedhur këmbët në një mënyrë qesharake. Secila këmbë bënte një hark tē madh anash, pastaj shkelte përpara. Mirépo, kështu nuk fundosej në borë dhe ngjitej me lehtësi. Një buzëqeshje ngadhnjimtare i endej në fytyrë, tek shikonte se largësia ëndërmjet tij dhe tē parit po zvogëlohej vazhdimit. Edhe pak e do ta arrinte, madje do ta linte mbrapa. I rroftë rinia dhe forca atij!

Lulashi e dinte si bëheshin rrathët, por nuk kishte përvojë dhe do tē vonohej shumë pér t'i bërë, prandaj vazhdoi tē ecte ashtu siç kishte filluar. Aty ku mungonin shkurret, pothuaj zvarrisej. Tani ishte ai në siklet. Nuk mërzitej sa Mirashi në këtë lloj gare, por s'i pëlqente tē ngelej mbrapa. Më tepër i nxirrin punë çizmet. Kur fundosej në borë, këmba dilte pa çizme. U ul ndenjur, i hoqi dhë i rrasni në trastë. Vazhdoi në çorapë. As në ushtri s'kishte pruvuar vështirësi tē tillë. Sytë i digjin nga pluhuri i borës, pëllëmbët e duarve sado që tē regjura i qenë gërvishtur nga shkurret, këmbët i mërdhihnin, kishte etje.

Mirashi duke u ngjitur në një shteg zigzag, po i afrohej gjithnjë e më shumë. Por, kurrizi i malit po mbaronte, pjerrësia pakësohej, kurse bora ishte më e cekët. Ja, Lulashi arriti te pisha e vetmuar. Atje

fillonte qafa. Bora ishte nën gju. Për të mos humbur kohë, ai nuk i veshi çizmet. Largësia ndërmjet tij dhe Mirashit u rrit përsëri.

Mirashit iu shua buzëqeshja ngadhnjimtare. S'e kaloi dot! Qe vonuar më tepër se ç'duhej për të pre-gatitur rrathët, sepse duart i kishin mërdhishur. Tani; rrathët më shumë e pengonin. U përkul, i zgjidhi dhe i vari në brez. Mund t'i hynin përsëri në punë. Vazhdoi mbas gjurmëve të të parit. Ja, këtu ai i paska veshur çizmet, duket nga gjurmët! Të mos i kishte shkuar ndërmend që t'i zbatte... Mendjehollë, dreqi!

Lulashi e priste te fundi i qafës, ku fillonte shpati i përtejmë i malit.

Ai ishte mjaft i pjerrët, pothuaj i zhveshur, me ahe të rralla, të deformuara ose shkurre. Tek-tuk dukeshin dëllinja me ngjyrë të errët si në të zezë. Retë këtu ishin ulët, aq sa dukeshin sikur mbështeteshin mbi majat e drunjve të qafës. Veriu frynte gulshe-gulshe, gjithnjë e më i fortë.

Poshtë, shumë poshtë, në bardhësinë e lugines dallohej si një rrip i ndritshëm, pérroi i Skabinës. Përtej ngrihej një shpat tjetër, më pak i pjerrët dhe i pyllëzuar. Kurorat e pishave ngjanin si quka të panumërtë, të zeza, në faqen e bardhë të tij. Tërthorazi shpatit, si një brez, dallohej rruga nacionale që të conte në qytetëzën e Sharrës. Aty do të dilnin. Në vijë ajrore dukej afër, po për të arritur atje duhej të ecnin edhe disa orë.

— Nga do t'i biem? — pyeti Lulashi, sapo u afrua tjetri.

— Drejt e më të poshtë na bie më shkurt! — u përgjegj Mirashi.

— Unë mendoj të dalim tërthorazi mbi pjesën e

pylléuar të këtij shpati, pastaj të zgresim. Aty vendi
është më i mbrojtur. Veriu po vjen duke u shtuar
dhe bora ka filluar të ngrijë! — Lulashi goditi me
thembrën e çizmes dhe në buzët e gjurmës u dallua
një cipë, si xham i thyer. — Në këtë vënd të zhve-
shur e të ngrirë, do ta kemi të vështirë zbritjen e,
ndoshta, na del më gjatë.

— Mos u tremb, bre burrë, se borë është. Edhe
në u rrëzofshim, s'na gjen gjë. Unë jam më i vjetër
dhe...

— Si të duash, zgresim këtu! — e ndërpren
Lulashi dhe u nis.

— Tani më takon mua të prij! — tha Mirashi.

— Këtu s'ka nevojë për prijës, përroin e Skabi-
nës para syve e kemi! — vërejti tjetri. — Megjithatë,
kalo!

Veriu frynte gjithnjë e më fort, duke e grumbu-
lluar borën në trajtë koni, mbas çdo kaçubeje e
pengese. Të ftohit vinte duke u shtuar. Korja e
ngrirë po trashej dhe po forcohej. Vende-vende
thembrat e buta të çizmeve nuk arrinin ta çanin dhe
rrëshqisnin mbi të.

Diku Lulashi e pa veten të rrëzuar praptazi dhe
sakaq filloj të rrëshqiste. U mundua të ngulte gish-
térinjtë në borë, por nuk mundi. Shpejtësia e rrësh-
qitjes rritej vazhdimisht. Ai ia nguli sytë një dëllinje
dhe kur i kaloi pranë, u kap pas degëve të saj. Halat
i gjakosën pëllëmbët, por as që e ndjeu dhembjen.
U çua, u shkund nga bora dhe filloj të shkulte halat
që i kishin hyrë në lëkurë.

— Më fal, se kalova përpara! — i thirri Mirashit
me shaka.

Ai nuk iu përgjigj. Mezi po zbriste, duke rrahu-
fort këmbët, që të bënte shkallina në borë. Ishte

penduar që nuk e pranoi shtegun e propozuar prej të riut, por s'kishte ndërmend ta thoshte. Me gjithë kujdesin e madh, diku rrëshqiti dhe përfundoi te dëllinja.

— Këtu e poshtë kaçubat janë më të rralla, kurse pjerrësia më e madhe, kështu që mund të rrëshqasim më shpejt e më lirisht drejt Skabinës! — buzëgoshi Lulashi. — Veç, irrezik se mbërrijmë pa frysme atje!

— Edhe në ndodhtë kështu, s'bëhet dëm i madh!
— ia priti Mirashi zyntë duke menduar se tjetri potallej me shtegun që zgjodhi ai.

— Por shokët presin manikotat e traktorit! — tha Lulashi.

— Dhe traktoristin! — vazhdoi me shpoti, Mirashi. — Mos ki frikë, s'na gjen gjë, vdekja di kë merr!

I vjetri hoqi çizmet, i lidhi çift me spango, futi pantallonat në çorapet e leshta, i vari çizmet në qafë dhe vazhdoi zbritjen. I riu ndoqi shembullin e tij. Një copë herë zbritën pa rrëshqitur, por këmbët filluan t'iu mbërdhinin. U dukej sikur ua shponin gjilpëra të panumërtë. Megjithatë, asnjeri nuk u ankua.

Filloi të binte borë, në fillim me flokë të rrallë, të imët, pastaj pérherë e më dendur. Flokët e borës fluturonin me shpejtësinë e veriut, pothuaj paralelisht me faqen e shpatit dhe sikur u jepnin trajtë të dukshme rrymave të erës. Vende-vende ato formonin vorbij. Lugina dhe pérroi i Skabinës nuk daloreshin më. Shpati i ngjante një shkretëtire të bardhë pa anë e pa fund. Llastarët e zhveshur të kaçubave të rralla dridheshin, përpëliteshin, përkushteshin.

leshin, pérplaseshin me njeri-tjetrin dhe ulérinin, nën fshikullitjen e gulsheve të erës.

Të dy udhëtarët e kishin gjithnjë e më të vëشتirë. Bora u qe ngjitur si rrrodhe në jakat me gëzof, në kapuçat e leshtë, u qe grumbulluar në rrudhat e skutat e veshjes dhe u kishte ngrirë në vetulla. Sytë, sado që i mbanin të picërruar, pér t'i mbrojtur nga gjilpërat e borës, u dhembnin e u lotonin. Duhej të mbanin duart para hundës ose t'i kthenin shpinën erës, që të mund të ngopeshin me frymë. Këmbët tani nuk u mërdhihnin, por u digjin, sikur shkelnin në prush. Filluan të rrëshqisnin përsëri. Çorapet kishin zënë përfund një cipë akulli. Disa herë u munduan t'i qëronin, por duart që s'i mbanin dot në xhepa, se duhet të ruanin drejtpeshimin me to, u qenë ngathtësuar dhe punonin me vështirësi. Kurse cipa e akullit, sa e qëronin, formohej përsëri.

Diku, Mirashi i acaruar sa s'bëhej nga rrëshqitja dhe rrëzimet e shpeshta, u ul në borë, i hoqi fare çorapet dhe provoi të ekte zbathur. Ndoshta kështu rrëshqiste më pak! Po, më lehtë zbritej!

— Do të të ngrijnë këmbët! — i thirri Lulashi.

— Në dreq..., akoma s'kanë ngrirë! — shfryu ai.

Mbas pak Mirashi nuk i ndiente fare këmbët. I dukej sikur ekte mbi kërcinj.

«Me të vërtetë do të më ngrijnë!» — mendoi. —

«Më mirë pa jetë, se pa këmbë!»

U ul përsëri mbi borë dhe i preku me dorë. Tabani i qe bërë si shollë. Veshi me vështirësi çorapet, pastaj çizmet.

— Po qe puna pér të vdekur, më mirë mbathur, se zbathur! — tha.

Lulashi ngurroi një çast, pastaj veproi si tjetri. Me shumë vështirësi zbritën edhe pak. Ndaluani

rrëzë një kaçubeje prej llastarësh ahu, përtej së cilës pjerrësia e shpatit ishte akoma më e madhe, pothuaj humnerë. Vështruan një copë herë andej, pastaj i kthyen sytë nga njeri-tjetri në mënyrë pyetëse. Sëcili priste përgjigje nga shoku. Mirashi, të cilit i takonte të fliste, nuk foli.

— Mendoj të dalim tërthorazi shpatit, në drejtëm të asaj kaçubes, atje dhe të rrëshqasim drejt saj! — tha Lulashi. — Rrugë tjetër s'ka, mbrapsh nuk mund të kthehem. Do të lëshohemi me radhë. E provoj unë i pari.

Mirashi përsëri nuk foli. Tani ishte thellësisht i penduar që zgjodhi atë rrugë, por nuk sillte dobi edhe sikur ta pranonte. Uli kokën dhe ia bëri me dorë tjetrit të kalonte, duke lënë të kuptonte se po hiqte dorë vullnetarisht nga roli i udhërrëfyesit.

Ecën tërthor shpatit, pothuaj këmbadoras. Lulashi u ndalua ku e gjykoi se ishte vendi më i përshtatshëm. Kaçuba nxinte nga dyqind metra poshtë tyre. E vështroi disa çaste me ngulm, përmblodhi veten, sikur u tkurr, pastaj me një lëvizje të beftë, u lëshua poshtë. Një hop u mbajt më këmbë, pastaj u rrëzua dhe vazhdoi të rrëshqiste në mënyrë të çregullt. Mirashi vuri re se ai po shkonte me shpejtësi në të majtë të shenjës. I vetëtiu një dëshirë e ligë, por sakaq e largoi me neveri.

Lulashi e kuptoi rrrezikun. Bëri çmundi dhe u kthye me kokë nga kaçuba. Ajo po rritej me shpejtësi në sytë e tij. Ishte një dëllinjë. I përmblodhi të gjitha fuqitë, i shtrëngoi gjithë muskujt e trupit dhe, sapo iu afrua kërceu në rrëshqitje e sipër, me duar të shtrira drejt saj. Halat ia shpan rpellëmbët, degët ia rropën lëkurën e tyre, por ai i shtrëngoi fort. Ndjeu se përshkoi një hark dhe ndaloj në anën e

poshtme të dëllinjës. Pa i lëshuar degët u ngjit në anën e sipërme, siguroi mirë këmbët te rrënjet dhe u çua. Zemra po i rrihte fort, thua jse do të shpërthente kraharorin. Vështroi përpjetë dhe mezi e dalloj Mirashin mbas perdes së borës.

— Gatiii, kujdees! — bërtiti, me duart si hinkë rrreth gojës.

«A do të mund të zgres në shenjë?» — mendoi Mirashi. — Ai kërceu si rrëqebull dhe iu shmang rrezikut, po unë?... S'jam më i ri dhe i shkathët si dikur!»

Megjithatë u lëshua pa ngurruar. U rrëzua shpejt. U mundua të kthehej përmbyt dhe ta frenonte shpejtësinë, e rrëshqitjes, duke ngulur në borë thonjtë dhe bërrylat, por nuk ia arrit. Dëgjoi britmën e Lulashit «majtas!», u mundua të shkonte andej, por u rrrotulla disa herë dhe vazhdoi më të poshtë, pa e ditur se nga. Befas, dalloj fare afér dëllinjën dhe siluetën e Lulashit. Provoi të hidhej drejt tyre, por ra përsëri mbi borë, me duar të shtrënguara bosh. «Kaq e pata!» i vetëtiu në mend, por nuk ndjeu frikë. Ndërkaq diçka e mbërtheu për këmbe dhe ai u kthye rrëmbimthi kokëposhtë. Një çast nuk e kuptoi ç'ndodhi e në kishte ndaluar, apo jo. Po, kishte ndaluar, megjithëse flokët e borës fluturonin me shpejtësi mbi të. Ngriti pak kokën. Pa dëllinjën që nxinte sipër tij. Me kujdes që të mos shkëputet nga ajo pengesë e çuditshme mbështeti duart anash dhe u mundua të çohet. Dallci diçka të murme, të shtrirë që nga dëllinja e deri tek këmbët e tij. Qenkësh njeri, qenkësh Lulashi! Ai i kishte mbërthyer këmbët si kular në rrëzen e dëllinjës dhe me të dyja duart e kishte mbërthyer për këmbe atë. Fytyna mezi i dallohej, sepse e kishte pothuaj të zhytur në borë.

— Kujdes, ngadalë! — thirri ai, mbytyrazi. — Mundohu tē kapesh mbas rrrobeve tē mia dhe térhiqu lart.

Mirashi ia dëgjoi këshillën dhe, duke mos i kursyer bërrylat, thonjtë e madje mjekrën, arriti tē kapte një degë tē dëllinjës. E shtrëngoi, sikur tē qe e veshur me pambuk. Mbas pak ata rrinin tē heshtur në anën e sipërme tē dëllinjës. Veriu i ngarkuar me flokë bore, ulérinte mbi kokët e tyre. Lulashi futi dorën në trastë, nxori shishen e konjakut, ia hoqi tapën me dhëmbë dhe ia zgjati tjetrit. Mirashi ngurroi një çast, pastaj e mori dhe piu disa gllënkë. Piu edhe Lulashi.

— Qenka shumë e fortë! — tha i vjetri.

— Po. Me pakicë, në këto raste tē bën mirë! — tha i riu. — Në kufi, kur ishte borë e ngricë, na jepnin nga pak.

— Rrezikove shumë! — tha i vjetri duke vështruar gjetiu. — Sikur tē tē ishin shkëputur këmbët nga rrëza e dëllinjës, do tē kishim shkuar tē dy në humnerë.

— Kot nuk na nisën tē dyve bashkë! — ia priti i riu.

— Po tē mos kishim shpëtuar, ndoshta këtë vend do ta qulanin «Humnera e Sharrëxhinje»! — tha i vjetri.

— Vetëm ai pa mend i shkon vdekjes në gojë!

— tha i riu. — Por, kur s'i shmangesh dot, ku e ke tē vdesësh me nder!

— Ty tē lumtë goja! — miratoi i vjetri. — Tani bëjmë mirë tē çohemi. S'është vend për tē pushuar këtu. Vazhdojmë terti thor shpatit, gjersa tē gjejmë një vend më pak tē rrezikshëm për tē zbritur.

— Mirë! — tha i riu. — Kalo përpara, veç me kujdes!

— Vetëm ai pa mend i shkon vdekjes në gojë! — buzëqeshi i vjetri. Nxori sëpatën e vogël, që të bënte shkallina në vëndet e rrezikshme. Veriu u zbut. Flokët e borës po rralloheshin. Trajtat dhe kufijtë e shpatit shquanin gjithnjë e më mirë. Nga lart u rrökullis një ortek i vogël që u thërmua në trungun e një ahu të veçuar duke gjëmuar butë. Nga kurora e tij u shkund bora. Llastarët e ngelur lakuriq dri-dheshin sikur mërdhijnin.

Dalngadalë, ku duke rrëshiqtur e ku duke prerë shkallina, të dy udhëtarët arritën rrëzë shpatit. Aty era kishte grumbulluar shumë borë, por atyre u dukej sikur shkelnin në pambuk.

«Duhet t'i blej Bardhës një dhuratë për 8 Marsin!» — mendonte Lulashi. — «Mbasit të marrim manikotën, do të kaloj nga kinkaleri, se rast tjetër nuk kam. Do t'i blej dhe një tufë me lule. Asaj i pëlqejnë shumë trëndafilat...»

«Kreshnik djalë ky, Lulashi! — mendonte **Mirashi**. — S'ka si bëhet më i mirë. Ia kam borxh jetën...»

6.

Skoda që drejtonte Sula po i afrohej qytezë. Megjithëse të djeshmen mbrëma kishte ngarkuar vonë, udhëtimi i kishte shkuar mbarë dhe, pa ndaluar asgjekundi, mundi të arrinte në stacionin e trenit rrëth mesnatës. Fjeti në shtratin portativ të kabinës, shkarkoi i pari në mëngjes dhe iu vu rrugës së kthimit.

Sula pa orën, dhjetë e tridhjetë e pesë. Paska arritur shpejt, megjithëse rruga ishte me borë! Vettëm në gjurmët e rrotave kishte dalë deri diku asfalti, në trajtën e dy brezave të murmë, paralelë që zgjateshin pambarim. Pamja që shtrihet përtëj xhamave të makinës, i ngjante një kartoline të Vtit të Ri. Buzë çatisë së magazinës së rrëshirës vareshtin qirinj vezullues akulli. Reshtat e pishave të vokala të fidanishtes pyjore, ngjanin si qëndisma të gjelbërtë në një qilim të bardhë. Atje tutje dallohej oxhaku i lartë i fabrikës së tharjes së dërrasës. Ai sikur e ndante në dy pjesë shpatin e malit që zbardhët mbrapa tij.

Makina iu afroa urës së ngushtë e fundit para qytezës. Si nuk kujtohen t'ia bëjnë parmakët prej betoni kësaj ure! Sula manovroi me kujdes. Ja edhe agjencia e pasagjerëve, e strukturës së borë. Paska pak njerëz. Përveç ndonjë nevojtari dhe shoferave, kush udhëton në një ditë të tillë?

Qyteza e Sharrës dukej më e bukur se zakonisht. Bora, me bardhësinë e saj të butë kishte mbuluar dhe hijeshuar çdo gjë të vogël, të vjetër, të shëmtuar. Spikatnin më mirë godinat e reja shumëkatëshe që lartësoheshin mbi skarpatin e majtë të rrugës. Trotuarët dhe lulishtet, që në fakt nuk ekzistonin, dukeshin sikur dergjeshin nën borë dhe kështu në përshtypjen e kalimtarit qyteza i qe afroa së ardhmes së saj.

Sula nxori makinën përtëj zonës së ndalimqëndrimit, mbajti krahun, ndaloj dhe zbriti. Do të hante diçka, se vetëm një kafe kishte shtënë në gojë. Pastaj do të paraqitej për ngarkesë në zyrën e shpërndarjes së Sharrës. Por, duke shkuar në rostiçeri, ndërrroi mendje. Sikur të shkonte më parë në PTT dhe

të merrte në telefon Shkodrën direkt? Një fqinj i tij kishte telefon në familje dhe mund të pyeste Katinën si u bë djali.

Në sallën e PTT-së s'kishte njeri, por centralis-tja dukej shumë e zënë. Çfarë donte ai, Shkodrën direkt? Të priste, kishte shumë kërkesa nga zyrat! Vajza e re, me skufjet në vesh, thërriste parreshtur, duke futur e nxjerrë fishat: Alo, alo, foli... e zënë, prisni pak, alo, merre...»

Sula zuri vend në stolin e gjatë dhe ndezi një cigare. Vështroi muret e patinuar, të lyer freskët; lexoi parullën «Pa ndërlidhje s'ka komandim, pa komandim s'ka fitore» pastaj, nëpërmjet vitrinës së madhe, i hodhi sytë në rrugë. Vallë, ka rënë shumë borë në sektorët e pyllit?

Shkodrën ia dhanë më shpejt nga ç'e priste. Nxitoi në kabinën numër një dhe u gëzua kur dëgjoi zérin e Katinës.

«...Si është djali?... Vërtet është më mirë?... Ashtu? Gëzohem! Unë jam fare mirë, mos u bëni merak. Shiko djalin dhe veten... Kur kthehem? Nuk e di. Ne shoferët nuk caktojmë kurrë afat, rrugë i thonë!... Jo, jo, nuk ka shumë borë... Ta merr mendja që do të kem kujdes; se mos u ngjita sot në timon!... Nuk e harroj porosinë, jo... Mirë, atë-herë puthe djalin nga unë... Mirë u pafshim!»

Pagoi dëftesën, falënderoi centralisten dhe doli me nxitim, i lehtësuar. Tani sikur kishte më shumë oreks. O burra, në rostiçeri!

Ndryshe nga pamja e shkretë e rrugëve, rostiçeria ziente si një zgjua bletësh. Sulës iu duk në fillim errët, pastaj iu mësuani sytë. Tryezat ishin plot. Kamiererët vërtiteshin me nxitim ndërmjet tyre duke thirrur «Ruaju shok!». Klientët venin e vinin, duke

kërkuar vend dhe trazonin me këmbë tallashin e shtruar përtokë. Në një qoshe, një malësore e re pranë një burri me mustaqe, po mëkonte foshnjën me lloku. Banaku s'dukej fare, aq shumë njerëz ishin grumbulluar përballë tij. Banakieri s'u bënte dot ballë kërkese dhe po hutohej.

— Hajde, bre, se i numërova tri herë ato pare!

— thërriste një klient.

Sula u mundua të bënte rrugë. Ndoshta kishte byrekë. Një udhëtar i shqetësuar e pyeti në kalohej Qafa e Lisit. Disa ushtarë ankoheshin se s'po gjenin makinë dhe do t'u humbiste leja rrugëve. Tre shoferrë po gjerbnin kafe në një qoshe duke u munduar t'i mbushnin mendjen njëri-tjetrit se variantet e Sharrës janë të bllokuar dhe duhej t'i ngarkonin me dërrasë në stabilimentin e qytezës. Por, thua do t'i mbushej mendja shefit të shpërndarjes?

Sula ndërroi mendje. Nuk do të merrte byrekë edhe sikur të kishte. Më mirë të priste të hante diçka të nxehë, një gjellë të rëndë që ta mbante. Për shembull, tasqebap ose mish me makarona. I shëtitë edhe një herë sytë nëpër tryeza, se mos gjente ndonjë të njohur. Ja tek qenka Aliu! Me kë po bisedoka ashtu duke tundur duart?

Aliu s'ia ktheu përshëndetjen Sulës, vetëm i tregoi me dorë karrigen e lirë dhe vazhdoi debatin me shefin e shpërndarjes së Sharrës.

— ...Mos, bre burrë, ti i njeh më mirë se unë leqet e Majës së Keqe. A kalohen ato me gjithë këtë borë?

— Të thashë, pra, do t'ju prijë vinci! — ngulte këmbë shefi, një djalosh i gjatë e i thatë me sy të kaltër, energjikë. — Ai do ta çajë borën. Në ngectë, do të nisim një traktor me ruspë.

— Hapeni një herë rrugën, me vinç, me traktor, apo me ç'të doni, pastaj shkojmë ne! — tha Aliu.

— Mos e do edhe të shtruar me asfalt?

— S'do të ishte keq.

— Ama, ç'shofer i sakrificës! — tha shefi, me shpoti.

— Posi, more! E ke kollaj ti, se kërkon të mbarosh punën tënde, të na nisësh ne e pastaj të shkosh e të nxehesh pranë sobës. Por, në magazinën e parkut s'ka kokë shoferësh rezervë.

— Po të kishte, ti duhet ta ndërroje menjëherë! — qeshi shefi.

— Kur s'të pëlqeka koka ime, pse ngul këmbë që të nisem unë në krye të makinave?

— Sepse, edhe në ndodhtë rrezik, s'bëhet dëm i madh! — vazhdoi të bënte shaka shefi.

— Nuk shkoj! — ia preu Aliu me inat dhe për të dhënë të kuptohej se vendimi ishte i pandryshueshëm, filloi të hante makaronat që i vuri përrapa kamerieri.

— Ej, mos ik! — i thirri Sulë kamerierit. — Më sill edhe mua diçka. A ka tasqebab? Një dopio racion, të lutem!

— Ali, pse shtiresh sikur nuk merr vesh nga kjo punë? — e ktheu me të butë shefi i shpërndaresh. Ti e di se po nuk u shkel rruga mbasi të çelet, ngrin dhe bëhet më keq.

— Ashtu është! — ndërhyri në bisedë Sulë. — Dhe po ngriu, për të keqen tonë është. Duhet shkuar, pra. Sa për rrezik, kur i dolëm për zot timonit, e patëm parasysh. Pastaj, rreziku të gjen aty ku s'e pret. Po ece me kujdes...

— Mos hidh kripë në makaronat e mia, prit tas-

qebabin tënd! — e ndërpree Aliu, duke e vështruar shtrembër. — Në qofsh kaq i gatshëm, shko ti!

— Unë pér punë kam ardhur, po qe nevoja shkoj! — tha Sula qetë.

— Udhë e mbarë, pra!

— Jo, po shkojmë bashkë. Në daç, nisem unë i pari. Ne shoferët nuk ndahemi nga njëri-tjetri në vështirësi dhe besoj se ti nuk do të bësh përjashtim.

Aliu, i zënë ngushtë, diçka murmuriti, gjoja se e pengonin makaronat që po mbillaçiste.

— Prengë, sa të hamë bukë, po i sjellim makinat pér t'i ngarkuar me pluhur qomyri! — iu drejtua Sula shefit të shpérndarjes. — Hiç mos e vështro Aliun, ai do të vijë, nuk është as frikacak dhe as dembel.

— Po shkoj të lajmëroj punëtorët e investimeve, pra! — tha Prenga duke brofur më këmbë. — Me makinën e parë do të vij edhe unë.

«Ç'dreq të solli këtu, o Sulë!» — mendoi Aliu, pa i çuar sytë nga pjata.

— Urdhéroni tasqebapin dopio... edhe bukën... edhe veglat e punës! — tha kamerieri, duke i lëshuar të gjitha me ngut mbi tryezë.

— Prit, merr paratë, se s'kemi nge të presim edhe një herë kaq pér të paguar! — Sula e kapi pér bluze. — Sa bëjnë?

Ata hëngrën pa shkëmbyer asnjë fjalë me njëri-tjetrin. Aliu mbaroi i pari, ndezi një cigare dhe nisi të shfrynte tymin me duf. Sula përlau dy racione bukë me tasqebapin dopio, piu një gotë ujë — ah, q'do të shkonte një gotë verë! — dhe u çua.

— Mjaft është moti i vrenjtur, mos ji edhe ti!

— buzëqeshi, duke e kapur shokun përkrahu.

Afruan makinat te rezerva e pluhurit të qomyrit

pastaj Sula propozoi të pinin nga një kafe në bufenë karshi. Qëndruan më këmbë pranë banakut dhe nuk zunë hiç në gojë udhëtimin. Biseduan për gjëndjen e makinave, për defiqitit e transportit që kishin krijuar me Sharrën, pastaj për një ndeshje futbolli. Pranë tyre u afrua një malësor i moçëm, që kishte mbështjellë kokën me një shall të kuq, aq sa kësulës së bardhë i dukej veëtmajt. Ai po i vështronte me ngulm.

— Deshë gjë, e babë? — e pyeti Sula.

— Më erdhi zor t'ju bezdisja pa e mbaruar atë kafe! — tha malësori. — Dëgjova se do të shkoni nga Maja e Keqe.

— Do të nisemi, por, deri ku arrijmë?...

— Sado pak të më afroni, qar e kam. Po të isha më i ri, do t'u kisha hipur këmbëve, por tanis... aha, shkoi vapa me gushtin! A më merrni?

— Të marrim! — i tha Sula. — Shko e hip në atë makinën atje, që të mos mërdhi hësh jashtë.

— Faleminderit o bijtë e babës! — Plaku vuri dorën në zemër dhe doli.

Mbas pak, autokolona e vogël, e përbërë nga autovinci dhe tri skoda po dilte nga qyteti e shqëruar nga vështrimet kureshtare të kalimtarëve. Për ku nisen këta? Të gjithë thonë se qafat janë të zëna!

Në makinën e Sulës që printe mbas vinçit kishin zënë vend malësori plak, shefi i shpërndarjes dhe një xhenerik traktorësh, i cili po shkonte për t'i vendosur manikotën traktorit të Lulashit. Në dy makinat e tjera ishin edhe katër punëtorë investimesh, të zgjedhur ndër më të fortët, për të ndihmuar autokolonën në rast nevoje.

Vinçi ecte ngadalë, duke u përkundur në të

gjitha drejtimet, por çante pa shumë vështirësi. Lin-te pas dy vraka të thella në borë që sikur çmbështi-lleshin nga rrotat e tij të pasme. Skodat i zgjeronin këto vraka, i shkelnin dhe i bluanin me zinxhirët e gomave. Zhurma dhe lëvizja e autokolonës, si edhe një fjollë tymi që dilte nga oxhaku i një shtëpie, qenë të vetmet shenja të dukshme gjallërie në atë pamje të bardhë, të qetë e të ngurtë.

Kaloriferi i makinës së Sulës punonte mirë, duke u krijuar udhëtarëve përshtypjen e gabuar se edhe jashtë, duhej të kishte rënë të ftohit. Filluan të zgjeroeshin dhe të rrinin shpenguar në sedilje. Prenga shkopsiti peliqen, kurse plaku çmbështolli nga koka shallin e kuq. Pastaj nxori kutinë e duhanit, drodhi një cigare të trashë dhe ia zgjati shoferit.

— Urdhëro e digj një duhan burrash!

— Urdhëro e ndize ti prej tonave, se na ke ardhur mik në shtëpi! — ia priti Sula duke buzë-qeshur dhe i zgjati paqetën «Ardian».

— Dimri është gjithmonë i pabesë këtej nga ne, por në mars rrallëherë e ka mbushur kaq shumë! — tha plaku, duke nxjerrë nga xhepi një çakmak të vjetër artizanësh.

Një re tymi u përplas në xhamin e përparmë dhe u përhap nëpër kabinë. Sula çeli një gisht xhamin anësor. Një rrymë ajri hyri si shigjetë dhe u kujtoi udhëtarëve se jashtë bënte njësoj ftohtë.

— Po të ketë rënë kudo kaq e jo më shumë, besoj se do të çajmë! — tha Prenga.

— Shenjat tregojnë se do të bjerë përsëri! — vërejti plaku.

Xheneriku i traktoreve po dremiste. Kishin punuar gjithë natën pér një riparim të ngutshëm. Rru-ga kishte pjerrësi të njëjtë, ecej ngadalë dhe s'ishte

e nevojshme të ndërroje shpesh marshet. Sula e mbante gazin njëloj dhe manovronte lehtë mbi timon.

E kishte llogaritur që atë mbrëmje të flinte në shtëpi. Të çmallej me djalin e Katrinën dhe të lahej. Kishte ditë rrugëve dhe ndërresat sikur i ngjiteshin në trup. Me këtë shpresë s'qe rruar atë mëngjes dhe tanj po i kruhej mjekra. Por ja që llogaria i doli ndryshe. Se mos ndodhë për herë të parë kështu!

Autokolona e la rrugën kryesore, kaloi një urë dérrase dhe filloi të ngjitej në një shpat të thepisur. Kjo rrugë ishte më e ngushtë e vende-vende me pjerrësi të madhe. Nën të gjarpëronte përroi i Skabinës. Motorët filluan të zhurmonin më fort. Ecej me marshet më të ulëta.

Gomat e pasme të vinçit gjithmonë e më shpesh xhironin në vend. Shoferi mundohej ta nxirrte makinen, duke bërë mbrapa-para dhe duke e shkelur gazin deri në fund. Motori zhurmonte fort, skapamentoja cirrej e shfrynte, rrrotat mundoheshin të dilnin nga djepi prej akulli, spostoheshin majtas e djathtas, duke iu afruar herë-herë buzës së greminës, arrinin më në fund të dilnin, por disa metra më tej përsëritezë e njëjta gjë.

Skodat, për t'iu shhangur çdo të papriture, e rriten largësinë ndërmjet tyre. Edhe ato xhironin, rrëshqisnin dhe spostoheshin. Secili shikonte rrezikun e makinës që ekte përpara.

Sula me muskuj e nerva të tendosura ishte shkri-
rë e bërë një me makinen. I kishte harruar bashku-
dhëtarët, veten e gjithçka dhe me përvojën e tij
mundohej t'iu përgjigjej të papriturave. Gjymtyrët
e tij, sikur të ishin pjesë të gjalla të timonit e të
levave të ndryshme, lëviznin me shkathtësi.

Punëtorët e investimeve vërtiteshin pothuaj me vrap ndërmjet makinave dhe mundoheshin të ndihmonin përparimin e autokolonës, duke hedhur atykëtu pluhur qomyri nën goma. Megjithatë çdo metër fitohej me vështirësi dhe rrezik.

— Nuk e hedhin siç duhet! — vërejti Prenga.
— Do të dal të punoj me ta! — Kapi dorezën dhe u mat të çelte derën.

— Rri aty e mos luaj! — i thirri Sula rreptë. — Mund të të shkel, se këtu s'hyjnë në punë as frenat. Ata punojnë mrekulli, por kështu të duket kur i vështron nga kabina e makinës.

Atë çast vinçi u spostua aq shumë drejt gremi-nës, sa që njëra nga gomat e çiftit të djathët qëndroi një çast pezull. Prenga shtrëngoi duart në mbajtëse, aq sa i dhembën. Sula hoqi pa vetëdije këmbën nga gazi dhe mbajti fryshtë. Punëtorët e investimeve shtangën, si statuja. E gjithë kjo zgjati sa një vetëtimë. Rreziku kaloi.

— Më mirë që s'i shikojmë rreziqet që kalojmë ne, vetë! — tha Sula, duke trazuar me njérën dorë në paqetën e cigareve. — U trembëm më shumë se ai! — Tregoi me kokë nga vinçi, pastaj ndezi ciganen dhe e thithi me afsh.

Drurët dhe shkurret buzë rrugës sikur u shkundën nga plogështia që i kishte ngurrosur. Degët e tyre filluan të lëviznin, flakën nga shpinat e kërrusura ngarkesën e borës, u drejtuanc dhe ia nisën të dridheshin e të përpëliteshin si të gëzuara që u cilruan nga ajo peshë.

— Filloi veriu! — tha plaku.

Era fshikullonte gjithnjë e më fort faqen e shpatit, rrëmbente borën e imtë dhe e conte, si ndonjë re të bardhë, drejt honit të luginës. Në xhamat e ma-

kinës ngjiteshin parreshtur grimca të bardha që sakaj shndërroheshin në bulëza të imta uji, të cilat bashkoheshin me njëra-tjetrën në rrëke të vogla, gjarpëruese.

— Kujtova se filloj bora! — tha Prenga.

— Mos u përmallo pér të, shpejt fillon! — parashikoi plaku.

— E, ku e ditke kaq mirë, ti? — u vrenjt Prenga.

— Retë s'po lëvizin, pra veriu fryn ulët dhe ky, veç borë sjell! — sqaroi plaku me urtësi, pa u bërë merak pér zemërimin e tjetrit.

Tani autokolona përparonte ngadalë, por para rrezik e peripeci, në një pjesë të rrrafshët e të gjerë të rrugës. Xheneriku i mbështetur mbi motor dremitë përsëri. Plaku po tymoste «duhan burrash» që lëshonte një erë të rëndë. Prenga ndiqte me shqetësim trillet e erës, që diku po e fshinte e diku po e grumbullonte borën. Mos daltë parashikimi i plakut, se atëherë... Të treqind punëtorët e Stabilimentit presin trupa.

Shoferi i vinçit e shtoi shpejtësinë, duke u munduar të merrte me sulm një të përpjetë. Motori i gumezhit, diku rrrotat i xhiruan, por më në fund ia arriti të dilte në krye.

Sula, që e kishte hequr këmbën nga gazi gjersa vinçi të dilte sipër ia shkeli me marshin e tretë. Makina u vërsul përpjetë me uturimë. Fillimi shkoi mbarë, por pa arritur në qafë, shpejtësia ra dhe rrrotat filluan të xhironin. Sula i dha më shumë gaz. Makina jo vetëm që s'bëri përparë, por filloj të spos-tohej dhe të rrëshqiste më të poshtë. Motori gulçonte.

«Do të fiket!» — i vetëtiu në mend shoferit.

Shkeli freksionin, i futi me shpejtësi marshin

mbrapa, karikoi frenat e dorës dhe i dha gaz. Me sy të mbërthyer në pasqyrën anësore u mundua të dilte mbrapsht nga zona e rrëshqitjes.

— Ktheje nga shpati! — thirri Prenga.

— C'ndodhi? — pyeti xheneriku, duke brofur nga dremitja.

Plaku diçka mërmëriti, por mbeti fare i qetë. Sytë e tij të vegjël e pak të mjegulluar vështronin larg, duke i dhënë një shprehje indiferente fytyrës së tij.

Makina ndaloi, pothuaj e mbështetur në shpat. Sula mallëkoi rëndë dhe zbriti, për të parë gjenden. Në kabinë vërshoi një rrymë e ftohtë ajri, e ngarkuar me grimca të akullta. Zbriti edhe Prenga. Dy «Skodat» e tjera kishin mbajtur krahun, larg njëra-tjetrës.

Aliu po vinte drejt tyre i tronditur. Shoferi i vinçit kishte ndaluar në qafë dhe, gjysmë i dalë nga kabina, mundohej ta gjente se ç'kish ndodhur.

— Ju thashë, kjo që po bëjmë është marrëzi! — bërtiste Aliu. — Le veten tonë, por do të marrim në qafë edhe të tjerët.

— Hesht, mos mbill panik! — ia preu Sula, duke u munduar të dukej i qetë. I erdhi përqark makinës, kontrolli vendin dhe shtoi, duke iu drejtuar Prengës: — Veriu e paska ngrirë borën. Do ta kemi shumë të vështirë për të shkuar më tej. Është me rrezik të madh.

— Si t'uva marrë mendja! — tha Prenga me ngurrim.

— Të kthehem, s'kemi ç'bëjmë këtu! — propozoi Aliu.

— Jo, mbrapsht nuk do të kthehem! — ia priti Sula. — Përveç të tjerave, kjo do të ishte njëlloj e

trezikshme. Ti, shoku Prengë, sikur the se do të preqatitej një traktor me ruspë për të na ardhur në ndihmë?

— Po, besoj se do ta nisin.

— Sidoqoftë, le të presim pak. Tani na pengon pamjen edhe bora me tufan. Ndoshta moti do të zbutet disi.

Të tjerët heshtën, pa ditur q'të propozonin tjetër.

— Mirë, fikni motorët dhe ejani të grumbullohem i në kabinën time! — vendosi Sula. — Vetëm një motor po mbajmë ndezur, që të kursejmë naftën.

— Thua ka vend për të gjithë? — dyshoi Aliu.

— Bëhem i dhjetë vetë.

— Për njerëz të mirë gjendet gjithmonë vend!

— buzëqeshi Sula.

Në çdo sedilje u ulën nga dy vetë, kurse ata që tepruan zunë vend mbi motor. Jashtë moti u acarua sa s'bëhej. Era ulërinte. Nuk dallohej cila ishte borë e mbartur prej saj e cila binte rishtas. Shihej vetëm një kaos rrymash dhe vorbuish të bardhë, përtëj të cilëve hera-herë nuk dallohej asgjë. Megjithëse në kabinë bënte ngrohtë, xhamat po zinin një perde bardhoshe, të ndritshme.

— Kështu siç po rrimë, e ngrohim kaq shumë njéri-tjetrin, sa s'kemi nevojë për kaloriferin e makinës tënde, o Sulë! — tha Prenga, duke u munduar të gjente karar me ortakun e sediljes.

— Me një bidon vaj ulliri mund të bëhej një kuti e madhe sardelesh! — tha Aliu.

— Pra, e pranoke se je peshk! — qeshi Sula.

— Madje krap, se krapi rritet kaq i madh! — e plotësoi shoferi i makinës së tretë.

— Bashkë me ju! — u mundua të mbrohej Aliu.

— Nuk e bëmë ne krahasimin me kutinë e konservave! — tha Sula.

— Ju po bëni shaka, por ndérkohë bora po na mbulon! — ndérroi bisedë Aliu, duke treguar me gisht nga ajo pjesë e xhamit të përparmë që kishte mbetur e tejdukshme.

Atje tej, vinçi dukej si ndonjë dinosaur i lash-tësisë, që e kishte mbërthyer dhe po e përpinte shkretëtira e bardhë.

— Mos u tremb, bre, se jemi gjithë këta burra dhe sado thellë që të na mbulojë, dalim se dalim! — tha njëri nga punëtorët e investimeve.

— Të lumtë goja! — miratoi plaku.

— Unë po vonohem! — tha, i shqetësuar, xheriku. — Ata presin manikotën e hidraulikut, se pa traktor, me këtë borë... Duhet të nisem më këmbë!

— Ç'kujton, se mos ne presim ndihmën e Zottit? — iu kthye Sula. — Sa t'i dalë pak dufi motit dhe pastaj... s'do të rrimë duarkryq. Apo jo, more shokë?

— Ashtu, mirë e ke!

— Ta merr mendja!

— Fjalë me vend!

Me që përmendëm Zotin, na trego të drejtën, o babë, a e beson! — iu drejtua Sula malësorit plak.

— Pse po më pyet? — u vrenjt ai.

— Pa të keq. Sepse kur rrëshqiti makina, m'u duk sikur ia murmurite emrin!

Plaku futi gishtërinjtë nën kapuç dhe kroi kokën mendueshëm.

— Paske pasur veshë të hollë! — vërejti. — Po, është e vërtetë, ia përmenda emrin Zottit. Më ndodh nganjëherë kështu, sidomos në rreziqe. Boll është lodhur e po lodhet Partia të na i pastrojë trutë nga ndryshku, por, e vjetra krejt e re s'bëhet se

s'bëhet. Megjithatë, pak e besoj, për të mos thënë aspak. Madje, së pari ma ka nxjerrë nga zemra Zottin ish-priffti i fshatit, një farë Dom Shtjefni.

— Prifti?! — u çudit Aliu.

— Po, po, bash prifti.

— Si eshtë e mundur kjo?

Tani po ta tregoj unë si. Atëhere na e kishin mbushur mendjen se fara e pabekuar nuk jep prodhim të mbarë, prandaj para mbjelljeve, ditën e caktuar nga prifti, mblidheshim në oborrin e kishës gjithë kryefamiljarët, me nga një grusht prej çdo lloj fare lidhur në shami. Prifti nxirrte tek dera një tryezë, sħtronte mbi tē defteret dhe nuk na i bekonte farërat po tē mos e kishim shlyer hakun e kishës, një lloj takse nga tē shumtat që na merrnin. Lëshonte vetäm kur hynte ndonjë dorëzënës nga ata më në gjendje. Në vitin tridhjetë e tre, ndërmjet kryefamiljarëve qëlloi edhe një grua. Quhej Marë. Ia kishin vrarë tē shoqin për punë gjaku dhe ajo përpushej t'i rroste vocërrakët me krahët e vet. Nuk e kishte shlyer hakun e kishës, se s'i dilte misri as për bukën e kalamajve. Iu lut priftit t'ia bekonte farën, se do t'ia shlyente tē gjitha mbas korrjeve tē atij viti, por ai nuk pranoi pa dorëzënës. U kthyé nga kryefamiljarët dhe u lut që tē hynte dikush dorëzënës për tē, por ata tē kullave tē para s'deshën, kurse ne tē tjerët ishim në ujë për vete. Iu lut përséri priftit, i tha se Zoti duhej t'u jepte e jo t'u merrte vocërrakëve tē saj, por ai e kërcënoi me mallëkim për ato fjalë. Atëhere Mara u zemërua keq, ngriti kokën e me sytë prush i bubulliti priftit: «Kurrë mos i bekofsh! Hambarët e Ali Agës s'kanë mbetur asnjeherë bosh, me gjithëse nuk i bekon farërat. E'pra, në më punofshin krahët, vocërrakët e mi do tē kenë misër edhe prej

farërash të pabekuara!» Qysh atë ditë prifti dha Zoti i tij u thyen në zemrën time, si një pasqyrë e goditur me gur. Por copat ngelën. Këto na i hoqi dora e Partisë, megjithëse është e vështirë të pastrohen të gjithë skutat. Kështu bre burra!

— Ej, ç'kohë të mallëkuara keni jetuar! — tha shoferi i makinës së tretë, më i riu në kabinë. Nxori nga xhepi paqetën «Ardian» dhe ua zgjati shokëve.

— Në dashtë, vetëm baca le ta ndezë! — tha Sula, duke mos e pranuar cigaren. — Kabina, edhe pa tym duhani është e vogël për kaq frysme. Kush nuk duron dot le të shkojë e ta pijë në ndonjërën nga kabinet e tjera. Si thoni, burra?

Të gjithë e miratuan.

— As unë nuk e ndez! — tha malësori plak. — Burri s'ndahet nga shokët.

— Mos ma kthe, se më kthehet nusja! — nguli këmbë shoferi i ri duke buzëqeshur.

— Mirë, pra, po ta marr. T'u rittë nderi! — Plaku e vuri cigaretën në vesh.

— Si dëmshpërblim, do t'ju gostis me nga një thelë portokalli! — tha Sula.

— Portokall në këtë kohë? — u çudit Aliu.

— Ma dha një shofer që bëri një rrugë në Sarandë. E kam ruajtur sa për erë.

— Po në s'të dalçin thelat? — buzëqeshi Prenga.

— Do t'i ndajmë në dysh! — tha Sula, duke kërkuar me dorë në xhepin e kabinës. — Partizanët kanë ndarë një thelë bukë në dyzet racione e jo më ne s'po ndajmë një portokall në dhjetë.

Kundërmimi i portokallit i mundi erërat e këqija të kabinës. Të dhjetë banorët e saj, duke shijuar pjesën që u takoi, mendonin se kur do të zbutej sado

pak moti. Vërtet aty brenda ishte ngrohtë, por deri kur do të prisnin duarlidhur?

Mbas një copë here Sula doli, gjoja për të pastruar xhamet. Suferina vazhdonte, por më e zbutur. Nga ana e shpatit makina qe mbuluar me një shtresë të trashë bore, kurse nga ana e luginës dukej llamarina. Xhamat kishin zënë akull që mezi shkëputej, në trajtë pllakash. Rruga mezi dukej. Ishte bërë një me shpatin. Mbi pérroin e Skabinës dalloheshin dy njolla të zeza, të lëvizshme.

— Po vijnë drejt nesh dy njerëz! — tha Sula, duke hyrë në kabinë. Kish dalë pa shtuar gjë në veshje dhe të ftohit i hyri në palcë.

— Do të janë nga sektori, ndoshta për manikotën! — tha xheneriku i traktorëve. — Kurse unë po rri ngrohtë këtu në kabinë! Do të nisem.

— Vetëm s'ke ku shkon! — tha Prenga. — Në qofshin vërtet nga sektori, për pak arrijnë. Shko me ta.

Por, as atij nuk i durohej. Me justifikimin se ndodhej pranë derës, doli dy herë të shikonte. Herën e dytë u bind që ishin të sektorit, sepse njuhu peligjet e sharrëxhinjve. Vuri duart hinkë në gojë dhe thirri, por nuk mori përgjigje. Si duket therriste më fort era!

Mbas nja gjysmë ore, që sidomos xhenerikut dhe Prengës iu duk shumë e gjatë, ata të dy arritën te makina. Ishin Mirashi dhe Lulashi. U përqafuan sikur të kishin vite pa u parë.

— A mërdhihët, shokë, a u lodhët shumë?

— Diçka.

U grumbulluan kokë më kokë para makinës së Sulës. Erdhi edhe vingieri, së bashku me punëtorët që ishin me të. Qëndronin me këmbë të zhytura në

borë dhe bashkë me fjalët nxirrinin shtëllunga tymi duhani. Kishin kaq kohë pa pirë cigare! Njëri nga punëtorët e investimeve u kujtua të pastronte një copë vend. Kur kishin lopatat dhe krahët, pse të rrinin me këmbët të zhytura në borë?

— Lerini shokët të futen në kabinë, që të çlo-dhen e të ngrohen pak! — propozoi Sula.

Të tjerët miratuan njëzëri, por ata të dy nuk deshën. Sapo kishin kaluar Skabinën dhe para se të ngjiteshin, kishin ndezur një zjarr të madh dhe ishin ngrohur mirë. Se dalluan tymin? Si duket e kishte tretur era. Tani s'kishin ftohtë. Edhe moti po zbutej.

Xhenerikut dhe Lulashit s'u rrihej. Mbas pak ata kërkuan leje që të niseshin drejt sektorit.

— Edhe në s'ardhëtë traktori tjetër, deri në mbrëmje arrijmë këtu, me rrugën të celur! — u zotua Lulashi.

— Në mos filloftë përsëri! — tha xheneriku.

— Mos prij ters, bre burrë! — ia priti Mirashi.

— Edhe traktori tjetër duhet të vijë! — tha Prenga.

Mirashin mezi e bindën që të mos kthehej meta. U desh këmbëngulja e Prengës. Si mendon Mirashi, lihen miqtë vetëm në shpat të malit? Jo, jo, s'është Prenga, po ai zot shtëpie aty. Ai i njeh edhe shtigjet në rast nevoje.

— Shokë, të çbllokojmë makinat! — tha Sula. — Propozoj të punojmë me ndërresa, se s'ka vegla përtë gjithë. Kush të ketë radhën të mos kursehet, t'i futë të pestin! Unë kam lopatë do të punoj në ndërrresën e parë. Shoku Mirash, të lutem bëjini pak shogëri bacës, futuni në kabinë... Çfarë, doni të punoni? Posi, ndërrresën tjetër!

Mbas pak njerëzit punonin me vrull rrëth ma-

kinave dhe ato po zhvisheshin shpejt nga shtresa e borës. Ngjyrat e kabinave dukeshin të pastra e të bukura në sfondin e bardhë. Veriu përsëri provonte të egërsohej, por s'kishte fuqi. Bora filloi të rrëzohej vetiu nga degët e drunjve. Retë po vozitnin drejt jugut.

— Tani do të çelë koha! — tha malësori plak, duke vështruar nga qelli.

— Forca, Sulë, se ta kalova! — thërriti Prenga.

Lulashi dhe xheneriku dallosheshin tashmë si dy njolla të lëvizshme në shpatin përtëj Skabinës.

7.

Staka i ngjitej së përpjetës ngadalë. Mundohej të shkelte sa më mirë shtegun dhe kthente shpesh kokën mbrapa. Operatori i vinte pas, duke u munduar të ecte në gjurmët e tij, por e humbiste shpesh drejtpeshimin dhe hapte e tundte krahët, si ndonjë shpend i madh, i plagosur, që s'ngrihet dot në fluturim. Aparati i varur në qafë, i tundej si ndonjë kumborë e madhe dhe ai nuk dinte ç'të ruante më parë, veten apo atë. Këmbët kishin filluar t'i mërdhijnin, kurse në trup e në fytyrë sa s'po i binin djersët.

«C'm'u desh mua kio aventurë!» — mendonte.

— «Filmin e pata përfunduar, në mensë ishte më mirë dhe ngrohtë, ç'nevojë pata?... Por, tani s'kthehem dot. Ec, pra, o Fredi, kush s'ka kokë ka këmbë!...»

— Ma jep ta mbaj unë atë aparat, se po të pëngon mjaft! — i tha Staka, që po e priste disa metra më lart.

— Boll, ke çantën dhe kasetën e filmave! —
ngurroi Fredi.

— Ma jep, mos ki merak, e ruaj më mirë se tif
— nguli këmbë Staka, duke zgjatur dorën.

Ndërsa po hqite aparatin nga qafa, Fredi vësh-troi mbrapa dhe pa të njëjtën panoramë që kishte-soditur të djeshmen mbrëma, ndërsa po kthehej me Ndrecën në sektor. Barakat dukeshin përsëri si në-maket, por më të bukura. Çatitë e pjerrëta, të tra-shura e të rënduara nga shtresa e borës, dukeshin sikur ndrydhnin nën vete ndërtesat e brishta, me-angjyra të ndezura, të rreshtuara në një piedestal të-bardhë. Qirinjtë e akullit buzë strehëve, vezullonin si kurora margaritarësh. Në shpatin përtej pishat dukeshin si krahë të panumërt të malit, që me ku-rorat si pëllëmbë qenë munduar të prisnin borën.

— Një minutë, do të filmoj! — tha Fredi, duke-zbërthyer këllëfin e matësit të dritës.

U dëgjua cërcëritja e mekanizmit të aparatit. Operatori që e harroi sakaq pendesën dhe të mërdhi-hurën e këmbëve, shëtiti kuadrin nga e majta në të-djathë, pastaj u përqëndrua te sektori, duke iu-afruar me objektivin.

— Kuadër i mrekullueshëm! — tha, duke i kthy-er aparatin Stakës.

— Merre ngadalë, se s'na ngut njeri! — e kë-shilloi Staka, dukë rifilluar ngjitjen.

«S'e pengoka fare këmba e çalë!» — mendoi Fredi, duke vënë re sa lehtë ngjitej tjetri. — «Mirë-thotë Ndreca, këta janë mësuar që në fëmijëri me-malin dhe borën».

Tani, edhe ai vetë sikur ngjitej më kollaj. Vërtet fillimi qënka i vështirë, pastaj... Megjithatë-herë-herë ndalej dhe pushonte, gjoja për të soditur

panoramën ose për të bërë ndonjë pyetje. Si quhej ai mali, atje përtet? Po ato kulla, të cilit fshat janë? Gjer te shtëpia e Stakës, sa orë mban? Sa, katër orë në kohë të mirë! Sa shumë!

— Të parët tanë kanë shkuar deri në Shkodër në këmbë për një grusht kripë a për një qase misër dhe shpesh janë kthyer pa të, madje s'janë kthyer fare, se kanë rënë në ndonjë pritë! — tha Staka. — Është turp të anko hemi sot, siç bën ndonjëri, se e hemi punën disa orë larg. E, aq më tepër kur i hemi kushtet e jetesës në sektor, siç i pe vetë!

— Po në familje, si i kini? — pyeti Fredi.

— Disi. Jo se s'kemi të ardhura të mjaftueshme, sharrëxhijtë marrin mirë, por sepse nuk dimë. Ja, traktoristi Lulash sa s'u prish me të atin se bleu tryezë e karrige në vend të sofrës.

— Dhe si përfundoi, pastaj?

— Lulashi nuk tërhiqet kollaj. Ia mbushi mendjen plakut dhe i futi në shtëpi, megjithëse ai vazhdon të hajë në sofër. Por, ndodh që i bëjnë shoqëri njëri-tjetrit, herë në sofër e herë në tryezë! — buzëqeshi Staka.

— Është një luftë e gjatë kjo! — tha Fredi. — Tani ec se u vonuam.

Kur erdhi koha për të pushuar përsëri, kishin dalë te rruga kryesore. Një pjesë e saj ishte pastruar nga bora dhe dukej si ndonjë govatë e bardhë, e stërgjatë. Në njërin ballë punonin gjashtë burra, ndërmjet tyre dhe Ndreca. Tehet e loptave i ngulnin thellë nën borë, pastaj i ngrinin përpjetë dhe hidhnin anash llokma të mëdha prej saj. Megjithëse ishin bërryl më bërryl, punëtorët jo vetëm që nuk e pengonin njëri-tjetrin, por punonin shpejt, ritmikisht, në heshtje, sikur përbënин një mekanizëm të vetëm,

— të gjallë. Bora psherëtinte kur e therrnin tehet e lopatave dhe rënkonte butë, kur e ngjeshnin anash.

Punëtorët ua kthyen përshëndetjen pothuaj me një gojë, pa e ndërprerë punën.

— Ju lutem, mos vështroni këtej dhe punoni si zakonisht! — i porositi Fredi, duke pregetitur aparatit.

— Borë po pastrojmë, s'po bëjmë ndonjë mrekulli, bre burrë! — vërejti një sharrëxhi kuqalosh.

— Rrokullisja e trupave kërkon forcë e zanat. Ata të Vukës po merren me këtë punë. Janë burra të shkathët dhe kini ç'të shihni e të merrni në film te ta.

— Edhe tek ata do të shkojmë! — tha Fredi, duke kërkuar vëndin më të përshtatshëm për filmin.

— «Interesant, zakonisht njerëzit duan të dalin për vete në film, kurse këta po më drejtojnë te shokët!»

— mendoi.

E kaloi kuadrin nga pamja e përgjithshme e pyllit, të rënduar me borë në pamjen gjatësore të rrugës së pastruar, pastaj iu afrua ballit ku punohej. Sapo dëgjuan cërcëritjen e aparatit, punëtorët morën një pamje të tendosur dhe shpejtuan ritmin e punës.

— E paevitueshme! — murmuriti Fredi.

— Çfarë, nuk doli mirë? — pyeti Ndreca.

— Mirë, mirë doli! — buzëqeshi operatori. —

Në ç'drejtim ndodhet brigada e Vukës?

— Do të shkojmë bashkë! — tha Staka.

Atë çast u shfaq buzë rrugës së pastruar Mrika me të birin. Ngulën lopatat në borë dhe priten.

— Po ju? — pyeti Ndreca, megjithëse e kuptoi pse kishin ardhur.

- Erdhäm tē ndihmojmë! — u përgjigj Mrika.
 — Besoj se unë e Bardhoku bëjmë sa një prej jush.
 — Mirë! — buzëqeshi Ndreca. — Rregulloni skarpatin, që tē mos shembet bora në rrugë. Ja, kështu... — Ai bëri një copë mostër dhe u kthye në punën e tij.

Nënë e bir filluan tē punonin krah për krah njeri-tjetrit. Bardhoku priste borën nga sipër me lëvizje tē gjalla e duke ofsharë, sikur priste dru. Faqet i skuqnin dhe sytë i shkëlqenin si prush. Mrika e vështronte vjedhurazi dhe buzëqeshte me dhembshuri e krenari. Ajo punonte shtruar, por, në saje tē përvojës, me shumë rendiment.

Fredi Mushqeta u mallëngjye nga ajo skenë. Filmoi me objektiv tē fshehur, pastaj kapérceu stomin e borës dhe u nis mbas Stakës. Shtegu ishte i parrahuar dhe i fundoseshin këmbët në borë, sado që mundohej tē ecte në gjurmët e tjetrit. Deri te buza e pyllit shtrihej një lirishtë jo shumë e pjerrët, me valëzime tē buta dëbore që zbardhonin sa tē vrisnin sytë. Nga pylli vinin herë-herë jehona tē qarta kris-mash e thirrjesh. Mbas pak, që andej dolën dy njerëz tē cilët, diçka po zvarrisnin. Fredi picërrroi sytë dhe i vështroi me vëmendje. Njohu Vukën dhe Lleshin.

«S'paska ikur!» — tha me vete për Lleshin.

Kur tē dy sharrëxhinxjtë arritën kundruall tyre dhe i përshëndetën Fredi duke treguar me dorë trupin që e kishin zvarrisur për së gjati, pyeti:

— Pse nuk e rrokullisni?

— Duam tē bëjmë një lug bore! — sqaroi Vuka.

— Ky dhe disa tē tjerë do tē na mundojnë pak, por tē tjerët do tē rrëshqasin vetë nëpër këtë! — Ai tregoi me dorë vrragën që zgjatej mbas trupit.

— Punë me mend! — Kurse vërejtja imë paska

qenë pa vend! — buzëqeshi Fredi. — Shokët e tjerë ku i kini?

— Ecni gjatë lugut, tek ata ju çon! — tha Vuka, duke ia ngulur capinën kreut të trupit. — Jepi, Llesh!

Lleshi, që kishte qëndruar gjithë kohën kokulur, i heshtur dhe i zymtë, brofi si nga gjumi dhe nguli capinën e vet. Të dy palët vazhduan rrugën.

— Më mirë shkel në gjurmën e lugut, se atje bora është më e ngjeshur! — tha Staka.

«E paska mendjen më femër se timen!» — tha me vete Fredi, duke ia ndjekur këshillën.

Sapo hynë në pyll, buçiti zhurma e një motosharrë. Ishte diku afër dhe Fredi rrotulloi vështrimin, por nuk e gjeti.

— He-heej! — thirri Staka.

Motosharra pushoi.

— Mirë se vini, shokë! — i përshëndeti dikush.

Fredi ktheu kokën dhe, jo larg tyre, njoju Frrokun. Po ky nga mbiu? U afrua me kureshtje. Rreth e qark drurit bora ishte gërmuar. Trungu ishte i kllaposur në rrëzë dhe i sapovizuar nga zinxhiri i motosharës. Mbi borë zverdhnin si qelibar ashklat dhe tallashi. Binte erë rrëshirë.

— A u lodhe, shoku Fredi? Po ti, Stakë? — Frroku kaloi motosharrën me dorën e majtë dhe u zgjati të djathtën. — Druri duhet prerë rrafsh me tokën e jo me borën! — tha, duke vënë re vështrimin kureshtar të operatorit. Edhe në mos pastë ndërgjegje ndonjeri prej nesh, ia rregullon Paloka. Sa të shkrijë bora, na detyron t'i ripresim cungjet e lëna larg, përveç çdëmtimit në bordero!

— Nuk bën asnjëherë lëshim, as në raste vësh-tirësish? — buzëqeshi Fredi.

— S'e ka për zanat. Dhe, mirë bën. Këtu te ne vështirësitë janë varg dhe atëhere pylli do ta pësonte keq.

— Vetëm po e pret? — pyeti Fredi.

— Vetëm. Për sa punë kemi sot, jemi pak njerëz. Tani, ju lutem të ruheni, se duhet të vazhdoj.

Frroku ndezi motosharrën, kërceu në gropë, u struk në pozicion të volitshëm, pothuaj i shtrirë në fundin e saj dhe vazhdoi prerjen.

Fredi iu afrua me kujdes që të mos e hetonte dhe nisi të filmonte. Për fat të mirë zhurma e motosharrës e mbyste cërcëritjen e aparatit dhe Frroku s'kuptoi gjë. Vetëm kur operatori iu afrua për të marrë një detal, ai ktheu kokën, i habitur. Por, atëherë gjithçka kishte përfunduar dhe Fredi, duke buzëqeshur, hoqi gishtin nga shkrehësi.

— Kujdes, mbas pak do të rrëzohet! — tha Frroku. — Bën mirë të largohesh.

Fredi iu bind. Zuri një vend të sigurtë dhe priti me aparatin në sy. Tani, Frroku përsëri nuk dukej. Mbas pak ai kërceu nga gropë dhe vrapi, si dhelpra që del nga strofka e tymosur duke thirrur «ruajunii!»

Pisha krisi, u hepua dhe mori tatëpjetën, duke kërcellitur e duke shkundur borën nga kurorat e drurëve që prekte. Fredi e ndoqi me objektiv, gjersa u përplas mbi borë me një gjëmim të mbytur. Degët e saj vazhduan të luhateshin një copë herë.

Staka vështronte me ca sy të trishtuar është përmalluar.

— Frrrok, a ke ndonjë sëpatë tjetër? — e pyeti, ndërsa ai kishte kërcyer mbi trung, që të priste degët.

— Janë sëpatat e Vukës dhe të Lleshit, rrëzë asaj

pishës, atje! — tregoi Frroku me dorë. — Zgjidh njërën prej tyre.

Staka mbërtheu bishtin e sëpatës si i urituri copën e bukës dhe me disa kërcime tepër të shkathëta pér sakatllëkun e tij, u gjend mbi trung. Nëpër pyll nisën të ushtonin sakaq goditjet e dy sëpatave që ndiqnin njëra tjetrën në mënyrë ritmike, tak-tuk, tuk-tuk, tuk-tak...

Staka e kishte zhveshur peliqen dhe muskujt i kërcenin nën fanellë me ritmin e goditjeve. Këmbët i kishte mbështetur kaq fort mbi trung, sa dukej si ndonjë degë e gjallë e tij. Gjoksi i zgjerohej kur ngrinte sëpatën lart, i tkurrej dhe i nxirrte një ofshamje fishkëlluese, kur tehu vërsulej më të poshtë. Dukej sikur fishkëllente ajri nga shpejtësia e goditjes. Gjatë ofshamjes i zbardhnin këmbët kërcënueshëm, duke kafshuar buzën e poshitme. Flokët i hovnin mbi ballin e djersitur. Sytë i shkëlqenin, si të ndezur nga një flakë e brendshme. Dukej më i ri dhe më i pashëm se zakonisht.

«C'mall e ç'dashuri pér punën!» — mendoi Fredi dhe rrëmbeu aparatin, i frysmezuar. Kërkoi këndin më të përshtatshëm pér filmim dhe u tha:

— Djema, ju lutem vazhdoni punën, sikur unë të mos isha fare këtu! Ajo që pa nëpërmjet objektivit iu duk e madhërishme.

Frroku i kishte shtrënguar shputat e këmbëve mbi trung si kthethra. Pantallonat prej shajaku dukeshin të ngushta pér pulpat e tij që tkurrereshin dhe bymeheshin në qdo goditje të sëpatës. Gishtërinjtë e tij të gjatë e me nyje të mëdha shtrëngonin fort bishtin e saj, ndërsa llërët e fuqishme dukeeshin si një vazhdim i gjallë i veglës. Lëvizjet e djaloshit ishin të kursyera, të lehta, të sakta dhe ritmike, por

njëkohësisht të fuqishme e gati të egra. Bashkë me sëpatën lëvizte çdo pejzë e muskujve të tij. Edhe sytë rinoë të kaltër e të ndritshëm merrnin pjesë duke shoqëruar tehun e çeliktë gjatë lëvizjes. Nga trungu rrëzoheshin radhazi degët me hala të gjelbra. Ato binin mbi borë si gjymtyrë të vdekura, të shoqëruara me ashkla verdhoshe.

«Vallë, kjo puna e sharrëxhinje ka bukuri të veçantë, apo unë s'e kam kuptuar deri më sot bukurinë e punës?» — mendoi Fredi, duke filmuar me frymëzim.

— Boll, se po ua rrit mendjen çunave dhe po na prishen mandej! — tha buzagaz Vuëka që sapo u kthyte nga zvarrisja e trupit të dytë.

Frroku preu degën e fundit, zbriti me një kërcim të lehtë nga pisha dhe mbështeti sëpatën në të. Vegla dukej tanë e vogël dhe e pafuqishme kundrejt trungut të kuqërrëmtë, që shtrihej gjatë-gjatë mes borës dhe degëve të prera.

— E pse do të na rritet mendja, të tillë punë kanë bërë edhe gjysh-stërgjyshërit tanë! — tha djaloshi, duke kaluar kurrizin e dorës mbi ballë.

— Mos doni t'ua kaloni? — pyeti me qesëndi Lleshi, ndërsa po mbushte llullën.

— Si jo? Po s'ua kaluam, kot i rëndojmë dheut! — ia priti Frroku.

— Gjithmonë bijtë janë munduar t'ua kalojnë etërve! — vërejti Vuëka. — Edhe në s'kanë mundur, s'ka qenë faj i tyre. Kurse sot, kush nuk lodhet përkëtë, vërtet që i rëndon kot bjeshkës.

— Ja, e shikoni, filloi bora! — tha Lleshi me gishtin përpjetë, disi krenar që doli parashikimi i tij.

Të gjithë ngritën sytë. Vërtet, ndërmjet kurorave

të drunjve dhe sidomos në boshllëkun e lënë nga pisha e rrëzuar, depërtonin flokë të rrallë bore që zbrisnin poshtë duke u përdredhur. Njeri prej tyre ia shoi llullën Lleshit.

— Çohuni, burra, të lëshojmë nëpër lug trupat e prodhuar, përndryshe ka rrezik të na i mbulojë!

— tha Vuka, duke rrëmbyer capinën.

— Po këtë? — pyeti Frroku, duke treguar me keqardhje pishën e sapoqëruar nga degët.

— Në na lëntë, i kthehemë së fundi asaj. Të gatshmet njëherë! — tha Vuka.

— Po merrem unë me të! — u zotua Staka duke brofur më këmbë.

— Të paska marrë malli për zanatin e vjetër! — vërejti Lleshi, ndërsa po çohej ngadalë, me duart në mes. — Hiç mos u përmallo për të, e ke më të mirë sot!

— Ç'të bëj që s'më lënë, se qysh tani shkëmbe-hesha me ty! — tha Staka dhe kapi sëpatën. — Shoku Fredi, mos u mërzit! — iu kthyte operatorit.

— Në u keqësoftë koha, s'ke ku gjen vend më të mbrojtur se këtu, në pyll. Kur të duash të kthehesh në sektor, më trego.

— Jo, do të qëndroj! — tha operatori. — Ti shiko punën.

— Burra, të afrojmë njëherë trupat te gryka e lugut! — thirri Vuka, duke ia ngulur capinën të parit, së bashku me Frrokun. — Hoo-hop!

Trupi i zhytur në borë pengohej në cungje, në rrënëjëza e gurë dhe mezi lëvizte gjersa doli përbë borë, pastaj nisi të rrëshqiste më lehtë. Në vendin e tij mbeti një gropë e gjatë si plagë, në fundin e së cilës dukej legusha ngjyrë ndryshku.

Pylli që gjer atëherë sikur dremiste nën gunën

e bardhë, nisi të gjallërohej. Degët e drunjve u drodhën, lëvizën, filluan të luhateshin dhe të shkundeshin nga bora. Ajo shkëputej prej tyre llokma-llokma, thërmohet nëpër degët e mëposhtme dhe binte në truallin e pyllit në trajtë copëzash e pluhuri të bardhë, duke bërë «puf, prrrsh. . .»

— Filloi veriu, ka për të shtruar mirë! — tha Lleshi, kësaj radhe me keqardhje e i pezmatuar.

— Hajde, jepi capinës dhe mos u trishto! — e nxiti Frroku. — Në qofsh vërtet në vështirësi, do të të vimë të gjithë në ndihmë ditën e diel. Gjer atëherë do të bëjnë si do të bëjnë edhe pa ty andej nga kulla.

— Të nxjerrim sektorin nga vështirësia, pa s'të lëmë në baltë! — shtoi Vuka, ndërsa zvarriste një trup. — Hoo-hop, jepi Frrok, hoo-hop!

— I zoti e nxjerr gomarin nga balta! — tha Lleshi, duke ngulur capinën.

— Jo gjithmonë vetëm! — ia priti Vuka. — Ata që s'na e donin të mirën, na nxitnin dikur të urreheshim e të vriteshim me njëri-tjetrin, por të parët që na e deshën të mirën, na kanë mësuar të mbështetemi te njëri-tjetri. S'i kemi harruar e s'do t'i harrojmë zakonet e mira, apo jo, Llesh?

— Drejt fole! — tha Fredi, të cilit i kishte bërë përshtypje urtësia e Vukës. — «Qenkan njerëz me zemër të madhe!» — mendoi.

— Hoo-hop, Mark, hoo-hop!

— Hoo-hop, Frrok, hoo-hop!

Era u shtua. Pylli uturinte. Shkundeshin copa të mëdha bore, rrëzoheshin degë të thata e boqe të vjetra, kurse flokët e borës bënин rrötullime e spirale nga më të ndryshmet dhe mezi binin përdhë. Plagët që lanë trupat u mbyllën sakaq dhe legusha

ngjyrë ndryshku nuk dukej më gjëkundi. Në lirishtë era sillte dhe ngrinte re të bardha dëbore, duke ulëritur me zemërim.

Trupat i grumbulluan kokë më kokë te gryka e lugut dhe vendosën t'i lëshonin më të poshtë. Të parin do ta përcillte Vuka me capinë, që ta frenonte dhe të lajmëronte shokët poshtë.

— Puna jonë është sa e vështirë, aq edhe e rrezikshme! — iu drejtua ai operatorit duke kopsitur peliqen. — Po nuk u tregove i kujdeshëm, e pëson vetë ose rrezikon shokët. S'bëhet shaka me trupat. Ja, dhjetë vjet si sot na u vra një shok. Gjithë ditën e kam pasur ndërmend. C'djalë që ishte!

— E di! — tha Fredi. — I ati i Bardhokut.

— Po, ai. Trego pér këtë në film. Njerëzit duhet ta dinë se druri prodhohet jo vetëm me djersë, por edhe me gjak... Do t'jua bëj me shenjë, duke tundur shaminë e kuqe, se britma nuk dëgjohet. Atëhere lëshoni trupat! — iu drejtua Vuka shokëve.

Ia nguli capinën fundit të trupit dhe shkoi mbastij, duke e frenuar.

Fredit iu shkre të shikonte nga lart pamjen e pyllit në furtunë. Ia vuri syrin një shkëmbi të hirtë, jo larg që aty. Pa i treguar Stakës, që të mos e shkëpuste nga puna, shkoi ngadalë në atë drejtim. Nuk e pati të lehtë, se rrëshqiste. Ngjitej duke u mbajtur prej degësh e duke ecur vende-vende këmbadoras.

Pamja që pa nga maja e shkëmbit e viente mun-

Degët e pishave, të kapërthyera me njëratjetrën, lëkundeshin furishëm, duke formuar tallaze. Kishte një ngjashmëri të madhe me detin në furtunë. Tallazet e gjelbra dukeshin të egra, kërcënuese, gati të frikshme. Era rrëmbeu stërkalat e ngrira të tyre dhe i çonte diku larg.

Fredi u mbështet mirë te shkëmbi, që t'i ruhej furisë së erës, nxori aparatin, montoi mbrojtësen e objektivit dhe filmoi, gjersa një flok bore erdhi e iu ngjit mu në objektiv.

«Nuk do ta pres këtë pjesë!» — mendoi. — «Kjo do t'ia shtojë bukurinë dhe origjinalitetin.»

Zbriti ngadalë, Qenkësh më vështirë për të zbriztur! Mezi mbahej më këmbë. Mbështetej ose kapej, herë me njëren dorë, herë me të dyja.

«Tre ose katër pika mbështetjeje, janë më të sigurta se dy!» — bënte shaka me vete.

— Ma jep dorën! — i thirri dikush.

Ktheu kokën dhe pa me habi Stakën, që kishte një pamje të shqetësuar.

— Pse s'më tregove, të vinim bashkë! — e qortoi ai miqësish. — S'bëhet shaka me këtë kohë. Mund të rrëzohet ndonjë pishë dhe një i pamësuar me pyllin s'di t'i ruhet rrezikut.

Kur arritën te vendi fillestar, në grykën e lugut kishin mbetur vetëm dy trupa nga pisha e rrëzuar së fundi. Frroku dhe Lleshi u nisën njëri pas tjeterit. Në fillim ata rrëshqitën ngadalë, pastaj shkuan duke e shtuar shpejtësinë. Shpinat e tyre të kuqërrrema herë dukeshin e herë zhdukeshin nëpër lug.

«Ngjan sikur qeni po ndjek dhelprën nëpër borë!» — mendoi Fredi dhe buzëqeshi me vete për këtë krahasim.

— Tani të presim sa të zbutet pak, se nuk ecet nëpër lirishtë me këtë murlan! — tha Staka.

Së bashku me Frrokun zgjodhën një vend të mbrojtur rrëzë një druri të moçëm, atje ku pylli ishte më i dendur e më i lidhur.

— Mirë e keni zgjedhur, këtu s'rrëzohen drurët se mbështesin njëri-tjetrin! — tha Lleshi.

— Edhe drurët e mbështetkan njëri-tjetrin! — buzëqeshi Frroku.

Sharrëxhijtë gërmuan me lopata një strehish-të. Nga ana e veriut ngriten një digë të lartë bore të ngjeshur. Fundin e strehishtës e shtruan me degë bredhi dhe e ftuan mikun të zgjidhë vend. Të tjerët u ulën rrëth tij. Era ulërinte si më parë, por në strehishtë më shumë dëgjohej, se sa ndihej.

Fredit iu kujtuan shtëpitë e eskimezëve dhe buzëqeshi. Nxori paqetën dhe u afroi shokëve nga një cigare me filtër. Si për çudi, çakmaku u ndez kollaj dhe nuk u fik prej erës.

— Qenka shumë i butë, s'ndihet fare se pi duhan!

— vërejti Lleshi. — Do të bësh një duhan burrash?

Fredi mori kutinë prej alumini, drodhi me vësh-tirësi një cigare të trashë në trajtë konike dhe e ndezi. Pa e thithur mirë, e dogji në grykë e në mush-këri.

— Ky s'qenka duhan, por barut! — tha buzagaz, ndërsa kollitej.

— Duhan burrash, pra!

Fredi ndihej mirë. E kishte pushtuar një gjallëri e pazakontë. Vetëm këmbët i mërdhijnin pak. Preku me dorë syprinën e këpucëve.

— Kanë marrë lagështirë! — vërejti Frroku. — I ke mbathur me çorape leshi?

— Jo, me çorape të zakonshme.

— Aha, ato s'bëjnë për kohë të tillë! — tha Frroku.

— Burri nga këmbët ftohet! — vazhdoi ai. — Po qenë këmbët ngrohtë... Po do ta rregullojmë këtë punë.

— Ky murlan do ta çelë motin! — tha Lleshi.

duke vështruar përpjetë. — Retë po lëvizin në drejtëtim të jugut.

S'kaloi një orë dhe parashikimi i tij u vërtetua. Flokët e borës u rralluan e pastaj rreshtën. Era u zbut dhe fryente me gulshe.

— Kaq e pati, e nxori dufin. Tani u lodh! — tha Staka.

«Parashikimet e tyre qenkan më të sakta se të buletinit meteorologjik!» — mendoi Fredi.

— Si thoni, burra, a zbresim? — propozoi Frroku.

Varg, u nisën më të poshtë. Fredin e lanë të parafundit. Vargun e mbyllte Staka. Miku s'lihet në fund dhe as në krye që të çajë borën. Nga shtegu s'kishte mbetur as gjurma. Edhe lugu mezi dallohej, si një rrudhë e lehtë në sipërfaqen e fshirë e të lëmuar nga era.

Edhe pjesa e pastruar e rrugës automobilistike ishte mbushur pothuaj krejt. Sharrëxhinjtë qenë mbledhur në një strehishtë të gjerë, rrëth një zjarri me degë të njoma pishe dhe hanin duke shkëmbyer biseda e shaka.

«S'qenkan dëshpëruar që puna u paska shkuar pothuaj kot!» — mendoi Fredi.

— He, kështu e ka bora, por ne do ta çelim përsëri! — tha një sharrëxi nofullgjerë, që e kishte vënë re keqardhjen e operatorit. — Ajo bjer e ne hiq. Më në fund, ne se ne do të fitojmë! Afrohu te zjarri, ja, këtu!

Afshi i zjarrit i pëlqeu Fredit. Madje, i pëlqeu edhe kundërmimi i tymit. Duke u djegur, halat e pishës kërcisin e përdridheshin. Zjarri dukej më i kuq e më i ndritshëm se çdo herë tjetër.

Mbas një copë here, pranë Fredit u fanit Frroku.

Mbante në dorë një palë çorape leshi të bardha, me qëndisma ngjyrash të ndryshme.

— Vishi! — i tha, duke ia zgjatur. — Mos ki merak, janë të reja.

— Ndoshta s'është nevoja t'i përdor! — ngurroi Fredi. Ja, po thahem në zjarr...

— Vishi, bre burrë, se na bëjnë të tjera gratë, të kulla! Madje, në të pëlqefshin, do të më bëhej qejfi t'i pranoje si kujtim.

— Faleminderit — tha Fredi, i prekur.

— Do të zbrisni në sektor? — e pyeti Staka. — Ùnë po shkoj të sjell diçka për shokët, se asnjeri nuk do të zgresë për drekë.

— As unë! — vendosi Fredi. — Më sill bukë e djathë, se kam një uri prej ujku.

Staka ktheu krahët dhe u zhduk mbrapa stomit.

— Bujrum! — e ftoi Fredin një sharrëxhi flokkëkuq, duke çelur trastën e vet. — Ohu, sa të vijë Staka... E do misri apo gruri?

— Misri. Gruri ha përditë! — buzëqeshi Fredi.

— Djathi nuk është i mensës, por i shtëpisë. Është djathë dhish, por i mirë. Provoje! — Ai këputi një copë të madhe dhe ia zgjati.

Fredi nisi të hante me ëndje. Më parë do të kishte ngurruar të hante nga dora dhe trasta e një sharrëxhiu, kurse tani as që i shkoi ndërmend kjo. Nuk qe uria, por diçka tietër që ia kishte sjellë këtë ndryshim. Diçka qe përblysur në brendësinë e tij. Këto mendonte Fredi duke përtypur me shije copën e bukës së misrit dhe djathin e dhirtë, ndërsa nuhas-te tymin e degëve të pishës.

— Burra, t'ia fillojmë përsëri! — tha Ndreca. — Ti, Mrikë, zbrit në sektor, se ndoshta Vata ka nevojë për ndihmë. Sonte mbrëma duam të hamë mirë.

Të ketë bollëk. Kështu i thuaj. Kurse ti, Bardhok, u tregove burrë i vërtetë! — Ai ia përkëdheli kokën djalit, të cilit i shkrepëtinë sytë kur dëgjoi këto fjalë. — Tani s'bën keq të shkosh e t'i përsëritësh mësimet për nesër... Hajdeni, burra! — Ndreca priu, me lopatën në sup.

«Njerëz të mirë, njerëz të fortë, njerëz me zemër të madhe!» — mendonte Ndreca, duke i vështruar me admirim. — «Pse thonë, i fortë si guri? Pse thonë, i mirë si buka e nxeh të?... Do të ishte më e drejtë të thuhej, i fortë si njeriu, i mirë si njëriu... si njeriu i vërtetë!...»

8.

— S'pata faj që s'të dëgjova kur thirre! — tha Paloka. Murlani ulërinte më keq se një lukuni ujqish.

— Kurse unë pata faj që u largova aq shumë, vetëm! — tha Bledari. — Por, mbasi përfundoi pa dëm, gjene mirë. Të shkuara, të harruara!

Qenë struktur rrëzë një bredhi të moçëm, i cili ishte aq i madh, sa ata të dy dukeshin si kukulla karshi tij. Trungu, me lëvore të ashpër e të plasaritur thellë, ngrihej i madhërishëm, qiri përpjetë dhe diku lart shtrinte anash degë të stërmëdha, në trajtë e një çadre vigane.

Bledari ngriti kokën lart. Nuk shihej asnjë copë qiell, veçse një rrjetë e dendur degësh e degëzash të murrme dhe reflekse të gjelbra të halave. Bora kishte mbetur diku në katet e sipërme të kurorës. Ajo zotëronte një rrëth vigan dhe ahet e bredhat rrëth e qark ishin shtrembëruar si të trembur nga kthetrat e saj.

— Ke ftohtë, a të ndezim përsëri zjarr? — pyeti Paloka.

— Jo, s'është nevoja. Ecja e shpejtë nëpër pyll më bëri mirë! — tha Bledari. — Tani edhe pak na mbeti për ta përfunduar ridamkimin.

— Hej, ç'rrezik kalove! tha Paloka, duke tundur kokën. — Ende s'e kam përmbledhur veten nga shqetësimi.

Bledari buzëqeshi. Edhe atij i dilnin herë pas here në kujtesë pamjet e ndodhisë së asaj dite. —

... Ata caktuan së bashku drunjtë që duheshin hequr, pastaj Paloka qëndroi që t'i shënonë me damkë, kurse ai shkoi më tej, të studjonë një pjesë tjetër të pyllit. Kështu do të shpejtohej puna dhe do të arrinin ta përfundonin ridamkimin para se të acarohej më keq furtuna. Pa e vënë re u largua mjaft nga shoku.

Ndërsa ecte kokëlart, për të vrojtuar dendësinë e kurorave të drunjta, ndjeu se shkeli bosh dhe u gjend befas, i fundosur në borë, gjer në brez. Në fillim s'i dha rëndësi dhe qeshi me vete, se iu kujtua përralla për mëndjemadhin që ra në gropë se e mbante kokën përpjetë. Të paktën, gropë e tij qëlloi e mbushur me borë dhe s'u vra! S'e meritonte të vritej: pylltarëve ua kérkon zanati që të ecin në pyll me kokë lart.

Provci të dilte, por duke lëvizur, u fundos më thellë. U shtri mbi borë me gjysmën e trupit dhe u mundua të nxirrte këmbët, por nuk mundi, Bora kishte ngrirë në sipërfaqë dhe duart i rrëshqisnin e s'kapej dot. Atëherë u shqetësua. Thirri Palokën, thirri me sa zë kish, por edhe ai vetë mezi e dallonte thirrjen nga uturima e pyllit. Era po ashpërsonej, flokët e borës po dëndësoheshin. Gjurmët që bënin

duart e tij gjatë përpjekjes, mbuloheshin sakaq. Filloji të mërdhihte. Murlani me borë ia shponte fytirën si me qindra gjilpëra dhe i pengonte frymëmarrjen. Detyrohej ta kthente sa mundej kokën mbrapa që të mund të ngopej me frymë.

Paloka do ta kërkonte, madje, ai sigurisht po e kërkonte, por s'duhej pritur, duhej bërë diçka... Vendosi të gërmonte me duar rreth vetes që të çlironte këmbët. Sa të arrinte të shtrihej me gjithë trupin mbi borë, pastaj do të largohej me zvarrise. Sa e madhe të jetë gropë, vallë? S'duhet të jetë shumë e madhe, ja, të shumtën deri te ai ahu!

Gërmonte me furi. E flakte borën larg. Kështu edhe po nxohej disi. Mirëpo duart i mërdhihnin, i mërdhihnin shumë. Ndërsa gropë po thellohej, ato i bëheshin pérherë e më të ngathëta, pérherë e më të pabindura. Mundohej t'i ngronte, duke i futur herë pas here nën sqetulla. Në ato çaste kthente kokën mbrapa, që të merrte frymë më lehtë dhe vështronë se mos dukej gjökundi Paloka. Murlani bëhej pérherë e më i egër.

...Degët e drunjve i lëvizte era, po trungjet pse lëviznin? Pse i rëndonin aq shumë qepallat?... Bora i ngjante një dysheku të butë me pupla. Sikur të mos qe aq e ftohtë, ah ç'do të shtrihej e të flinte.... Vërtet, pse lëviznin trungjet?... Sikur s'po mërdhihte më aq shumë. As këmbët nuk i mërdhihnin... Sikur ta dinte nëna në g'hall ishte!...

I doli para syve fytyra e saj e hequr, me rrudha të imta dhe me flokë të thinjur shtrënguar pas tëmthave. Iu duk sikur sytë e saj të butë e laramanë e vështronin me dhembshuri të thellë, sikur buzët e saj lëvizën dhe i thanë: «mos u jep, të keqen nëna, forca, gërmo, dil që andej sa më parë!»

Ai hoqi duart nga sqetullat dhe iu përvesh rish-tas gërmimit më me vrull. Ja, arriti deri të gjunjët, edhe pak, edhe pak!... Rrahu me pëllëmbë vendin para vetes që ta ngjeshte borën dhe provoi të shtri-hej e të tërhiqte këmbët. Ato lëvizën! Ca nga ca mundi t'i nxirrte. Ashtu, i shtrirë përbmbys mbi bo-rën e ftohtë, sikur e përqafonte atë, filloj të zvarri-sej, duke vënë në veprim jo vetëm gjymtyrët, por edhe mjekrën. Ndiente zemrën tek i rrithë fort. Ahu po afrohej. Edhe pak... Vetëm pasi u kap fort në një degë të tij, guxoi të ngruhej më këmbë... Atë çast dalloj Palokën, që po rendte i shqetësuar drejt tij. Ai diçka thërriste se lëvizte buzët, por nuk dë-gjohej se murlani ulërinte... tamam si një lukuni ujqish. Pastaj, iPaloka ndezi një zjarr të madh...

— Thonë se vdekjen në borë njeriu e pranon më lehtë! — tha Bledari.

— Njeriu s'shkon asnjëherë drejt vdekjes, veçse kur ndjek një qëllim të madh! — vërejti Paloka. — Edhe drunjtë, që janë drurë, e mbrojnë jetën e tyre. E trashin lëvoren rreth e qark plagëve, lëshojnë degë të reja në vend të atyre që u thahen e mundohen të gjelbërojnë edhe kur kalbëzimi ua ka zgavruar krejt trungun.

• Paloka heshti një copë herë. Sytë e tij vështro-nin mendueshëm, diku larg. Rrudhat rreth tyre dhe në ballë iu dendësan. Vazhdoi me një zë të thellë e kumbues, duke bërë pushime ndërmjet fjalëve:

— Ja, unë s'e kam pasur të shtruar me lule jetën... Gruaja më la me dy vocërrakë, djalë e vajzë. Nuk u martova përsëri. Fëmijët u rritën te gjyshja, nëna ime. Çdo të shtunë kthehesha i përmalluar në kullë dhe kur ata më hidheshin në qafë, harroja çdo hall e çdo mundim. Më rritej zemra tek i shihja që

rriteshin... Por, ja që edhe djali më la. U vra në kufi, në përpjekje me armiqtë. Jam krenar se ajo vdekje ishte si një lindje e dytë për të, por prindi është prind. Më merr malli për të... Dikur edhe vajza u largua, se gjeti fatin e saj. Dikush ma qau hallin se ngela vetëm. Kurse unë s'ndiehem i vetëm. Përditë kam rrëth e qark shokët, kam pyllin... Mandej, çdo dy javë shkoj te nipat e vegjël: tre çuna si sokola, njëri më i mirë se tjetri... Ja, kësaj radhe u vonova. M'u bënë tri javë pa i parë. Të shtunën që vjen besoj se do të shkoj. E Gjeloshi, më i madhi ndër nipat, s'ka për t'u kthyer i mërzitur nga Qafa e Ujit... Çdo të shtunë mbas dite del e më pret atje. Sa më duan!...

— I paç me jetë, i martofsh e u gjëzofsh me ta, o Palokë! — uroi Bledari, i prekur nga ai rrëfim i singertë.

— Faleminderit e i gjëzuar qofsh! — ia ktheu Paloka, me një buzëqeshje të çiltër, gati fëminore. Pastaj, si u mendua një hop, shtoi: — Po, po,jeta është e bukur, me gjithë hidhërimet e saj. Dikujt i takojnë më shumë e dikujt më pak, por se janë ato, shquhen të mirat dhe gjëzimet. Prandaj, njeriu ka hak që do të jetojë sa më gjatë... Veçse me nder!

Një gulsh ere kaloi nëpër rrjetën e degëve të bredhit e ai uturi si i zemëruar që ia prishën qetësinë. Ahet e bredhat rrëth e qark u drodhën.

— Çohemi dhe i japim fund? — propozoi Bledari.

— Drejt e ke! — miratoi Paloka dhe brofi më këmbë, duke u shkëputur nga mendimet. Edhe dy o're ditë janë. Në pyll muzgu bie përnjëherësh.

— Ç'të bëjmë me këtë? — kërkoi mendim inxhinieri duke treguar bredhin e moçëm.

— Thua ta shënojmë pér ta prerë? — ngurroi Paloka. — Kështu t'ia shpérblejmë bujarinë e strehimit?

— Po këta nipat e vegjël?

Bledari tregoi, duke buzëqeshur, filizat e rinj të bredhit e të ahut me majë të shtremberuara, pér t'iu larguar kurorës kërcënuese të viganit.

— Po, ke të drejtë! — miratoi Paloka me keqardhje, mbasi shëtitë vështrimin rrëth e qark.

Iu afrua përséri trungut të bredhit, zbuloi nga bora një cep të rrënjeve të tij, gdhendi pak lëvoren dhe pastaj goditi fort me çekiçin e damkës. Druri kumboi. Ai u largua pa e kthyer kokën. I dukej sikur bredhi po e vështronë me qortim.

«Me sa duket, ne ishim të fundit që u strehuam rrëzë tij!» — mendoi. «Vallë, sa breza kalimtarësh janë çlodhur nën të?»

— Mendoj ta shënojmë edhe këtë, është me zgavër në trung! — thirri Bledari, duke treguar një dru tjetër.

Pylli kishte rënë në qetësi. Dëgjohej bora që ndrydhej nën hapat e pylltarëve dhe herë pas here goditja e çekiçit të damkës. Në masën e hirtë të reve ishin krijuar disa të cara, ku dukej qelli, me një kaltërsi të zbehtë, të plumbtë.

— Çeli! — tha Bledari duke treguar me gisht përpjetë.

— Po, çeli shpejt. Na lodhi pak, por s'bëri keq që ra! — tha Paloka. — Bujqësisë do t'i vlejë. Edhe pyjeve. Mijëra filiza do të shpëtojnë nga shkatërrimi, se trupat do të kalojnë përmbi ta pa i dëmtuar.

— Kurse këta këtu i paskan dëmtuar! — tha Bledari, duke treguar një syth filizash të shkelur, të glëvoruar, apo me majë të këputura.

— Kur shikoj filiza tē dëmtuar, sikur shikoj fëmijë tē gjakosur! — tha Paloka dhe ra nē gjunjë pranë tyre. Nxori nga xhepi një biçak tē madh dhe i preu lëmuar degët e thyera ose tē zhvoshikuara. Umundua t'i drejtonte filizat e shkelur duke i shtrën-guar me borë rrith e qark.

— Ne, malësorët, ende nuk e dimë siç duhet vlerën e pyjeve! — tha duke u quar.

— Kështu ndodh kur e ke me shumicë diçka!

— vërejti Bledari.

— S'është vetëm kjo. Në tē kaluarën pylli na afronte egërsirat, nē pyll na zinin pritë, pylli na pengonte kullotën. Prandaj, tē parët tanë, që nuk ia dinin dobitë e shumta, e shihnin me frikë. Kurse sot është ndryshe. Këto pyje, që dikur ushqenin vetëm egërsirat, sot ushqejnë e begatojnë mbarë krahinën. Pothuaj s'ka familje pa një sharrëxhi a pylltar. Madje me lëndën e këtyre pyjeve është ndërtuar gjithë vendi.

— S'ka qoshe ku tē mos shkojë druri i këtyre pyjeve! — tha Bledari.

— Prandaj na takon t'i duam e t'i çmojmë akoma më shumë! — vërejti Paloka.

— Që t'u shërbejnë edhe nipave tē tu! — vërejti inxhinieri.

— Edhe nip-stërnipave tē tyre! — plotësoi Paloka. — Por s'mjafton tē mendojmë kështu vetëm ne. Të gjithë, të gjithë duhet.

Bledari ngriti sytë përpjetë dhe shqyrtoi me vëmendje kurorat e drunjve.

— Këtu është mjaft rrallë, s'kemi ç'të heqim. Shkojmë më tej! — tha.

Ata vazhduan kështu dhe mbas një copë herë dolën nē një lirishtë tē gjerë që rrithohej nga pylli

në formë patkoi. Buzë lirishtës kurorat e drunjve ishin më të begatshme dhe degët zgjateshin pothuaj gjer përdhe duke formuar një perde të madhe me lara të murme, të gjelbra e të bardha.

— Më në fund e kryem! — tha Bledari dhe kërroi vend që të ulej dhe të pinte i qetë një cigare.

— Thua, e kryem mirë? — dyshoi Paloka.

— Ne pér mirë u munduam. Koha do ta tregojë.

— Do të duhet shumë kohë! — vërejti Paloka. — Kështu e ka ky zanati ynë, duhet ta kesh jetën shumë të gjatë që ta shikosh frutin e punës tënde. Madje, edhe sikur të jetosh një shekull, pak të takon të shikosh.

Bledari gjeti një trung të rrëzuar, e pastroi nga bora dhe u ul. I shijoi së tepërtmi duhani. Kjo tregonte se ishte në gjendje të mirë, me gjithë peripecitë e asaj dite.

Tymi i duhanit tretej drejt jugut. Frynte erë e lehtë, aq sa degët e drunjve mezi lëviznin. Drunjtë të dukeshin të lodhur, të dremitur, sikur pregatitëshin të flinin, me kokët të mbështetura te njëri-tjetri. Drita nuk ishte më e ashpër, e bardhë-verbuesë, por e butë, disi kaltëroshe. Hijet ishin dendësuar. Hollësitë po fshiheshin mbas tyre. Shquanin mirë vetëm trajtat e mëdha, të rrumbullosura. Ngjyrat po përziheshin me njëra-tjetërën. Po binte muzgu.

Bledarin e magjepsi ajo pamje. Sikur i pikonte në brendësi një ndjenjë e butë prehëse. Iu kujtua pikatura e Entelës dhe buzëqeshi.

... Një pasdite Entela e kishte tërhequr pér dore në dhomën e saj, me një shprehje që tregonte se e priste një e papritur. Pranë dritares ndodhej kavaleti ku ajo piktoronte, i mbuluar me një pëlhu-

rë të lehtë. Ajo e hoqi pëlburën dhe vështroi Bledarin, që të hetonte përshtypjen e tij. Dukej që priste lavdërimë.

Bojrat e pikture ishin ende të pathara dhe kundërmonin terpentinë. Bledari pa një çeltirë të madhe laramane, buzë saj vargje drunjsh me kurora lejla, rozë, të bardha, të kaltra, përtej tyre një kreshtë mali të gjelbër dhe sipër një qiell verdhosh me njolla të bardha.

— Kam menduar ta quaj «Pranvera në pyje!»

— kishte thënë Entela, pak e shqetësuar nga heshtja e tij. — Si të duket?

Ai kishte rrudhur supet.

— Ngjyrat janë të bukura, shkojnë me njëratjetrën, por kjo nuk është pranvera në pyll! — kishte thënë, më në fund.

— Mos ndoshta pse drunjtë s'janë të gjelbër? — kishte pyetur ajo me ironi të lehtë. — Por kjo nuk është një fotografi me ngjyra!

— E di dallimin ndërmjet fotografisë dhe pikture, megjithatë kjo tëndja nuk më bën të ndjej pranverën në pyll, madje as pyllin!

— Çudi, njerëz që marrin vesh nga pikturna, e kanë pëlqyer shumë! — i kishte thënë ajo e mërzitur.

— Ata, ose nuk kanë shijet tonë, ose nuk kanë qënë asnjëherë në pyll! — kishte thënë ai, duke i hequr sytë nga pikturna.

Entela kishte hedhur me inat pëlburën mbi kavalet...

«Ti ke nevojë të vish këtu, Entelë!» — mendoi Bledari. — «Ke nevojë jo vetëm për të parë bukurinë e peizazheve, jo vetëm për të njojur pyllin e vërtetë...»

— Po dëgjohet zhurmë traktori! — tha Paloka.

— Lulashi do ta ketë ndrequr manikotën! — tha Bledari. — Si thua, të çelet rruga sonte?

— Ata s'flenë pa e çelur! — Paloka tregoi me dorë nga duhej të ishin sharrëxhijtë.

— Zbresim edhe ne atje? — pyeti Bledari, duke fikur bishtin e cigares.

— Është tamam koha!

Ata u çuan. E kaltra po pushtonte gjithësinë. Diku larg vezulloi një dritë.

Sa më shumë binte nata, aq më shumë shtohej të ftohtit. Megjithatë, Lulashit në kabinën e traktorit po i rridhnin djersët rrëke. Nuk i fshinte, sepse ato nuk shteronin dhe ai s'kishte kohë. Manovronte parreshtur me leva.

Traktori ngjeshte ruspën në ballin e borës, e shtynte dhe ajo qërohej si lëvore e trashë, rrëshqiste në llamarinën e çeliktë, kthehej e mbështillej në trajtë ruli e ai vinte duke u rritur, i shoqëruar me rritjen e uturimës së motorit. Kur zinxhirët fillonin e bluanin në vend, Lulashi e zmbrapste traktorin, pastaj e lëshonte rishtas përpara, me shpejtësi. Traktori ngjante si një qen i madh, i kuq, që i ndërsehej përbindshit të bardhë dhe përleshej me të.

Në kabinë, pranë Lulashit, qe ulur edhe Fredi Mushqeta. E kishin hipur sharrëxhijtë pothuaj me zor, sepse ai ngulte këmbë të vazhdonte të punonte bashkë me ta.

«Ti kryej mirë atë punën tënde, se kësaj i dalim për zot ne!» — i kishte thënë Vuka.

Mbrapa traktorit çmbështillej rruga e çelur, si një llogore e stërgjatë, me faqe të larta, të bardha dhe me rrafshin të vizuar prej thikave të zinxhirëve. Gjatë saj punonin grupe-grupe sharrëxhijtë. Ata

gregullonin me lopata skarpatet, vendet e ndërrimit dhe skelet e ngarkesës.

— Sa kohë do të na duhet për t'u takuar me traktorin që vjen përballë? — pyeti Fredi.

— Edhe nja dy orë! — iu përgjigj Lulashi, duke thirrur.

— Po errësohet. Si do të punosh më vonë, me tahmina?

— Punë që ndreqet! — ia priti Lulashi, duke buzëqeshur. Uli gazin, doli përgjysmë nga kabina dhe vikati: — O Vukë, erdhi koha për dritë!

«Edhe elektriçist qenka ky, Vuka?» — tha me vete Fredi, por nuk pyeti, se mos bëhej qesharak. Hapi sytë fort, që të shihte ç'bëhej përjashta. Gjithçka po kridhej në një turbullirë kaltëroshe. Drunjtë e veçuar paraqiteshin me silueta të shumëtrajtshme, kërcënuese. Pyjet përtej celtirës ngjanin si mure të një rënoje të lashtë. Sharrëxhinjtë dukeshin si hije të zbeta, që lëviznin.

Fredit iu duk sikur ishte në një èndërr. Vetëm uturima e traktorit, era e naftës dhe kundërmimi i athët i djersës së traktoristikit ia largonin këtë dukuri.

Befas, nga dritarja e pasme e kabinës erdhi një dritë e kuqérremtë. Bora shndriti me reflekse të purpurga dhe para traktorit u zgjat një hije e zezë. Drita u shtua dhe u forcuai.

Fredi ktheu kokën me habi. Pa një sërë flakë-zash që vinin drejt tyre. Ndërsa afroheshin, shpërthenin flakëza të tjera. Dëgjoheshin hapa në borë dhe murmuritje. Lulashi ktheu një hop vështrimin, buzëqeshi me habinë e tjetrit dhe vazhdoi të lëvizte levat.

— Janë sharrëxhinjtë me pishtarë! — sqaroi. —
Tani do të kemi dritë.

Vargani i dritave e arriti traktorin, i doli anash, pastaj kaloi përpara. Hija, si e trembur, u shkurtua, u gërmuq dhe u fsheh nën traktor. Shkëlqeu çeliku i ruspës dhe kuqëloi llamarina e kabinës.

— Mbaje pak, do të zgres! — tha Fredi.

— Merre edhe këtë, hidhe krahëve. Jashtë s'është si në kabinë! — thirri Lulashi, duke i hedhur pëliçen e vet.

Fredi u shtriq, bëri disa hapa që të shpinte këmbët dhe vështroi rrith e qark. Tani nuk dalloheshin as siluetat kërcënuesse të drunjve, as profilet e murme të pyjeve, as gjë përvëç pellgut të ndriçuar nga pishtarët, ku krijuheshin, zgjateshin, lëviznin dhe zhdukeshin hije të panumërtë, shumë trajtëshe. Ftyrat e sharrëxhinjve dukeshin të kuqe, sytë u kishin një shkëlqim të pazakontë, zëri u dilte si krismë. Duart që mbanin pishtarët dukeshin veçanërisht të fuqishme. Rrëzë flakëzave ziente rrëshina, që lëshonte kundërmim të këndshëm dhe tym të zi, i cili ngrihej drejt qiellit po aq të zi.

— A u mërzite, shoku Fredi?

Ai që foli e kapi sakaq për krahu. Ishte «elektriçisti» Vukë.

— E si të mërzitem!? — tha sinqerisht operatori.

— A të pëlqen kjo drita jonë? — buzëqeshi Vuka. — Është drita e gjyshstërgjyshërve. Deri vonë me këtë e ndriçonim shtëpinë. Kandili dhe llampa me vajguri patën jetë të shkurtër te ne. Kaluam shpejt nga pisha në dritën elektrike... në dritën e Partissë! Megjithatë, ndodh që na shërben përsëri kjo drita e lashtë.

— Hej, Lulash, jepi sa të mundesh. Traktori tjetër, së bashku me autokolonën, kanë arritur deri te kthesa e madhe! — foli dikush.

Fredi njohu zërin e Ndrecës. Pastaj dalloi inxhinier Bledarin. Edhe ai mbante një pishtar në dorë. I buzëqeshte dhe e përshëndeti, duke çuar pishtarin. E kishte mbërthyer peliqen deri në fyt dhe jo vetëm nga veshja, por edhe nga shprehja e fytyrës, nuk dallonte aspak nga të tjerët.

«Po unë, vallë, si dukem ndërmjet tyre?» — e pyeti veten Fredi, duke dëshiruar që edhe ai vetë të mos shquante nga të tjerët.

— Vukë, ma jep një pishtar! — iu lut.

Ai buzëqeshi dhe i zgjati të tjin.

— Forca, Lulash, se ngelëm pa front pune dhe po mërdhihim! — thirri Frroku. — Ti me ruspë e ne me lopata dhe ta arritëm!

— Unë jam një, jujeni shumë! — tha me zë të lartë Lulashi.

— Por, ti ke shaluar pesëdhjetë e katër kuaj! — ia priti Frroku.

Lulashi qeshi dhe e lëshoi traktorin me hov drejt ballit të borës.

— Shoku Fredi, a do të zbresësh në sektor? — e pyeti Staka operatorin, duke e zënë për krahu.

— Me të tjerët, bashkë! — ia priti ai, pa ngruar.

— Unë jam i detyruar të zbres! — tha Staka, kokulur, sikur desh të shfajësohej. — Duhet pregatitur banaku.

Ktheu krahët dhe iku. Ndiente një boshllëk përbreda, sikur i qe shembur diçka. Gjer atëhere e kishte ndjerë veten përsëri sharrëxhi, kurse tanë

i qe shembur kjo dukje. He, duhej pregatitur banaku! Banaku i kishte ngelur atij.

— Erdhe Stakë? — i tha Mrika, që priste duar-kryq pranë zjarrit.

— Erdha! — mezi iu përgjigj ai dhe eci drejt banakut, duke çaluar.

Mensa iu duk më e shkretë dhe më e ftohtë se qdo herë tjetër.

— Bëre mirë që erdhe. U mërzita shumë vetëm. I kam kryer të gjitha punët. Madje, më erdhhi keq kur i përfundova, se s'kisha me se të merresha. A mund të mungoj pak?

— Shko! — i tha Staka, pa e ngritur kokën.

Mrika doli me një nxitim të pažakontë për të. Megjithëse ishte errët, e ngjiti shpejt dhe pa u penguar shtegun mbi sektor dhe arriti në lirishtën e vogël, ku ndodhej varri i Frrokut. Gjatë gjithë asaj dite e kishte menduar këtë, por s'kishte pasur rast të mbetej vetëm. Sepse donte të ishte vetëm.

U ul pranë kreut të varrit dhe preku lehtë me gishterinj gurët e skalitur të tij. Nuk iu duk aspak e ftohtë ajo prekje, përkundrazi. Të dhjetë vjetët që kishte kaluar pa Frrokun iu bënë të paqenë dhe e pa me sytë e mendjes përsëri pranë saj. E pa të Mrizi i Lisave, ku çeli si një lule e egër mali ndjenja e tyre. E pa ndërsa kalonte buzagaz mbrëmjeve pragun e kthinës së tyre. E pa duke mbajtur në duar Bardhokun e vocërr. Pastaj, i doli para syve vigu me degë bredhi, që e sillnin më të poshtë një tufë sharrëxhinjsh të ngrysur. E largoi atë pamje. Ajo sonte donte të kujtonte Frrokun e gjallë, donte të shkëmbente dy fjalë me të. Kishin kaluar dhjetë vjet, por malli për të s'i ishte shuar. Ia kishte ruajtur nderin, ishte treguar e denjë për t'u thirrur si

e shoqja e Frrokut. Po ia rristsi djalin, po ia rristsi kreshnik, siç i kishte hije birit të tij.

U qua ngadalë. Nuk i bënин këmbët të ikte. I shkuan sytë te një hije e rrumbullt buzë lirishtes. E dinte që atje ndodhej dëllinja e madhe. Shkoi drejt saj dhe zgjati duart të këpuste disa degë. Halat ia shpuan pëllëmbët, por ajo nuk e ndjeu dhembjen, nuk u ruajt. Shkoi e i vendosi degët ngadalë pranë gurit të madh, të kreut. Ndjeu sesi një lot i nxehthë i përkëdheli faqen e saj të ashpër dhe pikoi aty.

Ngriti sytë dhe pa drithën e sektorit. Ndërmjet tyre shqoi drithën e tyre. Aty vocërraku i nënës po përsërishte mësimet, duke e pritur të kthehej. Ndjenjat e saj u kthjelluan, ashtu siç kthjellohet moti pas shiut. Tani e kishte pushtuar një dhembshuri e madhe për të birin, për sektorin, për njerëzit e atje-shëm, për bjeshkën, për jetën...

Kaloi pëllëmbët në fytyrë, shtrëngoi shaminë e kokës dhe nisi të zbriste duke shkelur me siguri në shtegun që s'dukej. Frynte erë e lehtë. Ajo sillte me vete zhurmat e fashitura të natës dhe bashkë me to, uturimë traktorësh e makinash.

«Me sa duket janë në përfundim!» — mendoi Mrika dhe shpejtoi hapin.

Vërtet ishin në të përfunduar. Kishin mbetur edhe një pesëdhjetë metra që të bashkoheshin frontet. Të gjithë i kishte përfshirë një gjallëri e pazakontë. Dëgjoheshin britma dhe thirrje nxitëse. Lopatat punonin shpejt. Njerëzve sikur iu ishte zhdukur lodhja e asaj dite të mundimshme. Traktorët vërsuleshin me egërsi kundër përbindshit të bardhë. Shkëlqenin kërcënueshëm thikat e çelikta, vallzonin hije të shumta, shuheshin e ndizeshin pishtarë të sinj.

Sulës i vinte keq që ishte i detyruar të qëndronte në kabinë. Kishte mbetur vetëm. Plaku kishte ikur drejt kullës së vet pa u ngrysur. Prenga kishte dalë para traktorit që t'i jepte drejtimin e punës. Mirashi kishte rrëmbyer lopatën e tij dhe po punonte qyshkur për rregullimin e kthesave e të skarpateve. Sula e çonte përpara makinën me hope. E kuqtonte që punohej shpejt, bile shumë shpejt, megjithatë ziente nga padurimi. Ai donte të ecte, të ecte! I vinte keq që s'mund të ndodhej midis sharrëxhinje në çastin e bashkimit të fronteve. As për të parë nuk mundej, se e pengonte vinçi. Por ai do të ngarkonte i pari të nesërmen dhe do të ngrysej në shtëpi. U bënë kaq net larg! Ishalla e gjen djalin të shëruar!

Kur ndërmjet dy traktorëve ngeli një mur bore, lindi një mosmarrëveshje e vogël. Asnjeri nga traktoristët nuk pranonte të tërhiqeji, për t'ia lënë tjetrit ruspat e fundit. Pati një çast ngurrimi, por e mënjanoi sakaq Ndreca, duke thirrur:

— Mbi të, burraq, me lopata!

Në të dy ballet u lëshuan një mori njerëzish. Pishtarët i ngulën në skarpate. Disa që s'gjetën front, u hodhën në mesin e borës së ngelur. Ajo nisi të kërcente përpjetë, si stërkala dhe binte në rrugë. Murlani s'paskësh qenë aq i fortë! Tehet e lopatave shkëlqenin si jataganët në një përlleshje të lashtë. Dëgjoheshin ofshamje, britma, thirrje nxitëse.

Fredi Mushqetës i erdhi keq sa s'thuhet që nuk mjaftonte drita e pishtarëve për të filmuar. Shoferrët, që s'i bënë dot ballë tundimit, kishin zbritur nga kabinat dhe kishin vrapuar aty. Të dy traktoristët, majë zinxhirëve, vështronin si po ua hiqnin kafsha-

tët nga goja sharrëxhinjtë dhe buzëqeshnin të kë-naqur.

Shpértheu një brohoritje ngadhënjimi. Ushtuan bjeshkët. Lopatat u quan përpjetë, si armët e fitores. Njerëzit përqafoheshin, i rrithnin shpatullat njëri-tjetrit, shtrëngonin duart.

Traktoret dhe makinat uturinë përsëri dhe u nisën mbas vargut të njerëzve me pishtarë. Të ndriçuar me radhë nga prozhektorët e makinave dhe vangu i pishtarëve, drunjtë buzë rrugës duke sheshin sikur zgjoheshin të habitur nga gjumi dhe përshëndesnin fitoren e njerëzve, duke tundur degët e tyre të mëdha.

Fredi Mushqeta kishte parë edhe herë tjetër manifestime me pishtarë, me më shumë pjesëmarrës, por në bulevard të asfaltuara dhe nën dritën e llampave neon. Gjithmonë këto manifestime i kishin ngjallur një ndjenjë ekzaltimi. Por, kjo që po shihte sonte, pishtarët mes pishnajës, pishtarët në ato duar të forta e të ashpra, pishtarët që ndriçonin llogoren prej bore dhe fytyrat ngadhënjimtare të atyre njerëzve të fortë, i ngjallnin një emocion të fuqishëm, si asnjëherë tjetër, që e bënte të vibronte përbrenda e pothuaj i pengonte frymëmarrjen. Në ato çaste e ndiente thellë se sa e vështirë ishte që nëpërmjet punës së tij, nëpërmjet filmit, t'i bënte të tjerët të ndienin e të kuptionin ato që kishte kuptuar më së fundi ai.

Sa dëgjoi zhurmë, Staka doli nga deriçka e banakut dhe nxitoi jashtë. Aty gjeti Mrikën dhe kuzhinierin Vatë. Bardhoku i vogël po vravonte, lart, drejt varganit.

— Obobo, m'u dogjën patatet! — u kujtua Vata, apo nuhati erën e djegur dhe nxitoi në kuzhinë.

Vargu zhurmëmadh i njerëzve mbushi sheshin e sektorit. Xhamat e barrakave llamburitën, kurse hijet e tyre u zgjatën drejt shpatit. Pishtarët nuk i shuan. I ngulën pranë e pranë në borë, buzë përroit dhe vërshuan në mensë. Ajo sakaq ndërroi pamje, u bë më e bukur dhe u gjallërua.

Staka rendi pas banakut, fytyrëqeshur. Në sportelin e kuzhinës doli koka e madhe tullace e Vatës.

— Ju kam gatuar gjithë të mirat! — tha ai, me zë bubullitës. — Vetëm qumësht dallandysheje mos më kërkoni. Të hani sa të shqepeni. E meritoni!

Nga radha përballë sportelit, sharrëxhijtë fillouan të dilnin, duke mbajtur në duar pjata që avullonin.

— Në tryeza, në tryeza, sonte do t'jua sjell në tryeza! — thërriste Staka, me shishen dhe me masënë më dorë.

— Rri, bre burrë, se mos je lodhur më pak se nesot! — i tha njëri.

— S'ka gjë, s'ka gjë! Teke, apo dopjo?

Mirashi donte një dopio. Helbete, burrë i moshuar! Nuk dukej aq i mërzitur sa të djeshmen, ose në mëngjes. Vërtet, ai nuk ndihej aq i mërzitur. Çështja që e mundonte, s'i dukej më aq e tmerrshme. Pse, vallë? E kishte rrëmbyer hareja e përgjithshme, apo....

— Edhe unë dopio e dua! — tha Sula. — Sonte do të flemë si qengja, apo jo shoku Bledar? U lodi më diçka, hë?

— Diçka po, por e vlejti! — buzëqeshi inxhimeri.

— Nesër mbrëma në shtëpi, oho! — fërkoi duart Sula.

— Të lutem, bëji një telegram nënës sime! —

Bledari nxori një copë letër, stilolapsin dhe diçka shkroi. — Ja përbajtja dhe adresa... ja edhe paratë, s'besoj të harrosh. Duhet ta kisha bërë qysh dje. Ajo bëhet merak.

— Mos ki merak, me të arritur do ta nis. Do të zgresësh në qytezë me mua nesër në mëngjes? Sikur e mbaruat ridamkimin!

— Jo, do të qëndroj! — tha Bledari.

Pse të ngutej pér në qytezë? Më mirë aty, midis sharrëxhinjve e pylltarëve. Atje e ka punën. Ç'të bënte në qytezë? Ndryshe ata që kishin familjet. Ai është familjar pa familje. Sa mirë do të ishte që edhe ai të kishte një cak. Entelë nuk është mirë kështu, ne duhet t'i japim fund kësaj!

— Ç'rrezik kaloi inxhinieri sot! — po i tregonte Paloka një sharrëxhiu.

Tani Bledarit i dukej e parëndësishme ajo që i kishte ndodhur. E ç'bëri ai, fundja, në krahasim me ata njerëz që e vinin kokën në rrezik përditë?

— Inxhinier, kësaj radhe harrova të të porosit, por herën tjetër kur të vesh në Tiranë, të lutem të pyesësh si shkon me mësimë ai djali im! — i tha Vuka. — Është në politeknicë, mëson pér radio. Hej, ku arritëm, djali i një sharrëxhiu, pér radio! Por këta çunat tanë nganjëherë i vret e mira, harrojnë ç'kanë vuajtur baballarët e tyre. S'u duhet lejuar kjo!

— Pa tjetër do të pyes! — premtoi Bledari.

«A thua do të vijnë të më ndihmojnë të diel!»

— mendonte Lleshi, duke mbillaçitur grosh. — «Po, po, do të vijnë, ata s'i luajnë fjalës... Megjithëse, i lodha sot...»

— Shokë! — thirri Ndreca, duke u çuar me go-tën e rakisë në dorë.

Bisedimet dhe tingëllitja e enëve rreshti.

«Të shikojmë se ç'fjalim do të mbajë!» — tha me vete Fredi, duke e vështruar me vëmendje.

— Shokë, ju lumshin krahët, se e bëtë si burrat! Gëzuar, shokë!

Ndreca çoi gotën në shenjë përshëndetjeje, duke iu drejtuar të gjithëve, e çukiti me fqinjët e u ul.

— Vukë, bjeri një herë çiftelisë! — thirri Frroku nga tryeza e vet.

— Shko e ma sill! — tha Vuka.

Frroku brofi dhe fluturoi jashtë. Vuka hodhi gotën e rakisë, fshiu buzët me kurrizin e dorës dhe priti me sytë nga dera.

— Mbaje! — i tha Frroku, që u kthye si era, duke dihatur shpesh. — Tani, bjeri një herë ashtu siç di ti.

— Edhe tingujt e çiftelisë në dru kumbojnë! — buzëqeshi Paloka.

Vuka akordoi telat. Dukeshin tepër të trashë e të vrazhdë gishtérinjtë e tij, dukej sikur do t'i këput-nin sakaq ata tela të hollë. Ata filluan të dridheshin, të kumbonin. Dhjetra sy u përqëndruan në ata gishtérinj, në ata tela...

Gishtérinjtë e trashë të Vukës rendnin mbi tela. Si orteku që duke zbritur më të poshtë shpatit mbledh borën, ajo melodi e zbritur nga lashtësia, kishte mbledhur ndjenjat dhe mendimet e tyre. Sharrëxhinjtë dëgjonin si të magjepsur dhe dukeshin si një galeri shtatoresh. Vetëm tymi që çohej nga llullat e cigaret e tyre dhe shkëlqimi i pazakontë i syve, tregonte se s'qenë të tillë. Ata dëgjonin dhe ndjenjat e mendimet e tyre dridheshin bashkë me telat e çiftelisë së Vukës.

Jashtë bënte ftohtë, por aty brenda ishte ngrohtë, shumë ngrohtë.